



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 674/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-33418-08-13-2019, me objekt “*Ruajtja me polici private e HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau Dejës*” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 36 muaj”, me fond limit 415.786.312 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.10.2019, nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

Ankimues: “Trezhnjeva” sh.p.k.
Njësia Nr.7, Ish Fusha e Aviacionit, Bulevardi Dafinave, Godina Nr.22, Pll.Nr.2, Kati III nga toka, Apartamenti Nr.9, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare)
Blloku “Vasil Shanto”, P.O. Box 259/1, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.08.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-33418-08-13-2019, me objekt “Ruajtja me polici private e HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau Dejës” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 36 muaj”, me fond limit 415.786.312 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.10.2019, nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

II.2. Në datën 20.08.2019, operatori ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e kriterëve të kualifikimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]

Ne datën 14.08.2019, nepermjet SPE, jemi njohur me dokumentat e tenderit.

Nga verifikimi i tyre konstatuam se ato janë hartuar në kundërshtim me ligjin e prokurimeve publike, pasi janë diskriminuese, për rrjedhojë përjashtuese si dhe lënë vend për interpretim dhe keqinterpretim. Madje nga leximi me kujdes i tyre, konstatojmë se kemi të bëjmë me rastin tipik kur gara është paracaktuar/fiksuar se kujt operatorëve do ti jepet. Për këtë arsye, i kërkojmë të gjitha institucioneve që u jemi drejtuar të iniciojnë hetim duke e mbajtur nën vëzhgim të gjithë këtë procedurë, pasi nga indiciet tona, fitues për këtë procedurë do të shpallen BOE SHPSF "NSS Ndreu Security Servis" shpk & "EUROGJICI-SECURITY" sh.p.k. Dalim në këtë konkluzion pasi të gjitha kriteret lidhen ngushtësisht me kapacitetet që disponojnë këto shoqëri të cilat ruajnë aktualisht në vendrojet objekt prokurimi.

Konkretisht:

Organizimi i këtij shërbimi në një lot të vetëm shpang pjesëmarrjen e Operatorëve të tjerë dhe për pasojë shpang konkurrencën dhe barazinë në tendera publike.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këtë procedurë, për realizimin me sukses të kontratës, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pikë 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

2. Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
- b) të sigurojë mirepërdorim të fondëve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Referuar sa më sipër, shoqëria jone gjykon se organizimi nga ana e autoritetit kontraktor në një lot është joproporcionale pasi e tejkalon vëllimin dhe përmasat e kontratës që prokurohet, në kushtet kur kërkohej që shërbimi i ruajtjes të kryhej në 3 (tre) HEC, Vau i Dejes, Koman, Fierze të cilat administrativisht janë të organizuara në njësi të vecanta dhe shtrihen në dy qarqe, respektivisht 10 vendroje me tre tume në HEC Fierze, 12 vendroje me tre tume në HEC Koman, 14 vendroje me tre tume në HEC Vau i Dejes me 4.98 punonjës shërbimi për vend/roje. Organizimi në një lot të vetëm sipas kriterëve të kualifikimit është joproporcionale me objektin e prokurimit, dhe ndikon në uljen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si dhe bie ndesh me frymën e ligjit i cili parashikon se kriteret për kualifikimin duhet të hartohen në atë mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e sa më shumë ofertuesve në procedurën e prokurimit. Për autoritetin është e

rendesishme te vertetohet se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (ne rastin konkret punonjes sherbimi.mjete sherbimi etj.) mjaftueshem sa te jete ne gjendje te realizoje objektin e prokurimit dhe per kete arsye autoriteti kontraktor duhet te marre masa per modifikimin e kriterit ne fjale, ne perputhje me permasat e kontrates qe dote prokurohet duke e ndare ne 3 (tre) lote.

Ju sjellim ne vemendje:

Procedura ne fjale eshte zhvilluar 3 vjete me pare dhe ka funksionuar shume mire e ndare ne lote ku pjesmarrja e operatoreve ekonomik ka qene e mjaftueshme pavaresisht se fitues te procedures per lotin Fierze, sipas vendimit te KPP ka dal shoqeria "Trezhnjeva" kontrata eshte nenshkruar dhe zbatuar ne kundershkim me kete vendim te KPP i cili e ka shpallur absolutisht te pavleshme kontraten e lidhur nga BOE SHPSF "NSS Ndreu Security Servis" shpk & "Eurogjici-Security" kjo procedure vazhdon te jete ne proces gjyqesor.

Gjthashtu ju sjellim ne vemendje se shpallja "Fitues" sipas kriterëve te percaktuara nga Autoriteti Kontraktor te BOE SHPSF "NSS Ndreu Security Servis" shpk & "Eurogjici-Security" eshte percaktuar pasi Operatori Ekonomik SHPSF "NSS Ndreu Security Servis" shpk, pavaresisht se ka realizuar kontraten per HEC Fierze prej 3(tre) vitesh me 50 % te kontrates, deri me sot nuk ka asnje punonjes te certifikuar dhe as QKSH ne Drejtorin e Policise se Qarkut Kukes, po keshtu nuk ka asnje punonjes te deklaruar ne Zyren e Punes dhe Tatim Taksave si tepunesuar ne HEC Herze duke kryer evazion fiskal, fshehje te te ardhuarve, ushtrim aktiviteti ne kundershkim me aktet ligjore qe normojne vepritarine e SHPSF-ve.

Ky informacion per Autoritetin Kontraktor duhet te sherbeje per perjashtimin nga pjesmarrja ne kete procedure te ketij Operatori Ekonomik dhe vazhdimin e procedurave per hetim administrative prane APP-se per perjashtim nga procedurat e prokurimit publik dhe indicje per hetim te metejshem nga oraganet e tjera ligjzbatuese; Prokuroria, Hetimi Tatimor, Inspektoriati i Punes, Drejtoria e Pergjithshme e Policises se Shtetit, Krimet Ekonomik e Financiar ne Policine e Shtetit, Autoriteti Konkurences, Drejtoria e parandalimit e pastrimit te parave.

Kerkoj ndarjen me lote te kesaj procedure.

1)Ne piken 2.9 "Kohezgjatja e Kontrates ose Afati Kohor per Ekzekutim" te dokumentave standart te tenderit, mungon afati kohor i fillimit dhe i perfundimit:

2. 9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj 36 ose ditë □□□□

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

2.9.1 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: 36 (tridhjetë e gjashtë) ose ditë: •••• (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër(jo më shumë se (4) vjet)

Ose duke filluar nga ••/••/•• (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më ••/••/•• (dd/mm/vvvv)

Mungesa e informacionit qe ka te beje me daten e fillimit dhe te perfundimit te sherbimit krijon konfuzion dhe pamundesi per shoqerine tone ne perlllogaritjen e ofertes ekonomike pasi ne baze te diteve nxjerrim mesataren e diteve ne muaj.

Per kete arsye, kerkojme plotesimin e te gjitha rubrikave nga autoriteti kontraktor si data e fillimit dhe data e perfundimit te sherbimit.

Gjithashtu, kerkojme te vendoset informacioni nese ditet mesatare mujore do te jene 30.41 apo 30.44 dite gjate perlllogaritjes se tumit te dyte dhe te trete apo do te aplikohet nje mesatare tjetere. Komisioni i prokurimit publik me Vendimin K.P.P 784/2016, date 12.10.2016, ne nje rast te ngjashem ka arsyetuar: [...]

Per sa me siper, kerkojme vendosjen e afatit ne dite si mesatarja e diteve ne muaj.

II) Ne Shtojca 1 "Formulari i Ofertes Ekonomike", autoriteti ka publikuar shenimin si ne vijim:

Sqarime: Analiza e kostos

Sqarime:

1.Në çmim të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, shtesat për Turnet e II-ta dhe III-ta, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, nderlidhje, kapacitetet mbeshtetese, shpenzimet për sigurimin e përgjegjesis profesionale, shpenzimet administrative, fitimi i shoqërisë etj.

Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi dhe analiza e detajuar e cmimit.

Preventiv të kostos për 1 roje në muaj, për 1 vëndroje me shërbim 24 orë

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj	Vlera (Lek) 1 vëndroje me tre turne /Muaj
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Shpenzimet për ndërlidhje (bazuar në tarifën vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin)		
6	Kapacitetet mbeshtetese (transporti i punonjesve pasi kemi të bëjmë me objekte në një distancë të largët)		
7	Shpenzimet për sigurimin e përgjegjesis profesionale		
8	Shpenzimet administrative		
9	Fitimi i shoqërisë		
	Vlera totale pa tvsh për 1 roje në muaj		
	Vlera totale me tvsh për 1 roje në muaj		

Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zërave të mësipërm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM-së Nr. 809, datë 26.12.2018, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe akteve nenligjore në fuqi etj.

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit dhe analizes se kostos, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka të drejtë t'u kërkojë operatorëve ekonomik sqarime në lidhje me zërat e ofertës ekonomike dhe në rast se konstaton se operatori nuk e argumenton dot aritmetikisht, ligjërisht dhe me dokumentacion mbështetës ofertën, autoriteti do ta s'kualifikojë.

Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit).

Klasifikimi i ofertave behet mbi bazen e vleres se ofertes se dhene ne total.

Agjensia e Prokurimit Publik ka publikuar setin e DST per procedurat e prokurimit publik per tendrin e hapur sherbime po keshtu APP dhe KPP-ja kane nxjerre udhezim e perbashket per hartimin e ofertave nga operatoret ekonomik dhe ka percaktuar prevetivin per kte lloj sherbimi si me poshte: [...]

Ky veprim i personave pergjegjes te Njesise se Prokurimit eshte shperdorim klasik i detyres me qellim favorizimin e operatorit ekonomik qe ka ne ruajtje objektin aktualisht dhe rritjen fiktive te ofertes.

5	Shpenzimet per ndërlidhje (bazuar në tarifat vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin)		
6	Kapacitetet mbështetese (transporti i punonjesve pasi kemi te bejme me objekte ne nje distanc te larget)		
7	Shpenzimet per sigurimin e pergjegjesis profesionale		
8	Shpenzimet administrative		
9	Fitimi i shoqërisë		

Kur koficienti per nje vend/roje eshte i percaktuar 4.98 roje, sjell si pasoje ofertime te ndryshme per subjekte te ndryshme. Vendorsja e ketyre kerkesave sherben si pengese per konkurencen e drejte ne prokurimin publik ne kundershtrim me parimet e pergjithshme te Prokurimit Publik te percaktuara ne nenin 2 te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndyshuar pasi nuk ka tarifa te percaktuara.

Se pari, kerkesa per Shpenzimet per nderlidhje (bazuar ne tarifat vjetore te Akep per Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin) bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, date 20.12.2017 pasi sic edhe thekson ky rekomandim keto pajisje presupozohet qe i disponojne operatoret nga momenti i licencimit te tyre:

“- Te mos perllogariten shpenzimet per uniformen, si dhe te mos kerkohet paraqitja e mjeteve ndihmese si p.sh elektrik dore etj. pasi keto kritere permbushen nga shoqeria qe ne momentin e licensimit te saj.

Se dyti, edhe sikur te pranojme per nje moment se kerkesa per llogaritjen ne preventiv eshte e ligjshme (nuk eshte) nuk eshte percaktuar numri i radiove dhe se kerkesa AKEP Radiokomunikim dhe Radioalarme eshte kerkuar ne range Qarku kurse objektet ndodhen ne dy rrethe Tropoje dhe Shkoder cka rrit ne menyre fiktive koston kur llogaritet ne shkalle qarku, eshte teresisht diskriminues dhe jo ne proporcion me objektin e procedures.

Nga sa me siper, kerkojme heqjen e kerkesave referuar me siper.

III) Ne Shtojca 1 "Formulari i Ofertes Ekonomike", autoriteti ka publikuar shenimin si ne vijim:
Sqarime: Analiza e koston

- Operatores jane te detyruar te paraqesin analizen e detajuar me menyren e perlllogaritjes se koston per oferten e paraqitur si dhe preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha koston per te cifat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM nr. 809, date 26.12.2018 per Percaktimin e Pages Minimale ne Shkalle Vendi", Ligji Nr. 7961, date 12.7.1995, "Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise", te ndryshuar, Ligji 75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike". Numri i punonjesve te nevojshem te sherbimit per nje vendroie me tre tume te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 per cdo punonjes sherbimi). Nderkohe qe referuar shtojces 9 "Specifikimet Teknike, Sherbimet & Grafiku i Ekzekutimit, Termat e References", rezulton te jete i pa plotesuar fakt i cili krijon konfuzion gjate hartimit te ofertes ekonomike pasi ne shtojcen 1 eshte percaktuar 4.98 punonjes per vendroie ndersa ne shtojcen 9 eshte i pa percaktuar per nje vendroie kurse ne shtojcen 12 ka percaktuar numrin e punonjesve te sherbimit 5 per cdo vend/roie.

Per sa me siper eshte detyre e autoritetit kontraktor te hartoje kriteret dhe specifikimet ne menyre te qarte dhe te sakte me qellim shmangien e konfuzionit te operatores ekonomik ofertues, informacioni i cili le vend per interpretim dhe per rrjedhoje edhe keqinterpretim duke mos i vene ne kushte barazie dhe kjo do te conte ne ofertime te ndryshme dhe vleresimi nga KVO do te ishte po i ndryshem.

Ky informacion mund te sherbeje si pengese per konkurrencen e drejte ne prokurimin publik, ne kundersizim me parimet e pergjithshme te prokurimit publik te percaktuara ne nenin 2 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Nga sa me siper, autoriteti kontraktor duhet te marre masa per te percaktuar qarte informacionin lidhur me numrin e rojeve per cdo vendroie (4.98 roje) ne te gjitha rubrikat e Dokumentave te Tenderit ku duhet te vendoset ky informacion si kusht i domosdoshem per plotesimin e ofertes nga ana e operatoresve ekonomike pjesmarres ne kete procedure prokurimi.

IV) Ne Shtojca 12 "Termat e References", autoriteti ka publikuar kriteret e kualifikimit qe duhet te paraqesin operatores ekonomik.

Nderkohe qe ky veprim bie ne kundersizim me LPP dhe vete Dokumentat e Tenderit dhe konkretisht me shtojcen Shtojca 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", rubrike e cila eshte vendi ku percaktohen kriteret e vecanta te kualifikimit. Autoriteti nuk mund te dubloje kriteret e vecanta te kualifikimit duke i vendosur sa ne shtojcen 10 dhe ne shtojcen 12.

Per sa me siper, kerkojme heqjen e kriterëve te kualifikimit nga shtojca 12 "Termat e References" dhe nga cdo rubrike tjeter qe nuk ka te beje me shtojcen 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" dhe lenien e tyre vetem ne shtojcen 8.

V) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

"Operatori ofertues duhet te paraqese Certifikata per punonjes sherbimi nenkategoria 1.3.A per 165 punonjes sherbimi, prej te cilave:

- 45 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukes, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 30 punonjes;
- 120 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder, shoqeruar me autorizim arme

minimalisht 100 punonjes. Kërkesa per paraqitjen e 165 certifikatave nuk eshte ne perpjestim te drejte me numrin e punonjesve per zbatim e kontrates, ne te cilet eshte specifikuar se sherbimi do te kryhet ne 36 vendroje me 4.98 punonjes per vendroje me tre tume (tumi I, II dhe III-te) ne total bejne 179.8 punonjes sherbimi.

Ne nenin 46 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, pika 3, parashikohet [...].

Ne nenin 46 te Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: [...].

Ndersa ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, percakohet se: [...].

Per sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit si ne vijim:

- "Operatori ofertues duhet te paraqese 179.28 (njqind e shtatedhjet e nente pike njezet e tete) certifikata profesionale per ushtrim profesioni te rojes leshuar nga DPQ Kukes 50 (pesedhjet) dhe 129.28 certifikata profesionale per ushtrim profesioni te rojes leshuar nga DPQ Shkoder" vendosja e kriterit per 45 certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukes, 120 certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder perputhet me numrin e punonjesve te certifikuar qe kane aktualisht firma "Eurogjici-Security" ne Qarkun Kukes 45 dhe numrin e punonjesve te certifikuar qe kane firmat "Eurogjici-Security" dhe "NSS Ndreu security servis" ne qarkun e Shkodres 120.

Kerkojme heqjen e Autorizimit te armeve pasi pajisja me kete dokument per punonjesit e sherbimit behet vetem pasi lidhet kontrata nga firma fituese sipas plan dislokimit.

VI) Ne kriteret e vecanta te kualifikmit, autoriteti ka kerkuar:

1.Shëbime të ngjashme:

- Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme kat. (1.3.A) në një vlerë sa 166,000,000 leke, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes se tenderit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme operoret duhet të paraqesin:

Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte shtetore duhet të paraqiten Kontrat/ kontrata të realizuara, shoqëruar me Vërtetimin e realizimit me sukses lëshuar nga autoriteti përkatës kontraktor, i cili duhet të përmbajë, Afatin, Vlerën, Objektin. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Ose

- Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte private duhet të paraqiten Kontrat/ kontrata të realizuara të shoqëruara me Faturat përkatëse tatimore të shitjes të firmosura dhe vulosura nga të dyja palët dhe Vërtetimin e përfundimit me sukses të saj, lëshuar nga subjekti privat i cili duhet të përmbajë, datat, Afatin, Vlerën, Objektin. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Kërkesa e hartuar ne kete menyre le vend per interpretim dhe keqinterpretim, pasi sipas LPP-se si deshmi per pervojen e meparshme kerkohet deri ne 40 % e vleres kontrates te realizuara ne tri vitet e fundit. Ne rastet kur sherbimet jane kryer me subjekte shtetore duhet te paraqiten

vertetimin e realizimit me sukses leshuar nga autoriteti perkates kontraktor, i cili duhet te permbaje, afatin, vleren, bojektin ne rastin kur sherbimet jane kryer me subjekte private duhet te paraqiten vetem faturat tatimore.

Kjo per arsyen pasi disa kontrata me institucione te rendesise se vecante shteterore jane kontrata te klasifikuara ne nivelin "Sekret Shteteror" dhe nuk mund te paraqiten cka e ka parashikuar dhe ligjvenesit ku ka percaktuar se per kontratat e realizuara me institucione shteterore kerkohen vetem vertetimi ne realizimit me sukses leshuar nga autoriteti perkates kontraktor, i cili duhet te permbaje, afatin, vleren, objektin. Autoriteti kontraktor duhet te riformuloje kriterin si me poshte, ne menyre te mos kete keqinterpretime dhe te mos perjashtoj firmat qe kane realizuar kontrata me institucionete rendesise vecante ne nivelin "Sekret Shteteror".

Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi ku te kete realizuar sherbime te ngjashme, ne nje vlere sa 40 % e fondit limit qe prokurohet, te realizura gjate tre viteve te fundit nga data e hapjes se tenderit. Per te vertetuar kete Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetime te cilesise se kryerjes se saj.

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

VII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 10 arme krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm,
- Jo me pak se 120 punonjes shërbimi të certifikuar,
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,

- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

Kerkesa e mesiperme ku kerkohet... "Te kete ne liste emerore te pakten tridhjetë punonjes te licensuar nga DPQ", eshte jo proporcionale me objektin e kontrates.

Ne nenin 46 te Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: [...]

Ndersa ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, percakohet se: [...]

Ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 5, gerrat "a", "b" dhe "c", parashikohet si me poshte: [...].

Shoqeria jone gjykon se, vendosja e kriterëve te vecanta per kualifikim ka si synim kryesor qe t'i sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret per kualifikim duhet te hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, pjesemarres ne keto procedura, per realizimin e sukses te kontrates me qellim zgjerimin e rrethit te pjesmarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 1 pika 2 te LPP i cili parashikon shprehimisht se [...].

Referuar sa me sipër, shoqeria jone gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për ... "Te kete ne liste emerore te pakten 165 punonjes te licensuar nga DPQ" eshte joproporcionale pasi nuk ploteson volumin dhe permasat e kontrates qe prokurohet, ne kushtet kur kerkohet qe sherbimi i ruajtjes te kryhet ne 36 (tridhjetë e gjashtë) vendroje me tre tume, me 4.98 punonjes sherbimi. Numri i punonjesve te sherbimit i percaktuar ne kriterin e vecante te kualifikimit eshte joproporcional me objektin e prokurimit, dhe ndikon ne uljen e konkurences ndermjet operatoreve ekonomike si dhe bie ndesh me frymen e ligjit i cili parashikon se kriteret per kualifikimin duhet te harton ne ate menyre qe te stimulojne pjesmarrjen e sa me shume ofertuesve ne proceduren e prokurimit. Per autoritetin eshte e rendesishme te vertetohet se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (ne rastin konkret punonjes sherbimi), mjaftueshem sa te jete ne gjendje te realizoje objektin e prokurimit dhe per kete arsye, autoriteti kontraktor duhet te marre masa per modifikimin e kriterit ne fjale, ne perputhje me permasat e kontrates qe do te prokurohet (50 punonjes sherbimi per Qarkun Kukes dhe 129.28 per Qarkun Shkoder).

Kerkesa e mesiperme ku kerkohet... "Te kete pergjegjes sherbimesh", eshte jo proporcionale me objektin e kontrates. Per autoritetin eshte e rendesishme te vertetoje se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike, mjaftueshem sa te jete ne gjendje te realizoje kontraten, objekt i ketij prokurimi. Percaktimi i pergjegjesve te sherbimit, ka te beje me organizimin e brendshem te shoqerise dhe artifica te tilla nuk i sherbejne qellimit per te cilin vendoset kriteri, perkundrazi kufizojne pjesmarrjen dhe konkurrencen.

Per sa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses per pergjegjes sherbimi

Kerkesa e mesiperme ku kerkohet ... "krahu" "arme brezi", ... "Te autorizim per mbajtje arme" si dhe 26 arme krahu dhe 8 arme brezi, eshte nje kerkese qe vjen ne kundershtrim me legjislacionin ne fuqi.

Me vendimin Nr. 15/2017, date 18.01.2017, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi me i larte qe merr vendime administrativisht perfundimtare, ka vendosur qe kerkesa per arme dhe autorizim armesh ne kete faze te prokurimit, eshte nje kerkese ne kundershtrim me ligjin. Konkretisht KPP ka vendosur: [...]

Per sa me siper, kerkojme heqjen nga kriteri te kerkeses per "arme Krahu", "arme brezi", "autorizim per mbajtje arme".

Kjo kerkese e dubluar nga Autoriteti Kontraktor plotesohet plotesisht ne kerkesen e percaktuar "Operatori ekonomik duhet te disponoje 28 arme krahu, kategoria 1.3.A vertetuar me:

- Autorizim per blerje armesh leshuar nga Drejtoria e Policise Shtetit,*
- Kontrate Shitblerje,*
- Fatura Shitblerje dhe*
- Pagesen Bankare*

Operatori ekonomik duhet te disponoje 8 arme brezi, kategoria 1.3 A vertetuar me:

- Autorizim per blerje armesh leshuar nga Drejtoria e Policise Shtetit,*
- Kontrate Shitblerje,*
- Fatura Shitblerje dhe*
- Pagesen Bankare*

Kerkesa e mesiperme ku kerkohet ... "pese operatore" eshte nje kerkese qe vjen ne kundershtrim me legjislacionin ne fuqi dhe vendimet e komisionit te prokurimeve publike pasi eshte nje numer teper i ekzagjuar. Per autoritetin kontraktor eshte e mjaftueshme te provohet nga operatoret ekonomik se disponojne operator pa vene kufi mbi numrin e tyre.

Madje, Komisioni i Prokurimeve Publike me vendimin Nr. 15/2017, date 18.01.2017, si organi me i larte qe merr vendime administrativisht perfundimtare, ka vendosur qe kerkesa per operatore salle, eshte nje kerkese e ekzagjuar.

Konkretisht KPP ka vendosur: [...]

Per sa me siper kerkojme ndryshimin e kerkeses duke kerkuar disponim te operatoreve pa permendur numer.

VIII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimti, autoriteti ka kerkuar:

- Kerkesa e mesiperme ku kerkohet..*
- Nuk ka masa administrative per vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*
- Nuk ka shkelje te konstatuara per vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*
- Nuk ka ngjarje te ndodhura per vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*
- Nuk ka masa per ngjarje per vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*

eshte nje kerkese qe vjen ne kundershtrim me legjislacionin ne fuqi dhe bie ndesh parimet e LPP-se.

Ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregulave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 5, gerrat "a", "b" dhe "c", parashikohet si me poshte:[...]

Shoqeria jone gjykon se, vendosja e kriterëve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me suksese kontratës,

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatoreve ekonomike, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këtë procedurë, për realizimin e suksese kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatoreve ekonomike në respekt të nenit 1 pikë 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: [...]

Shoqeria jone gjykon se kërkesa e referuar më sipër është diskriminuese dhe e egzagjyeruar pasi nuk siguron një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë ata që kanë masa administrative dhe ata që nuk kanë masa administrative.

Legjislacioni i prokurimit publik i ka përcaktuar qartë rastet kur një operator mund të përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi dhe ky rast nuk është i përfshirë.

- Për sa më sipër, kërkojmë heqjen e kërkesës që ka të bëjë me
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka ngjarje të ndodhura për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka masa për ngjarje për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi.

IX) Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 18 automjete dhe 6 motorra, në emer të shoqërisë ose në rastin kur janë në emer të administratorit, apo të marra me qera nga një person juridik apo fizik tjetër.

Për automjetet në pronesi duhet të paraqiten:

- Certifikatat e Pronesise
- Lejet e qarkullimit.
- Certifikate e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara
- Siguracionet

Për automjetet me qera duhet të paraqiten:

- Kontraie qeraje të lidhur para noterit
- Certifikatat e Pronesise
- Lejet e qarkullimit
- Certifikate e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara
- Siguracionet

Faturat tatimore të prera nga qiradhenesi dhe pagesën përkatëse bankare për periudhën e marrjes së mjeteve me qera.

Kërkesa për paraqitjen e 18 automjete dhe 6 motora" është një kërkesë e paligjshme dhe jo në proporcion me volumin e realizimit të kontratës pasi kemi vetëm 3 objekte të grupuara në një

perimeter te caktuar ku nje automjet ose nje motor per objekt eshte i mjaftueshem per kryerjen e sherbimit pasi diskriminon operatoret ekonomik qe disponojne automjete dhe jo motora.

Nga sa me sipër, kerkojme ndryshimin e kriterit si ne vijim:

5. Operatori ofertues duhet te vertetoje se disponon 3 motora ose 3 automjete ne pronesi ose me kontrate qeraje per nderhyrje ne raste nevoje. Mjetet duhet te jene te pajisur me dokumentacionin perkates (leje qarkullimi, kolaudim i mjetit dhe sigurimi i detyrueshem, taksa te vlefshme certificate pronesie).

X) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

4. Operatori ekonomik duhet te disponoje jo me pak se 30 dedektore dore elektronike, jo me pak se 30 spray neuoparalizues, jo me pak se 30 radio komunikimi dhe jo me pak se 30 cope jelek antiplumb.

Ne rastet kur pajisjet jane blere brenda vendit operatori duhet te paraqese:

- Fature Tatimore e Shitjes e firmosur nga te dyja palet dhe e vulosur nga shitesi;
- Pagesen qe verteton vleren e blerjes se paisjeve;
- Deklarimin e fatures tatimore te shitjes ne sistemin elektronik te tatimeve;

Ne rastet kur keto kapacitete jane blere jashte vendit operatori duhet te paraqese:

- Deklaraten e zhdoganimit nepermjet se ciles vertetohet zhdoganimi i paisjeve;
- Xhirimin Bankar qe verteton pagesen e vleres se blerjes se paisjeve;
- Deklarimin e fatures tatimore te shitjes ne sistemin elektronik te tatimeve;

Autoriteti kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te paisjeve dhe ne rast se konstaton se operatori ekonomik nuk disponon realisht pajisjet, autoriteti pervec se do ta skualifikojë, por do te kryejë denoncim dhe ne APP per qellim te nenit 13 te LPP-se.

Ne rastet e bashkimit te operateve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarrës ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikimi.

Kerkesa e mesiperme eshte nje kerkese qe vjen ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor duhet te percaktojë qarte dokumentin qe verteton paisjet ose me vertetim nga Drejtoria e Policise Qarkut perkates ose me fatura tatimore dhe mos te dublojë kerkësat per dokumentacion dhe jo te kerkojë dokumenta pa lidhje qe se din as vete cfare kerkon ose pse i duhet xhirimi bankar e aq me teper Deklarimin e fatures tatimore te shitjes ne sistemin elektronik te tatimeve, tagra te cilat i takojne institucioneve te tjera biles ligjvenesit per te lehtesuar bizneset edhe vertetimet e tatimeve per detyrime behen me deklarim.

Madje, kerkesa per radio komunikimi, dedektor, spray bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, date 20.12.2017, per kete arsye duhet hequr.

Se pari, kerkesa per paraqitjen e paisjeve speciale bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, date 20.12.2017 pasi sic edhe thekson ky rekomandim keto paisje presupozohet qe disponojne operatoret nga momenti licencimit te tyre:

- Te mos perlllogariten shpenzimet per uniforrnen, si dhe te mos kerkohet paraqitja e mjeteve ndihmese si p.sh elektrik dore etj, pasi keto kriteret permbushen nga shoqëria qe ne momentin e licensimit te saj.

Per kete arsye duhet hequr nga kriteri i kualifikimit kerkesa per, radio komunikimi, dedektor, spray, jelek antiplumb.

Se dyti, edhe sikur te pranojme per nje moment se kerkesa per paraqitjen e pajisjeve speciale eshte e ligjshme (nuk eshte) pasi numri per mjete speciale te sherbimit, eshte teresisht diskriminues dhe jo ne proporcion me objektin e procedures.

Referuar specifikimeve teknike dhe grafikut te sherbimit rezulton te jene 36 (tridhjet e gjashte vendroje) dhe kerkesa per 30 cop pajisje, emertimet e te cilave jane te permendura me siper eshte e jo ne proporcion me objektin e prokurimit pasi 1 pajisje per vendroje do te mjaftonte.

Kerkesa e mesiperme ku kerkohet ... "jelek antiplumb" eshte nje kerkese qe vjen ne kundersiztim me legjislacionin ne fuqi dhe vendimet e komisionit te prokurimeve publike pasi nuk kemi te bejme me sherbim transport vlerash monetare 1.3.B por kemi te bejme me sherbim ruajtje kat 1.3.A.

Per sa me siper, kerkojme heqjen e kesaj kerkese nga kriteri kualifikues.

XI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

Vertetim leshuar nga Bashkia/Niesi Administrative me ane te se cilit te vertetohet shlyerja e taksave per vitin 2016-2017-2018, per adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik, sipas Ekstraktit Historik leshuar nga QKR.

Kerkese perseritur dy here e ekzagjeruar dhe ne kundersiztim me ligjin Legjislacioni i prokurimit publik i ka percaktuar qarte rastet kur nje operator mund te perjashtohet nga pjesmarrja ne nje procedure prokurimi dhe ky rast nuk eshte i perfshire aq me teper kerkohet per tre vite kur mund te kerkohet i vitit te fundit dokumentacion i tepert dhe qe nuk i sherben autoritetit Kontraktor.

Kerkojme heqjen e ketij kriteri ose te kerkohet vertetim per vitin e fundit per njesit administrative ku ndodhen objektet.

XII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

1. Operatori ekonomik gjate tre viteve te fundit 2016-2017-2018 nga data e hapjes se tenderit duhet te kete xhiro mesatare vjetore nje viere jo me te vogel se 166,000,000 leke.

Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarrjes ne perputhje me perqindien e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikimi.

Ky kriter duhet te modifikohet duke kerkuar vertetim nga Administrata Tatimore jo me pak se 40% e mesatares per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit.

XIII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

2. Operatori ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv (te mos kete dale me humbje) te qendrueshem gjate tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje te bilanceve te ketyre tre viteve, te paraqitur prane autoritetit perkates, te shoqeruara nga akt ekspertize e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarrjes ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikimi.

Ky kriter eshte ekzagjeruar duhet te modifikohet dhe te kerkohet Operatori ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv (te mos kete dale me humbje) te qendrueshem gjate tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopjete bilanceve te nje prej tre viteve te paraqitur prane autoritetit perkates, te shoqeruara nga akt ekspertize e kryer nga Eksperti kontabel I autorizuar. Ne rastet e bashkimit te operatoreve

ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarres ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne te kuntiert perben kusht s'kualifikim.

XIV) Ne kriteret e vecanta te kualifikimti, autoriteti ka kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te zoteroje Licence/Autorizim per ngritjen dhe shfrytezimin e sistemit te pavarur te radiokomunikacionit dhe radioalarmit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" me zone mbulimi Qarkun Kukes dhe Qarkun Shkoder.

Edhe kjo eshte kerkese e egzagjeruar prandaj ky kriter duhet te modifikohet dhe te kerkohet; Operatori ekonomik duhet te zoteroje Licence/ Autorizim per ngritjen dhe shfrytezimin e sistemit te pavarur te radiokomunikacionit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" me zone mbulimi rrethi Tropoje dhe rrethi Shkoder ku ndodhen objekte dhe zbatohet kontrata.

Kerkojme te hiqet kerkesa radioalarmit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" pasi kemi te bejme me ruajtje fizike dhe jo me verifikim alarmi.

XV) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

Operatori Ekonomik ofertues duhet qe ne stafin teknik te kete edhe 2(dy) punonjes i diplomuar ne bachelor per Elektronik / Telekomunikacioni / Informatik / Kompjuterike / Megatronike. Per te vertetuar disponimin e ketij kapaciteti, operatori duhet te paraqese: Diplomen dhe Kontraten e Punes e cila duhet te mbuloje te gjithe periudhen e sherbimit i cili duhet te figuroje ne listpagese I siguruar. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter ne te kundert perben kusht per s'kualifikim.

Kerkesa e mesiperme eshte nje kerkese qe vjen ne kundershtim me legjislacionin ne fuqi dhe bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr.15166 dhe nr.1858, date 20.12.2017, pasi sic edhe thekson ky rekomandim ky informacion nuk mund te kerkohet me dokumentacionin dhe pajisjet e referuara me siper ne kriter por mjafton paraqitja e Aktit te Miratimit:

- Ne lidhje me kriterin e Qendrës së Kontrollit, te kerkohet paraqitja e Aktit të Miratimit të Qendres së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit ne Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF.

Akoma me tej, rezulton se ky eshte nje kriter i dubluar pasi po ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

"3. Operatori ofertues duhet te kete Qender te Menaxhimit dhe te Kontrollit per ushtrim aktiviteti ne Qarkun ku kerkohet sherbimi te konfirmuar me akt miratimin perkates shoqeruar me vertetim nga Drejtoria e Policise se Qarkut Kukes dhe Shkoder."

Per autoritetin kontraktor e nevojshme eshte qe oe te vertetojne disponimin e salles operative dhe dokumenti qe e verteton kete kapacitet eshte akti i miratimit i leshuar nga DVP. Kerkesa qe operatori ekonomik krahas ketij dokumenti, te paraqese edhe nje sere dokumentash te tjere eshte nje kerkese e panevojshme dhe vetem sa rendon/veshtirson poziten e operatoreve ekonomik ne pergatitjen e dokumentacionit. Akoma me tej Autoriteti ka kerkuar qe te jete ne listepagesa por nuk ka percaktuar si kriter as paraqitjen e liste pagesave dhe peridhen qe duhet te jete i siguruar. Per sa me siper, kerkojme heqjen e ketij kriteri.

XVI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te disponoje jo me pak se 2 (dy) Sistem Radiokomunikimi:

Per te plotesuar kerkesen e mesiperme OE duhet te paraqese fatura tatimore shitje, pagesat perkatese dhe deklarimin e faturave ne sistemin elektronik te tatimeve.

Kerkojme heqjen e ketij kriteri pasi eshte kerkuar licence / Autorizim per ngritjen dhe shfrytezimin e sistemit te pavarur te radiokomunikacionit dhe radioalarmit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise", me zone mbulimi Qarkun Kukës dhe Qarkun Shkoder, ku jane te percaktuar sistemet e Radiokomunikimit, aq me teper kerkohet dokumentacion pa lidhje si fatura tatimore dhe deklarimin ne SET (sistemi elektronik i tatimeve) kur ky dokument plotesohet me paraqitjen e QKSH dhe faturave tatimore per instalimin e paisjeve te salles operative. Deklarimi ose jo ne SET nuk i perket Autoritetit Kontraktor por jane institucione te tjera qe kontrollojne keto deklarime per AK eshte e mjaftueshme qe te jene kapacitetet teknike.

Perfundimisht kerkojme:

- 1. Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses;*
- 2. Ndarjen ne 3 (tre) lote, ndryshimin dhe specifikimin e kriterëve dhe dst-ve sipas percaktimeve te mesiperme;*
- 3. Kthim pergjigje brenda afatit te percaktuar ne nenin 63 te LPP-se.*

II.3. Autoriteti kontraktor me anë të shkresë nr. 3513/3 prot., datë 22.08.2019 i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht atë, me argumentimin si më poshtë vijon:

[...]

1. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit se organizimi nga ana e autoritetit kontraktor ne nje lot eshte jopropocionale pasi e tejkalon volumin dhe permasat e kontrates qe prokurohet, ne kushtet kur kerkohet qe sherbimi i ruajtjes te kryhet ne 3 (tre) HEC, Vau i Dejes, Koman, Fierze te cilat administrativisht jane te organizuara ne njesi te vecanta dhe shtrihen ne dy Qarqe, respektivisht 10 vendroje me tre tume ne HEC Fierze, 12 vendroje me tre tume ne HEC Koman, 14 vendroje me tre tume ne HEC Vau i Dejes me 4.98 punonjes sherbimi per vend/roje. Organizimi ne nje lot te vetem sipas kriterëve te kualifikimit eshte joproporcional me objektin e prokurimit, dhe ndikon ne uljen e konkuresces ndermjet operatoreve ekonomike si dhe bie ndesh me frymen e ligjit i cili parashikon se kriteret per kualifikimin duhet te hartohen ne ate menyre qe te stimulojne pjesmarrjen e sa me shume ofertuesve ne proceduren e prokurimit. Per autoritetin eshte e rendesishme te vertetohet se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (ne rastin konkret punonjes sherbimi mjete sherbimi etj.) mjaftueshem sa te jete ne gjendje te realizoje objektin e prokurimit dhe per kete arsye autoriteti kontraktor duhet te marre masa per modifikimin e kriterit ne fjale, ne perputhje me permasat e kontrates qe dote prokurohet duke e ndare ne 3 (tre) lote, komisioni relaton:

Ne nenin 9, pika 5 te VKM 914, date 29.12.2014 citohet: "Kontrata ndahet ne lote, kur perbehet nga pune, mallra apo sherbime, homogjene ose te ngjashme, dhe kur vlere e kombinuar eshte e tille qe vetem nje numer i kufizuar operatoresh ekonomike do te ishin ne gjendje t'i siguronin ato. Kjo menyre mund te perdoret vecanerisht per te nxitur pjesemarrjen e biznesit te vogel e te mesem dhe per te ulur kostot administrative te autoritetit kontraktor. Ne cdo rast, kur kontrata ndahet ne lote, per efekt te perzgjedhjes se procedures se prokurimit, vlere limit e kontrates do te jete shuma e vleres se secilit lot".

Komisioni per shqyrtimin e ankeses konstaton se sherbimet e kerkuara ne proceduren e prokurimit ne shqyrtim jane plotesisht homogjene dhe ndarja ne lote nuk do te sillte nje shtim te konkurrences. Nese procedura do te ndahej ne lote, fondi limit per secilin lot do te ishte si me poshte:

OBJEKTI	VENDROJE	FONDI LIMIT
HEC FIERZE	10	115,496,198
HEC KOMAN	12	138,595 437
HEC VAU I DEJES	14	161,694 677

Fondi limit per lotin me te vogel do te ishte 115.496.198 leke dhe, ne kete menyre, nuk do te krijonte mundesine per pjesemarrje per biznesin e vogel dhe te mesem. Gjithashtu, ne rastin me te mire, nuk do te ulte kostot administrative per autoritetin kontraktor. Duke menaxhuar tre kontrata te ndryshme per autoritetin kontraktor do te rritej niveli i riskut.

Prokurimi si nje sherbim i vetem nuk pengon pjesemarrjen e asnjë operatori ekonomik pasi ata mund te paraqesin oferte ne perputhje me nenin 74, pika 1 te VKM 914, date 29.12.2014 citohet: "Oferta mund te paraqitet nga nje bashkim operetoresh ekonomike ku njeri prej te cileve i perfaqeson te tjeret gjate procedures dhe ne rast perzgjedhjeje edhe gjate zbatimit te kontrates. Ne oferte duhet te percektohet pjesa e sherbimit; punes ose fumizimit, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi". Komisioni per shqyrtimin e ankeses gjykon se kerkesa e operatorit ekonomik per ndarjen kontrates ne lote eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.

2. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit per piken 2. 9 "Kohezgjatja e Kontrates ose Afati Kohor per Ekzekutim" te dokumentave standart te tenderit, mungon afati kohor i fillimit dhe i perfundimit si dhe te vendoset informacioni nese ditet mesatare mujore do te jene 30.41 apo 30.44 dite gjate perlllogaritjes se turnit te dyte dhe te trete apo do te aplikohet nje mesatare tjeter, komisioni relaton:

Ne piken 2.9 te DST citohet:

2. 9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj 36 ose ditë □□□□

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

2.9.1 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: 36 (tridhjetë e gjashtë) ose ditë: •••• (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër(jo më shumë se (4) vjet)

Ose duke filluar nga ••/••/•• (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më ••/••/•• (dd/mm/vvvv)

Nga sa paraqitet me siper duket qarte se afati i parashikuar i marreveshjes kuader eshte 36 muaj nga nenshkrimi i marreveshjes kuader. Autoriteti kontraktor nuk eshte i detyruar te plotesoje cdo pike te pikes 2.9 te DST per sa kohe qe aty DST japin mundesine te fiksosh muajt ose ditet. Duket qarte se kohezgjatja e marreveshjes kuader eshte 36 muaj nga data e nenshkrimit te saj dhe eshte

e parendesishme data e sakte e fillimit te sherbimit, e dhene kjo qe, ne fazen aktuale te prokurimit, nuk dihet saktesisht nga autoriteti kontraktor. Komisioni per shqyrtimin e ankeses gjykon se kjo kerkese e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.

3. Ne lidhje me pretendimin e ankimesit se ne Shtojcen 1 "Formulari i Ofertes Ekonomike", autoriteti ka kerkuar edhe shpenzime shtese: Se pari, kerkesa per Shpenzimet per nderlidhje (bazuar ne tarifat vjetore te Akep per Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin) bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, date 20.12.2017 pasi sic edhe thekson kv rekomandim keto pajisje presupozohet qe i disponojne operatoret nga momenti i licencimit te tyre, Se dyti, edhe sikur te pranojme per nje moment se kerkesa per llogaritjen ne preventiv eshte e ligjshme (nuk eshte) nuk eshte percaktuar numri i radiove dhe se kerkesa AKEP Radiokomunikim dhe Radioalarm eshte kerkuar ne range Qarku kurse objektet ndodhen ne dy rrethe Tropoje dhe Shkoder cka rrit ne menyre fiktive koston kur llogaritet ne shkalle qarku, eshte teresisht diskriminues dhe jo ne proporcion me objektin e procedures. Nga sa me siper, kerkojme heqjen e kerkeseve se referuar me siper, komisioni relaton:

Ne percaktimin e fondit limit autoriteti kontraktor ka parashikuar edhe disa shpenzime qe parashikohet te kryhen nga operatoret ekonomike qe do te kryejne sherbimin. Keto kosto jane vendosur ne tabelen permbledhese si me poshte:

Preventiv të koston për 1 roje në muaj, për 1 vendroje me shërbim 24 orë

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /Muaj
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Shpenzimet per ndërlidhje (bazuar në tarifat vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin)		
6	Kapacitetet mbeshtetese (transporti i punonjesve pasi kemi te bejme me objekte ne nje distanc te larget)		
7	Shpenzimet per sigurimin e pergjegjesis profesionale		
8	Shpenzimet administrative		
9	Fitimi i shoqërisë		
	Vlera totale pa tvsh për 1 roje në muaj		
	Vlera totale me tvsh për 1 roje në muaj		

Komisioni per shqyrtimin e ankeses konstaton se shpenzimet e parashikuara jane te mbeshtetura ne ligj. Njekohesisht komisioni konstaton se ne asnje pjese te DST nuk eshte kerkuar qe ndonje prej ketyre zerave te shpenzimit te kete nje limit minimal, nen te cilin operatori ekonomik te skualifikohet. Ne kete menyre, operatoret ekonomike te cilet gjykojne se keto shpenzime i kane te barabarta me zero, mund te parashikojne kete vlere ne table. Komisioni per shqyrtimin e ankeses

gjykon se kjo kerkese e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.

4. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit se ne Shtoca 12 "Termat e References", autoriteti ka publikuar kriteret e kualifikimit qe duhet te paraqesin operatoret ekonomik ku kerkohet heqja e kriterëve te kualifikimit nga shtojca 12 "Termat e References" dhe nga cdo rubrike tjeter qe nuk ka te beje me shtojcen 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" dhe lenien e tyre vetem ne shtojcen 8, komisoni relaton:

Ne termat e references jane parashikuar disa nga kerkesat e kriteret e vecanta te kualifikimit dhe kjo gje mund te shkaktoje konfuzion tek operatoret ekonomike dhe eshte e arsyeshme te hiqen. Komisioni per shqyrtimin e ankeses gjykon se kjo kerkese e operatorit ekonomik duhet te pranohet.

5. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit mbi kriterin 3.1 kapaciteti ligjor/ profesional i opereveve ekonomik pika 4 se Operatori ofertues duhet te paraqese Certifikata per punonjes sherbimi nenkategoria 1.3.A per 165 punonjes sherbimi, prej te cilave:

- 45 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukes, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 30 punonjes;

- 120 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 100 punonjes. Kerkesa per paraqitjen e 165 certifikatave nuk eshte ne perpjestim te drejte me numrin e punonjesve per zbatim e kontrates, ne te cilet eshte specifikuar se sherbimi do te kryhet ne 36 vendroje me 4.98 punonjes per vendroje me tre tume (tumi I, II dhe III-te) ne total bejne 179.8 punonjes sherbimi.

Ne nenin 46 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, pika 3, parashikohet [...], komisoni relaton:

Ne kerkesat e vecanta te kualifikimit, tek pjesa 3.3 Kapaciteti teknik, ne pikat 4 dhe 5 kerkohet:

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukes, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 10 arme krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,

- Grup të gatshëm,
- Jo me pak se 120 punonjes shërbimi të certifikuar,
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

Komisioni llogariti numrin e punonjesve te sherbimit qe nevojitet per te plotesuar sherbimin ne 10 vendroje per qarkun e kukesit dhe 26 vendroje per qarkun e shkodres. Nga llogaritjet rezulton se numri i nevojshem i punonjesve te sherbimit eshte 49.8 punonjes sherbimi per qarkun e kukesit dhe 129.48 punonjes sherbimi per qarkun e shkodres. Komisioni per shqyrtimin e ankeses konstaton se, duke krahasuar numrin total te punonjesve te sherbimit te nevojshem me ata te kerkuar ne kerkesen per kualifikim rezulton se ne kerkese jane parashikuar me pak punonjes si me poshte:

QARKU	NUMRI I PUNONJESVE TE SHERBIMIT I KERKUAR NE KERKESEN PER KUALIFIKIM	NUMRI I PUNONJESVE TE SHERBIMIT I NEVOJSHEM PER KRYERJEN E SHERBIMIT
KUKES	45	49.8
SHKODER	120	129.48

Ne kerkesen per kualifikim kerkohen me pak punonjes sherbimi se numri i nevojshem per te kryer sherbimin. Ne kete menyre kjo kerkese eshte ne perpjesetim me permasat e kontrates, Kerkesat per kualifikim i sherbejne autoritetit kontraktor per tu bindur se operatori ekonomik i ka kapacitetet per te realizuar kontraten dhe komisioni gjykon se kerkesa eshte ne perputhje me ligjin.

Persa i perket pikes lidhur me heqjen e kerkeses per paraqitjen e autorizimit te armeve, komisioni konstaton se ne kerkesen per kualifikim nuk eshte kerkuar paraqitja e autorizimit per armet, por eshte kerkuar paraqitja e nje vertetimi ku te jepet informacion, nder te tjera, edhe per numrin e armeve qe disponon shoqeria. Komisioni per shqyrtimin e ankeses gjykon se keto kerkese te operatorit ekonomik jane te pa mbeshtetura ne ligj dhe nuk mund te pranohen.

6. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit mbi kriterin 3.3 kapaciteti teknik pika 1 mbi Sherbimet e ngjashme te kryera ku kerkohet qe Autoriteti kontraktor te riformuloie kriterin si me poshte, ne menyre te mos kete keqinterpretime dhe te mos perjashtoj firmat qe kane realizuar kontrata me institucione te rendesise vecante ne nivelin "Sekret Shteteror": Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi ku te kete realizuar sherbime te ngjashme, ne nje vlere sa 40 % e fondit limit qe prokurohet, te realizura gjate tre viteve te fundit nga data e hapjes se tenderit. Per te vertetuar kete Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetime te cilesise se kryerjes se saj. Ne rastin e perves se meparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara, komisioni relaton:

Ne kerkesat e vecanta te kualifikimit, tek pjesa 3.3 Kapaciteti teknik, ne piken 1 kerkohet:

1. Shëbime të ngjashme:

- Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme kat. (1.3.A) në një vlerë sa 166,000,000 leke, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së tenderit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët duhet të paraqesin:

Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte shtetërore duhet të paraqiten Kontrat/ kontrata të realizuara, shoqëruar me Vërtetimin e realizimit me sukses lëshuar nga autoriteti përkatës kontraktor, i cili duhet të përmbajë, Afatin, Vlerën, Objektin. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimit dhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Ose

- Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte private duhet të paraqiten Kontrat/ kontrata të realizuara të shoqëruara me Faturat përkatëse tatimore të shitjes të firmosura dhe vulosura nga të dyja palët dhe Vërtetimin e përfundimit me sukses të saj, lëshuar nga subjekti privat i cili duhet të përmbajë, datat, Afatin, Vlerën, Objektin. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimit dhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Ne nenin 28, pika 3 të VKM 914, datë 29.12.2014, ndër të tjera citohet: [...].

Nisur nga sa më sipër, komisioni për shqyrtimin e ankesës gjykon se kërkesa duhet të riformulohet si më poshtë:

"1. Shërbime të ngjashme:

- Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme kat. (1.3.A) në një vlerë jo më të vogël se 166,000,000 leke, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së tenderit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët duhet të paraqesin:

Ne rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte shtetërore duhet të paraqiten vërtetimet e realizimit me sukses lëshuar nga autoriteti përkatës kontraktor si dhe faturat tatimore përkatëse ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimit dhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Ose

- Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte private duhet të paraqiten faturat përkatëse tatimore të shitjes të firmosura dhe vulosura nga të dyja palët ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimit dhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik".

Komisioni për shqyrtimin e ankesës gjykon se kjo kërkesë e operatorit ekonomik duhet të pranohet pjesërisht. Njesia e prokurimit të modifikojë kërkesën sipas riformulimit të mësipërm.

7. Në lidhje me pretendimin e ankuesit mbi kriterin 3.3 kapaciteti teknik pika 4 dhe 5 mbi vërtetimet e kërkuara nga Drejtoria e qarqeve Kukës dhe Shkoder, Kërkesa ku kërkohej "Të kete në listë emergjente të pakten tridhjetë punonjës të licensuar nga DPQ: është jo proporcionale me objektin e kontratës. Referuar sa më sipër, shoqëria jone gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për ... "Të kete në listë emergjente të pakten 165 punonjës të licensuar nga DPQ është joproporcionale pasi nuk plotëson vëllimin dhe përmasat e kontratës që prokurohet në kushtet kur kërkohej që shërbimi i ruajtjes të kryhet në 36 (tridhjetë e gjashtë) vendndodhje me tre tume. me 4.98 punonjës shërbimi. Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë,

ne perputhje me permasat e kontrates qe do te prokurohet (50 punonjes sherbimi per Qarkun Kukes dhe 129.28 per Qarkun Shkoder), si dhe kerkesa.... "Te kete pergjegjes sherbimesh", eshte jo proporcionale me objektin e kontrates. Kerkon heqjen e kerkeses per pergjegjes sherbimi, komisioni relaton:

Ne kerkesate vecanta te kualifikimit, tek pjesa 3.3 Kapaciteti teknik, ne pikat 4 dhe 5 kerkohet:

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukes, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 10 arme krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm,
- Jo me pak se 120 punonjes shërbimi të certifikuar,
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

Komisioni per shqyrtimin e ankeses konstaton se ne kerkessat per kualifikim nuk ekziston kerkesa: "Te kete ne liste emerore te pakten tridhjte punonjes te licensuar nga DPQ". Ne kete menyre kjo pike e ankeses nuk qendron,

Sa i perket pikes per heqjen e kerkeses per pergjegjesit e sherbimit, komisioni gjykon se pergjegjesit jane te domosdoshem per vete numrin e larte te vendrojeve dhe rendesine e objekteve qe ruhen. Kerkesa e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.

7.1 Ne lidhie me pretendimin e ankimuesit ku kerkohet te hiqen kerkesat per arme krahu dhe arme brezi pasi eshte nie kerkese qe vjen ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi..., komisioni relaton:

Ne kërkesat e vecanta te kualifikimit, tek pjesa 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike, ne pikat 4 kerkohet:

4. Certifikata per punonjes sherbimi nenkategoria 1.3.A per 165 punonjes sherbimi, prej te cilave:

- 45 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 “Per sherbimin privat te sigurise fizike”, leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukes, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 30 punonjes;
- 120 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 “Per sherbimin privat te sigurise fizike”, leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 100 punonjes;

Gjithashtu, ne kërkesat e vecanta te kualifikimit, tek pjesa 3.3 Kapaciteti teknik, ne pikat 4 dhe 5 kerkohet:

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukes, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 10 arme krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm,
- Jo me pak se 120 punonjes shërbimi të certifikuar,
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

Ndersa ne kërkesat e vecanta te kualifikimit, tek pjesa 3.3 Kapaciteti teknik, ne pikat 7 dhe 8 kerkohet:

7. Operatori ekonomik duhet të disponojë 28 armë krahu, kategoria 1.3.A vërtetuar me:

- Autorizim për blerje armësh lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit,

- Kontratë Shitblerje,
- Fatura Shitblerje dhe
- Pagesën Bankare

8. Operatori ekonomik duhet të disponojë 8 armë brezi, kategoria 1.3 A vërtetuar me:

- Autorizim për blerje armësh lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit,
- Kontratë Shitblerje,
- Fatura Shitblerje dhe
- Pagesën Bankare

Komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton se në total është kërkuar që operatori ekonomik që do të kryejë shërbimin të ketë në total 36 armë, nga të cilat 28 armë krahu dhe 8 armë brezi. Duke qenë se në total shërbimi do të kryhet në 36 vendroje, rezulton se është kërkuar një armë për çdo vendroje, një numër tepër i arsyeshëm duke patur parasysh rëndësinë e objekteve që ruhen. Kërkesa e operatorit ekonomik është e pa mbështetur në ligj dhe nuk mund të pranohet.

7.2 Në lidhje me vërtetimet e kërkuara nga Drejtoria e qarqeve Kukës dhe Shkoder për operatorët e qendrës së kontrollit, ai pretendon se "pese operatore" është një kërkesë që vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e komisionit të prokurimeve publike pasi është një numër tepër i ekzagjeruar. Për autoritetin kontraktor është e mjaftueshme të provohet nga operatorët ekonomik se disponon operator pa vënë kufi mbi numrin e tyre dhe kërkon ndryshimin e kërkesës duke kërkuar disponim të operatoreve pa përmendur numër, komisioni relaton:

Në kërkesat e vecanta të kualifikimit, tek pjesa 3.3 Kapaciteti teknik, në pikat 4 dhe 5 kërkohej:

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.75/2014,
- Jo më pak se 10 armë krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka ngjarje të ndodhura për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka masa për ngjarje për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Ka performancë pozitive.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm,
- Jo më pak se 120 punonjës shërbimi të certifikuar,
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.75/2014,
- Jo më pak se 18 armë krahu dhe 8 armë brezi,

- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje të ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa për ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës konstaton se në qarkun Kukës ndodhen 10 vendroje ndërsa në qarkun Shkoder ndodhen 26 vendroje. Në kërkesën për kualifikim janë parashikuar pesë Operatore të Qendres së Kontrollit për qarkun Kukës dhe pesë Operatore të Qendres së Kontrollit për qarkun Shkoder. Duke qenë se qendrat e kontrollit do të punojnë me tre turne, duke patur parasysh rendesinë e vecante të objekteve që do të merren në ruajtje dhe koeficientin e zëvendësimit, numri minimal i nevojshëm i Operatoreve për secilën qendër kontrolli është pesë. Kërkesa e operatorit ekonomik është e pa mbështetur në ligj dhe nuk mund të pranohet.

7.3 Në lidhje me pretendimin e ankimesit mbi vërtetimet e kërkuara nga Drejtoritë e qarqeve Kukës dhe Shkoder ku të vërtetohet se nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi, nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi, nuk ka ngjarje të ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi, nuk ka masa për ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi, dhe kërkon heqjen e tyre, komisioni relaton:

Në nenin 46 "Kualifikimi Ofertuesve", të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" ndryshuar, citohet: [...].

Bazuar në piken e mesipërme, autoritetit kontraktor i lind e drejta të kërkojë dokumentacion për të siguruar se operatori ekonomik ka reputacionin dhe besueshmërinë e nevojshme për kryerjen e shërbimit. Kërkesat e autoritetit kontraktor janë të mbështetura në ligj dhe janë të domosdoshme për një përzgjedhje sa më objektive. Në këtë mënyrë kërkesa e operatorit ekonomik është e pa mbështetur në ligj dhe nuk mund të pranohet.

8. Në lidhje me pretendimin e ankimesit mbi kriterin 3.3 kapaciteti teknik pika 10 mbi disponimin minimalisht të 18 automjeteve dhe 6 motorra, ku kërkon ndryshimin e kriterit si në vijim:

Operatori ofertues duhet të vërtetojë se disponon 3 motora ose 3 automjete, komisioni relaton: Në nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", të LPP, I ndryshuar, citohet: [...].

Bazuar në piken e mesipërme, autoritetit kontraktor i lind e drejta të kërkojë dokumentacion për të siguruar se operatori ekonomik ka makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike të nevojshme për kryerjen e shërbimit. Komisioni gjykon se numri i mjeteve është i ekzagjeruar, dhe mjetet e mjaftueshme do të ishin 6 automjete dhe 6 motorra. Motorrat janë të domosdoshëm për nderhyrje urgjente në rastet e bllokimit të rrugëve nga trafiku. Në këtë mënyrë kërkesa e operatorit ekonomik duhet të pranohet pjesërisht. Njesia e prokurimit ta modifikojë atë duke kërkuar 6 automjete dhe 6 motorra.

9. Në lidhje me pretendimin e ankimesit mbi heqjen e pikes 10 mbi disponimin e jo më pak se 30 dedektore dore elektronike, jo më pak se 30 spraj neuroparalizuesi, jo më pak se 30 radio komunikimi dhe jo më pak se 30 cope jelek antiplumb nga kriteri 3.3 "kapaciteti teknik" komisioni relaton:

Në nenin 46 "Kualifikimi i Ofertuesve", të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" ndryshuar, citohet: [...].

Bazuar në piken e mesipërme, autoritetit kontraktor i lind e drejta të kërkojë dokumentacion për të siguruar se operatori ekonomik ka makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike të nevojshme për

kryerjen e sherbimit. Komisioni gjykon se per numrin total prej 36 vendrojesh, sasia e paisjeve te kerkuara nuk eshte e ekzagjeruar. Ne kete menyre kerkesa e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.

10. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit mbi kriterin 3.1 Kapaciteti ligjor/professional i operatoreve ekonomike pika 5: "Vertetim leshuar nga Bashkia/Njesi Administrative me ane te se cilit te vertetohet shlyeria e taksave per vitin 2016-2017-2018, per adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik, sipas Ekstraktit Historik leshuar nga QKR" ankimuesi kerkon heqjen e ketij kriteri ose te kerkohet vertetim per vitin e fundit per njesit administrative ku ndodhen objektet, komisioni relaton:

Ne nenin 46 "Kualifikimi i Ofertuesve", te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" ndryshuar, citohet: [...].

Bazuar ne piken e mesiperme, autoritetit kontraktor i lind e drejta te kerkoje dokumentacion per tu siguruar se operatori ekonomik ka reputacionin dhe besueshmerine e nevojshme per kryerjen e sherbimit. Kerkesat e autoritetit kontraktor jane te mbeshtetura ne ligj dhe jane te domosdoshme per nje perzgjedhje sa me objektive. Ne kete menyre kerkesa e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.

11. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit mbi kriterin 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 1: "Operatori ekonomik gjate tre viteve te fundit 2016-2017-2018 nga data e hapjes se tenderit duhet te kete xhiro mesatare vjetore ne vlere jo me te vogel se 166,000,000 leke. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit" ku kerkon modifikimin e kriterit ne vertetim nga Administrata Tatimore jo me pak se 40 % e mesatares per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit, komisioni relaton:

Ne nenin 28, pika 4 te VKM 914, date 29.12.2014, nder te tjera citohet: [...].

Komisioni konstaton se fondi limit i kontrates qe prokurohet eshte 415,786,312 (Katerqind e pesembedhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e treqind e dymbëdhjetë) leke pa tvsh dhe vlere maksimale qe mund te kerkoje autoriteti kontraktor, bazuar ne piken e mesiperme, eshte 166.314.524 leke. Komisioni gjykon se kerkesa per realizimin e nje xhiroje mesatare vjetore prej 166.000.000 lekesh eshte e mbeshtetur ne ligj. Ne kete menyre kerkesa e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.

12. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit mbi kriterin 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike pika 2: " Operatori ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv (te mos kete dale me humbje) te qendrueshem gjate tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje te bilanceve te ketyre tre viteve, te paraqitur prane autoritetit perkates, te shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarres ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikimi, ku kerkon modifikimin e kriterit ne "Operatori ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv (te mos kete dale me humbje) te qendrueshem gjate tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopjete bilanceve te nje prej tre viteve te paraqitur prane autoritetit perkates, te shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel I autorizuar. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarres ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikim", komisioni relaton:

Ne nenin 46 "Kualifikimi i Ofertuesve", te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" ndryshuar, citohet: [...]

Bazuar ne piken e mesiperme, autoritetit kontraktor i lind e drejta te kerkoje dokumentacion per tu siguruar se operatori ekonomik ka reputacionin dhe besueshmerine e nevojshme per kryerjen e sherbimit. Komisioni gjykon se kerkesa per dokumentimin e nje aktiviteti pozitiv ne tre vitet e fundit eshte e mbeshtetur ne ligj. Ne kete menyre kerkesa e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.

13. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit mbi kriterin 3.3 kapaciteti teknik pika 2: "Operatori ekonomik duhet te zoteroje Licence/ Autorizim per ngritjen dhe shfrytezimin e sistemit te pavarur te radiokomunikacionit dhe radioa/alarmit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" me zone mbulimi Qarkun Kukes dhe Qarkun Shkoder" ku kerkon modifikimin e kriterit ne "Operatori ekonomik duhet te zoteroje Licence/Autorizim per ngitjen dhe shfrytezimin e sistemit te pavarur te radiokomunikacionit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" me zone mbulimi rrethi Tropoje dhe rrethi Shkoder ku ndodhen objekte dhe zbatohet kontrata", komisioni relaton:

Ne kerkesat e vecanta per kualifikim, nder te tjera, kerkohet:

"Operatori ekonomik duhet të zotërojë Liçencë/ Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të lëshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" me zonë mbulimi Qarkun Kukes dhe Qarkun Shkoder". Duke qene se 10 vendroje ndodhen ne qarkun Kukes dhe 26 vendroje ndodhen ne qarkun Shkoder, kerkesa e operatorit ekonomik eshte e pa arsyeshme dhe e pa mbeshtetur ne ligj. Ne kete menyre kerkesa e operatorit ekonomik nuk mund te pranohet.

14. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit mbi kriterin 3.3 kapaciteti teknik pika 9: "Operatori Ekonomik ofertues duhet qe ne stafin teknik te kete edhe 2 (dy) punonjes i diplomuar ne bachelor per Elektronik/ Telekomunikacioni/ Informatik/ Kompjuterike/ Megatronike. Per te vertetuar disponimin e ketij kapaciteti operatori duhet te paraqese: Diplomen dhe Kontraten e Punes e cila duhet te mbuloje te gjithë periudhen e sherbimit i cili duhet te figuroje ne listpagese i siguruar. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter ne te kundert perben kusht per s'kualifikim" ku kerkon heqjen e ketij kriteri si kriter i dubluar, komisioni relaton:

Ne kerkesat e vecanta per kualifikim, nder te tjera, kerkohet:

"Operatori Ekonomik ofertues duhet që në stafin teknik të ketë edhe 2 (dy) punonjes i diplomuar ne bachelor per Elektronik / Telekomunikacioni / Informatik / Kompjuterike / Megatronike. Per te vertetuar disponimin e ketij kapaciteti, operatori duhet te paraqese: Diplomen dhe Kontraten e Punës e cila duhet të mbulojë të gjithë periudhën e shërbimit i cili duhet te figuroje ne listpagese i siguruar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë këtë kriter në të kundërt përbën kusht për s'kualifikim".

Ne nenin 46 "Kualifikimi i Ofertuesve", te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" ndryshuar, citohet: [...].

Bazuar ne piken e mesiperme, autoritetit kontraktor i lind e drejta te kerkoje dokumentacion per tu siguruar se operatori ekonomik ka personelin e nevojshem per kryerjen e sherbimit. Komisioni gjykon se kerkesa per punesimin e 2 (dy) punonjesve te diplomuar ne bachelor per Elektronike /

Telekomunikacion / Informatike / Kompjuterike / Megatronike eshte e mbeshtetur ne ligj. Ne kete menyre kerkesa e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet. 15. Ne lidhie me pretendimin e ankimesit mbi kriterin 3.3 kapaciteti teknik pika 12: "Operatori ekonomik duhet te disponoje jo me pak se 2 (dy) Sisteme Radiokomunikimi: Per te plotesuar kerkesen e mesiperme OE duhet te paraqese fatura tatimore shitje, pagesat perkatese dhe deklarimin e faturave ne sistemin elektronik te tatimeve, ku kerkon heqjen e kriterit pasi eshte kerkuar License nga AKEP, komisioni relaton:

Ne nenin 46 "Kualifikimi i Ofertuesve", te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" ndryshuar, citohet: [...].

Bazuar ne piken e mesiperme, autoritetit kontraktor i lind e drejta te kerkoje dokumentacion per tu siguruar se operatori ekonomik ka personelin e nevojshem per kryerjen e sherbimit. Komisioni gjykon se kerkesa per disponimin e dy sistemeve te radiokomunikimit eshte e mbeshtetur ne ligj dhe rrit sigurine e komunikimit ne gjithe territorin. Ne kete menyre kerkesa e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.

Perfundimisht mbeshtetur ne nenin 63 te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar dhe nenin 78, pika 6, germa c, te V.K.M Nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, Komisioni per Shqyrtimin e Ankeses, me unanimitet, VENDOSI:

1. Te pranohet pjeserisht ankesa e operatorit ekonomik SHPSF "Trezhnjeva", per tenderin me objekt: "Ruajta me polici private e HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC VAU Dejes".
2. Te behet modifikimi i DT sipas ketij vendimi nga Njesia e Prokurimit.

II.4. Në datën 30.08.2019 operatori ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...]

Dokumentat e tenderit dhe kriteret per kualifikim duhet te hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne keto procedura, per realizimin me sukses te kontrates, me qellim zgjerimin e rrethit te pjesmarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 1 pika 2 te LPP i cili parashikon shprehimisht se:

2. Qellimi i ketij ligji eshte:

- a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik, te kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale;
- c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik;
- ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike;
- d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik;
- dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.

Referuar sa me siper, shoqeria jone gjykon se organizimi nga ana e autoritetit kontraktor ne nje lot eshte jopropocionale pasi e tejkalon volumin dhe permasat e kontrates qe prokurohet, ne kushtet

kur kerkohet qe sherbimi i ruajtjes te kryhet ne 3 (tre) HEC, Vau i Dejes, Koman, Fierze te cilat administrativisht jane te organizuara ne njesi te vecanta dhe shtrihen ne dy Qarqe, respektivisht 10 vendroje me tre tume ne HEC Fierze, 12 vendroje me tre tume ne HEC Koman, 14 vendroje me tre tume ne HEC Vau i Dejes me 4.98 punonjes sherbimi per vend/roje. Organizimi ne nje lot te vetem sipas kriterëve te kualifikimit eshte joproporcional me objektin e prokurimit, dhe ndikon ne uljen e konkurrenës ndërmjet operatoreve ekonomike si dhe bie ndesh me frymen e ligjit i cili parashikon se kriteret per kualifikimin duhet te hartohen ne ate menyre qe te stimulojne pjesmarrjen e sa me shume ofertuesve ne proceduren e prokurimit. Per autoritetin eshte e rendesishme te vertetohet se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (ne rastin konkret punonjes sherbimi mjete sherbimi etj.) mjaftueshem sa te jete ne gjendje te realizoje objektin e prokurimit dhe per kete arsye autoriteti kontraktor duhet te marre masa per modifikimin e kriterit ne fjale, ne perputhje me permasat e kontrates qe dote prokurohet duke e ndare ne 3 (tre) lote.

Ju sjellim ne vemendje:

Procedura ne fjale eshte zhvilluar 3 vjete me pare dhe ka funksionuar shume mire e ndare ne lote ku pjesmarrja e operatoreve ekonomik ka qene e mjaftueshme pavaresisht se fitues te procedures per lotin Fierze, sipas vendimit te KPP ka dal shoqeria "Trezhnjeva" kontrata eshte nenshkruar dhe zbatuar ne kundërshtim me kete vendim te KPP i cili e ka shpallur absolutisht te pavleshme kontraten e lidhur nga BOE SHPSF "NSS Ndreu Security Servis" shpk & "Eurogjici-Security" kjo procedure vazhdon te jete ne proces gjyqësor.

Gjthashtu ju sjellim ne vemendje se shpallja "Fitues" sipas kriterëve te percaktuara nga Autoriteti Kontraktor te BOE SHPSF "NSS Ndreu Security Servis" shpk & "Eurogjici-Security" eshte percaktuar pasi Operatori Ekonomik SHPSF "NSS Ndreu Security Servis" shpk, pavaresisht se ka realizuar kontraten per HEC Fierze prej 3(tre) vitesh me 50 % te kontrates, deri me sot nuk ka asnje punonjes te certifikuar dhe as QKSH ne Drejtorin e Policise se Qarkut Kukes, po keshtu nuk ka asnje punonjes te deklaruar ne Zyren e Punes dhe Tatim Taksave si tepunesuar ne HEC Herze duke kryer evazion fiskal, fshehje te te ardhuarve, ushtrim aktiviteti ne kundërshtim me aktet ligjore qe normojne vepritarine e SHPSF-ve.

Ky informacion per Autoritetin Kontraktor duhet te sherbeje per perjashtimin nga pjesmarrja ne kete procedure te ketij Operatori Ekonomik dhe vazhdimin e procedurave per hetim administrative prane APP-se per perjashtim nga procedurat e prokurimit publik dhe indicje per hetim te metejshem nga oraganet e tjera ligjzbatuese; Prokuroria, Hetimi Tatimor, Inspektoriat i Punes, Drejtoria e Pergjithshme e Policises se Shtetit, Krimet Ekonomik e Financiar ne Policine e Shtetit, Autoriteti Konkurrenës, Drejtoria e parandalimit e pastrimit te parave.

Pretendimi i autoritetit kontraktor ne kthim pergjigje është: Ne nenin 9, pika 5 të VKM nr.914, date 29.12.2014 citohet [...].

Komisioni per shqyrtimin e ankeses konstaton se sherbimet e kerkuara ne proceduren e prokurimit ne shqyrtim jane plotesisht homogjenedhe ndarja ne lote nuk do te sillte nje shtim te konkurrenës, Vete Autoriteti Kontraktor ku i referohet nenit 9, pika 5 te VKM nr 914, date 29.12.2014 , pranon se "Kontrata ndahet ne lote, kur perbehet nga pune, mallra apo sherbime, homogjene ose te ngjashme ku pranon ne kthim pergjigje se keto sherbime jane komplet homogjene. Meqense VKM e percakton ndarjen ne lote per sherbime homogjene ose te ngjashme dhe vete Autoriteti kontraktor

ne pergjigjen e tij e pohon se keto sherbime jane plotesisht homogjene. Kerkoj ndarjen me lote te kesaj procedure.

I) Ne piken 2.9 "Kohezgjatja e Kontrates ose Afati Kohor per Ekzekutim" te dokumentave standart te tenderit, mungon afati kohor i fillimit dhe i perfundimit:

2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj 36 ose ditë □□□□

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

2.9.1 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: 36 (tridhjetë e gjashtë) ose ditë: •••• (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër(jo më shumë se (4) vjet)

Ose duke filluar nga ••/••/•• (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më ••/••/•• (dd/mm/vvvv)

Mungesa e informacionit qe ka te beje me daten e fillimit dhe te perfundimit te sherbimit krijon konfuzion dhe pamundesi per shoqerine tone ne perlllogaritjen e ofertes ekonomike pasi ne baze te diteve nxjerrim mesataren e diteve ne muaj.

Per kete arsye, kerkojme plotesimin e te gjitha rubrikave nga autoriteti kontraktor si data e fillimit dhe data e perfundimit te sherbimit.

Gjithashtu, kerkojme te vendoset informacioni nese ditet mesatare mujore do te jene 30.41 apo 30.44 dite gjate perlllogaritjes se tumit te dyte dhe te trete apo do te aplikohet nje mesatare tjeter. Komisioni i prokurimit publik me Vendimin K.P.P 784/2016, date 12.10.2016, ne nje rast te ngjashem ka arsyetuar: [...]

Per sa me siper, kerkojme vendosjen e afatit ne dite si mesatarja e diteve ne muaj.

II) Ne Shtojca 1 "Formulari i Ofertes Ekonomike", autoriteti ka publikuar shenimin si ne vijim:

Sqarime: Analiza e kostos

Sqarime:

1.Në çmim të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, shtesat per Turnet e II-ta dhe III-ta, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, nderlidhje, kapacitetet mbeshtetese, shpenzimet per sigurimin e pergjegjesis profesionale, shpenzimet administrative, fitimi i shoqerise etj.

Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi dhe analiza e detajuar e cmimit.

Preventiv të kostos për 1 roje në muaj, për 1 vendroje me shërbim 24 orë

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /Muaj
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		

4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Shpenzimet për ndërlidhje (bazuar në tarifën vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin)		
6	Kapacitetet mbështetëse (transporti i punonjësve pasi kemi të bëjmë me objekte në një distancë të largët)		
7	Shpenzimet për sigurimin e përgjegjësisë profesionale		
8	Shpenzimet administrative		
9	Fitimi i shoqërisë		
	Vlera totale pa TVSH për 1 roje në muaj		
	Vlera totale me TVSH për 1 roje në muaj		

Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zërave të mësipërm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM-së Nr. 809, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe akteve nenligjore në fuqi etj.

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit dhe analizës së kostos, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka të drejtë t’u kërkojë operatorëve ekonomik sqarime në lidhje me zërat e ofertës ekonomike dhe në rast se konstaton se operatori nuk e argumenton dot aritmetikisht, ligjërisht dhe me dokumentacion mbështetës ofertën, autoriteti do ta s’kualifikojë.

Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit).

Klasifikimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertes së dhënë në total.

Agjensia e Prokurimit Publik ka publikuar setin e DST për procedurat e prokurimit publik për tendrin e hapur shërbime po kështu APP dhe KPP-ja kanë nxjerre udhëzim e përbashkët për hartimin e ofertave nga operatorët ekonomik dhe ka përcaktuar preventivin për këtë lloj shërbimi si më poshtë: [...]

Ky veprim i personave përgjegjës të Njësive të Prokurimit është shpërdorim klasik i detyrës me qëllim favorizimin e operatorit ekonomik që ka në ruajtje objektin aktualisht dhe rritjen fiktime të ofertes.

5	Shpenzimet për ndërlidhje (bazuar në tarifën vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin)		
6	Kapacitetet mbështetëse (transporti i punonjësve pasi kemi të bëjmë me objekte në një distancë të largët)		
7	Shpenzimet për sigurimin e përgjegjësisë profesionale		
8	Shpenzimet administrative		
9	Fitimi i shoqërisë		

Kur koficienti për një vend/roje është i përcaktuar 4.98 roje, sjell si pasojë ofertime të ndryshme për subjekte të ndryshme. Vendosja e kësaj kërkesave shërben si pengesë për konkurrencën e drejtë

ne prokurimin publik. ne kundërshtim me parimet e përgjithshme të Prokurimit Publik të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik ", i ndëshuar pasi nuk ka tarifa të përcaktuara.

Se pari, kërkesa për Shpenzimet për nderlidhje (bazuar në tarifën vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin) bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, datë 20.12.2017 pasi sic edhe thekson ky rekomandim këto pajisje presupozohet që i disponojnë operatorët nga momenti i licencimit të tyre:

“- Të mos përlogariten shpenzimet për uniformën, si dhe të mos kërkohet paraqitja e mjeteve ndihmëse si p.sh elektrik dore etj. pasi këto kritere përmbushen nga shoqëria që në momentin e licencimit të saj.

Se dyti, edhe sikur të pranojmë për një moment se kërkesa për llogaritjen në preventiv është e ligjshme (nuk është) nuk është përcaktuar numri i radiove dhe se kërkesa AKEP Radiokomunikim dhe Radioalarme është kërkuar në rangë Qarku kurse objektet ndodhen në dy rrethë Tropoje dhe Shkoder cka rrit në mënyrë fiktive koston kur llogaritet në shkallë qarku, është teresisht diskriminues dhe jo në proporcion me objektin e procedurës.

Nga sa më sipër, kërkojmë heqjen e kërkesave referuar më sipër.

III) Në Shtojcë 1 "Formulari i Ofertes Ekonomike", autoriteti ka publikuar shënimin si në vijim:
Sqarime: Analiza e koston

- Operatorët janë të detyruar të paraqesin analizën e detajuar me mënyrën e përlogaritjes së koston për ofertën e paraqitur si dhe preventivin sipas zerave të mesipër, duke pasqyruar të gjitha koston për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM nr. 809, datë 26.12.2018 për Përcaktimin e Pages Minimale në Shkallë Vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike". Numri i punonjësve të nevojshëm të sherbimit për një vendroie me tre tume të llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjës/muaj: 174 ore). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për cdo punonjës sherbimi).

Nderkohe që referuar shtojcës 9 "Specifikimet Teknike, Sherbimet & Grafiku I Ekzekutimit, Termat e Referencës", rezultojnë të jetë i pa plotësuar fakti i cili krijon konfuzion gjatë hartimit të ofertes ekonomike pasi në shtojcën 1 është përcaktuar 4.98 punonjës për vendroie ndërsa në shtojcën 9 është i pa përcaktuar për një vendroie kurse në shtojcën 12 ka përcaktuar numrin e punonjësve të sherbimit 5 për cdo vend/roje.

Për sa më sipër është detyrë e autoritetit kontraktor të hartojë kriteret dhe specifikimet në mënyrë të qartë dhe të sakta me qëllim shmangien e konfuzionit të operatorëve ekonomik ofertues, informacioni i cili le vend për interpretim dhe për rrjedhojë edhe keqinterpretim duke mos i vene në kushtë barazie dhe kjo do të conte në ofertime të ndryshme dhe vlerësimi nga KVO do të ishte po i ndryshëm.

Ky informacion mund të sherbejë si pengesë për konkurrencën e drejtë në prokurimin publik, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të prokurimit publik të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Nga sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të përcaktuar qartë informacionin lidhur me numrin e rojeve për cdo vendroie (4.98 roje) në të gjitha rubrikat e Dokumentave të Tenderit ku duhet të vendoset ky informacion si kusht i domosdoshëm për plotësimin e ofertes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor nuk ka pranuar qe te percaktohet sakte numri i punonjesve pasi tek preventive numri i punonjesve eshte 4.98 roje/vend/roje dhe tek termat e referencës është 5 roje/vend/roje.

IV) Ne Shtojca 12 "Termat e References", autoriteti ka publikuar kriteret e kualifikimit qe duhet te paraqesin operatoret ekonomik.

Nderkohe qe ky veprim bie ne kundërshtim me LPP dhe vete Dokumentat e Tenderit dhe konkretisht me shtojcen Shtojca 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", rubrike e cila eshte vendi ku percaktohen kriteret e vecanta te kualifikimit. Autoriteti nuk mund te dubloje kriteret e vecanta te kualifikimit duke i vendosur sa ne shtojcen 10 dhe ne shtojcen 12.

Per sa me siper, kerkojme heqjen e kriterëve te kualifikimit nga shtojca 12 "Termat e References" dhe nga cdo rubrike tjeter qe nuk ka te beje me shtojcen 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" dhe lenien e tyre vetem ne shtojcen 8.

Kerkesa per kriteret e kualifikimit eshte pranuar qe te hiqen nga shtojca e termave te references por Autoriteti Kontraktor nuk ka pranuar qe te percaktohet sakte numri i punonjesve pasi tek prevetivi numri i punonjesve eshte 4.98 roje/vend/roje dhe tek termat e references eshte 5 roje/vend/roje.

V) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

"Operatori ofertues duhet te paraqese Certifikata per punonjes sherbimi nenkategoria 1.3.A per 165 punonjes sherbimi, prej te cilave:

- 45 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukes, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 30 punonjes;

- 120 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 100 punonjes. Kerkesa per paraqitjen e 165 certifikatave nuk eshte ne perpjestim te drejte me numrin e punonjesve per zbatim e kontrates, ne te cilet eshte specifikuar se sherbimi do te kryhet ne 36 vendroje me 4.98 punonjes per vendroje me tre tume (tumi I, II dhe III-te) ne total bejne 179.8 punonjes sherbimi.

Ne nenin 46 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, pika 3, parashikohet [...].

Ne nenin 46 te Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: [...].

Ndersa ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, percakohet se: [...].

Per sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit si ne vijim:

- "Operatori ofertues duhet te paraqese 179.28 (njqind e shtatedhjet e nente pike njezet e tete) certifikata profesionale per ushtrim profesioni te rojes leshuar nga DPQ Kukes 50 (pesedhjetë) dhe 129.28 certifikata profesionale per ushtrim profesioni te rojes leshuar nga DPQ Shkoder" vendosja e kriterit per 45 certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukes, 120 certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder perputhet me numrin e punonjesve te certifikuar qe kane aktualisht firma "Eurogjici-Security" ne Qarkun Kukes 45 dhe numrin e

punonjesve te certifikuar qe kane firmat "Eurogjici-Security" dhe "NSS Ndreu security servis" ne qarkun e Shkodres 120.

Kerkojme heqjen e Autorizimit te armeve pasi pajisja me kete dokument per punonjesit e sherbimit behet vetem pasi lidhet kontrata nga firma fituese sipas plan dislokimit.

Pretendimi i Autoriteti Kontraktor ne kthim pergjigje se nuk kemi kerkuar Autorizim per mbajtje arme nuk qendron pasi ne kriteret per kualifikim dhe ne shtojcen e hedhur me 26.08.2019 kerkohet qe bashkelidhur certifikatave te punonjesve duhet te shoqerohen dhe me 30 autorizime mbajtje arme per qarkun Kukes dhe 100 autorizime per qarkun Shkoder. Kerkojme heqjen e Autorizimit te armeve pasi paisja me kete dokument per punonjesit e sherbimit behet vetem pasi lidhet kontrata nga firma fituese sipas plan dislokimit.

VI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

1.Shëbime të ngjashme:

- Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme kat. (1.3.A) në një vlerë sa 166,000,000 leke, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes se tenderit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët duhet të paraqesin:

Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte shtetërore duhet të paraqiten Kontrat/ kontrata të realizuara, shoqëruar me Vërtetimin e realizimit me sukses lëshuar nga autoriteti përkatës kontraktor, i cili duhet të përmbajë, Afatin, Vlerën, Objektin. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Ose

- Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte private duhet të paraqiten Kontrat/ kontrata të realizuara të shoqëruara me Faturat përkatëse tatimore të shitjes të firmosura dhe vulosura nga të dyja palët dhe Vërtetimin e përfundimit me sukses të saj, lëshuar nga subjekti privat i cili duhet të përmbajë, datat, Afatin, Vlerën, Objektin. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Kerkesa e hartuar ne kete menyre le vend per interpretim dhe keqinterpretim, pasi sipas LPP-se si deshmi per pervojen e meparshme kerkohet deri ne 40 % e vleres kontrates te realizuara ne tri vitet e fundit. Ne rastet kur sherbimet jane kryer me subjekte shtetërore duhet te paraqiten vertetimin e realizimit me sukses leshuar nga autoriteti perkates kontraktor, i cili duhet te permbaje, afatin, vleren, bojektin ne rastin kur sherbimet jane kryer me subjekte private duhet te paraqiten vetem faturat tatimore.

Kjo per arsyen pasi disa kontrata me institucione te rendesise se vecante shtetërore jane kontrata te klasifikuara ne nivelin "Sekret Shtetëror" dhe nuk mund te paraqiten cka e ka parashikuar dhe ligjvenesit ku ka percaktuar se per kontratat e realizuara me institucione shtetërore kerkohen vetem vertetimi ne realizimit me sukses leshuar nga autoriteti perkates kontraktor, i cili duhet te permbaje, afatin, vleren, objektin. Autoriteti kontraktor duhet te riformuloje kriterin si me poshte, ne menyre te mos kete keqinterpretime dhe te mos perjashtoj firmat qe kane realizuar kontrata me institucionete rendesise vecante ne nivelin "Sekret Shtetëror".

Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi ku te kete realizuar sherbime te ngjashme, ne nje vlere sa 40 % e fondit limit qe prokurohet, te realizura gjate tre viteve te fundit nga data e hapjes

se tenderit. Per te vertetuar kete Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetime te cilesise se kryerjes se saj.

Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

Autoriteti Kontraktor ka pranuar qe per sherbime te ngjashme te paraqiten vertetime per realizim kontrate por ka shtuar fjalet shoqeruar me fatura tatimore shitje. Kerkojme qe te hiqet fjala shoqeruar me fatura tatimore shitje pasi kjo kerkese kerkohet kur sherbimet jane realizuar me subjekte private.

VII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukes, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 10 arme krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm,
- Jo me pak se 120 punonjes shërbimi të certifikuar,
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

Kerkesa e mesiperme ku kerkohet... "Te kete ne liste emerore te pakten tridhjetë punonjes te licensuar nga DPQ", eshte jo proporcionale me objektin e kontrates.

Ne nenin 46 te Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: [...]

Ndersa ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, percakohet se: [...]

Ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 5, germet "a", "b" dhe "c", parashikohet si me poshte: [...].

Shoqeria jone gjykon se, vendosja e kriterëve te vecanta per kualifikim ka si synim kryesor qe t'i sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret per kualifikim duhet te hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, pjesemarrës ne keto procedura, per realizimin e sukses te kontrates me qellim zgjerimin e rrethit te pjesmarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 1 pika 2 te LPP i cili parashikon shprehimisht se [...].

Referuar sa me sipër, shoqeria jone gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor per ... "Te kete ne liste emerore te pakten 165 punonjes te licensuar nga DPQ" eshte joproporcionale pasi nuk ploteson volumin dhe permasat e kontrates qe prokurohet, ne kushtet kur kerkohet qe sherbimi i ruajtjes te kryhet ne 36 (tridhjet e gjashte) vendroje me tre tume, me 4.98 punonjes sherbimi. Numri i punonjesve te sherbimit i percaktuar ne kriterin e vecante te kualifikimit eshte joproporcional me objektin e prokurimit, dhe ndikon ne uljen e konkurences ndermjet operatoreve ekonomike si dhe bie ndesh me frymen e ligjit i cili parashikon se kriteret per kualifikimin duhet te harton ne ate menyre qe te stimulojne pjesmarrjen e sa me shume ofertuesve ne proceduren e prokurimit. Per autoritetin eshte e rendesishme te vertetohet se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (ne rastin konkret punonjes sherbimi), mjaftueshem sa te jete ne gjendje te realizoje objektin e prokurimit dhe per kete arsye, autoriteti kontraktor duhet te marre masa per modifikimin e kriterit ne fjale, ne perputhje me permasat e kontrates qe do te prokurohet (50 punonjes sherbimi per Qarkun Kukes dhe 129.28 per Qarkun Shkoder).

Kërkesa e mesiperme ku kerkohet... "Te kete pergjegjes sherbimesh", eshte jo proporcionale me objektin e kontrates. Per autoritetin eshte e rendesishme te vertetoje se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike, mjaftueshem sa te jete ne gjendje te realizoje kontraten, objekt i ketij prokurimi. Percaktimi i pergjegjesve te sherbimit, ka te beje me organizimin e brendshem te shoqerise dhe artifica te tilla nuk i sherbejne qellimit per te cilin vendoset kriteri, perkundrazi kufizojne pjesmarrjen dhe konkurrencen.

Per sa me sipër, kërkojme heqjen e kërkeses per pergjegjes sherbimi

Kërkesa e mesiperme ku kerkohet ... "krahu" "arme brezi", ... "Te autorizim per mbajtje arme" si dhe 26 arme krahu dhe 8 arme brezi, eshte nje kerkese qe vjen ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi.

Me vendimin Nr. 15/2017, date 18.01.2017, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi me i larte qe merr vendime administrativisht perfundimtare, ka vendosur qe kërkesa per arme dhe autorizim armesh ne kete faze te prokurimit, eshte nje kerkese ne kundërshtim me ligjin. Konkretisht KPP ka vendosur: [...]

Per sa me sipër, kërkojme heqjen nga kriteri të kërkesës për "arme Krah", "arme brezi", "autorizim për mbajtje arme".

Kjo kërkesë e dubluar nga Autoriteti Kontraktor plotësohet plotësisht në kërkesën e përcaktuar "Operatori ekonomik duhet të disponojë 28 arme krah, kategoria 1.3.A vertetuar me:

- Autorizim për blerje armesh leshuar nga Drejtoria e Policisë Shtetë,
- Kontrate Shitblerje,
- Fatura Shitblerje dhe
- Pagesen Bankare

Operatori ekonomik duhet të disponojë 8 arme brezi, kategoria 1.3 A vertetuar me:

- Autorizim për blerje armesh leshuar nga Drejtoria e Policisë Shtetë,
- Kontrate Shitblerje,
- Fatura Shitblerje dhe
- Pagesen Bankare

Kërkesa e mesipërme ku kërkohej ... "pese operatore" është një kërkesë që vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e komisionit të prokurimeve publike pasi është një numër tepër i ekzagjeruar. Për autoritetin kontraktor është e mjaftueshme të provohet nga operatorët ekonomik se disponojnë operator pa vënë kufi mbi numrin e tyre.

Madje, Komisioni i Prokurimeve Publike me vendimin Nr. 15/2017, datë 18.01.2017, si organi më i lartë që merr vendime administrativisht përfundimtare, ka vendosur që kërkesa për operatore sille, është një kërkesë e ekzagjeruar.

Konkretisht KPP ka vendosur: [...]

Për sa më sipër kërkojme ndryshimin e kërkesës duke kërkuar disponim të operatorëve pa përmendur numër.

VIII) Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar:

- Kërkesa e mesipërme ku kërkohej..
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka shkellje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka ngjarje të ndodhura për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka masa për ngjarje për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,

është një kërkesë që vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe bie ndesh parimet e LPP-se.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nëni 28, pikë 5, gërmat "a", "b" dhe "c", parashikohet si më poshtë:[...]

Shoqëria jone gjykon se, vendosja e kriterëve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomikë, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e aseteve të tjera fizike, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit të suksesshëm të kontratës,

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të

sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatorët ekonomike, pjesëmarrës në këtë procedurë, për realizimin e suksesshëm të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pikë 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: [...]

Shoqëria jone gjykon se kërkesa e referuar më sipër është diskriminuese dhe e egzagjyeruar pasi nuk siguron një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë ata që kanë masa administrative dhe ata që nuk kanë masa administrative.

Legjislacioni i prokurimit publik i ka përcaktuar qartë rastet kur një operator mund të përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi dhe ky rast nuk është i përfshirë.

- Për sa më sipër, kërkojmë heqjen e kërkesës që ka të bëjë me
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka ngjarje të ndodhura për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,
- Nuk ka masa për ngjarje për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi.

IX) Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 18 automjete dhe 6 motorra, në emër të shoqërisë ose në rastin kur janë në emër të administratorit, apo të marra me qera nga një person juridik apo fizik tjetër.

Për automjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- Certifikatat e Pronësive
- Lejet e qarkullimit.
- Certifikate të kontrollit Teknik
- Taksat e paguara
- Sigurimet

Për automjetet me qera duhet të paraqiten:

- Kontratat qeraje të lidhura për noterit
- Certifikatat e Pronësive
- Lejet e qarkullimit
- Certifikate të kontrollit Teknik
- Taksat e paguara
- Sigurimet

Faturat tatimore të prera nga qiradhenesi dhe pagesën përkatëse bankare për periudhën e marrjes së mjeteve me qera.

Kërkesa për paraqitjen e 18 automjete dhe 6 motorra" është një kërkesë e paligjshme dhe jo në proporcion me volumin e realizimit të kontratës pasi kemi vetëm 3 objekte të grupuara në një perimenter të caktuar ku një automjet ose një motor për objekt është i mjaftueshëm për kryerjen e shërbimit pasi diskriminon operatorët ekonomikë që disponojnë automjete dhe jo motorra.

Nga sa më sipër, kërkojmë ndryshimin e kriterit si në vijim:

5.Operatori ofertues duhet të vertetojë se disponon 3 motorra ose 3 automjete në pronësi ose me kontratë qeraje për ndërhyrje në rastet e nevojës. Mjetet duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin përkatës (leje qarkullimi, kollauidim i mjetit dhe sigurimi i detyrueshëm, taksa të vlefshme certifikate pronësie, nga një automjet ose motor për çdo objekt.

X) Në kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar:

4. Operatori ekonomik duhet te disponoje jo me pak se 30 dedektore dore elektronike, jo me pak se 30 spray neuroparalizues, jo me pak se 30 radio komunikimi dhe jo me pak se 30 cope jelek antiplumb.

Ne rastet kur pajisjet jane blere brenda vendit operatori duhet te paraqese:

- Fature Tatimore e Shitjes e firmosur nga te dyja palet dhe e vulosur nga shitesi;
- Pagesen qe verteton vleren e blerjes se paisjeve;
- Deklarimin e fatures tatimore te shitjes ne sistemin elektronik te tatimeve;

Ne rastet kur keto kapacitete jane blere jashte vendit operatori duhet te paraqese:

- Deklaraten e zhdoganimit nepermjet se ciles vertetohet zhdoganimi i paisjeve;
- Xhirimin Bankar qe verteton pagesen e vleres se blerjes se paisjeve;
- Deklarimin e fatures tatimore te shitjes ne sistemin elektronik te tatimeve;

Autoriteti kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te pajisjeve dhe ne rast se konstaton se operatori ekonomik nuk disponon realisht pajisjet, autoriteti pervec se do ta skualifikoje, por do te kryeje denoncim dhe ne APP per qellim te nenit 13 te LPP-se.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarrres ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikimi.

Kerkesa e mesiperme eshte nje kerkese qe vjen ne kundersiztim me legjislacionin ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor duhet te percaktoj qarte dokumentin qe verteton paisjet ose me vertetim nga Drejtoria e Policise Qarkut perkates ose me fatura tatimore dhe mos te dubloje kerkesat per dokumentacion dhe jo te kerkoje dokumenta pa lidhje qe se din as vete cfare kerkon ose pse i duhet xhirimi bankar e aq me teper Deklarimin e fatures tatimore te shitjes ne sistemin elektronik te tatimeve, tagra te cilat i takojne institucioneve te tjera biles ligjvenesit per te lehtesuar bizneset edhe vertetimet e tatimeve per detyrime behen me deklarim.

Madje, kerkesa per radio komunikimi, dedektor, spray bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, date 20.12.2017, per kete arsye duhet hequr.

Se pari, kerkesa per paraqitjen e pajisjeve speciale bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, date 20.12.2017 pasi sic edhe thekson ky rekomandim keto pajisje presupozohet qe disponojne operatoret nga momenti licencimit te tyre:

- Te mos perlllogariten shpenzimet per uniforrnen, si dhe te mos kerkohet paraqitja e mjeteve ndihmese si p.sh elektrik dore etj, pasi keto kriteret permbushen nga shoqëria qe ne momentin e licensimit te saj.

Per kete arsye duhet hequr nga kriteri i kualifikimit kerkesa per, radio komunikimi, dedektor, spray, jelek antiplumb.

Se dyti, edhe sikur te pranojme per nje moment se kerkesa per paraqitjen e pajisjeve speciale eshte e ligjshme (nuk eshte) pasi numri per mjete speciale te sherbimit, eshte teresisht diskriminues dhe jo ne proporcion me objektin e procedures.

Referuar specifikimeve teknike dhe grafikut te sherbimit rezulton te jene 36 (tridhjet e gjashte vendroje) dhe kerkesa per 30 cop pajisje, emertimet e te cilave jane te permendura me siper eshte e jo ne proporcion me objektin e prokurimit pasi 1 pajisje per vendroje do te mjaftonte.

Kerkesa e mesiperme ku kerkohet ... "jelek antiplumb" eshte nje kerkese qe vjen ne kundersiztim me legjislacionin ne fuqi dhe vendimet e komisionit te prokurimeve publike pasi nuk kemi te bejme me sherbim transport vlerash monetare 1.3.B por kemi te bejme me sherbim ruajtje kat 1.3.A.

Per sa me siper, kerkojme heqjen e kesaj kerkese nga kriteri kualifikues.

XI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

Vertetim leshuar nga Bashkia/Njesi Administrative me ane te se cilit te vertetohet shlyerja e taksave per vitin 2016-2017-2018, per adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik, sipas Ekstraktit Historik leshuar nga QKR.

Kerkese perseritur dy here e ekzagjeruar dhe ne kundertshtim me ligjin Legjislacioni i prokurimit publik i ka percaktuar qarte rastet kur nje operator mund te perjashtohet nga pjesmarrja ne nje procedure prokurimi dhe ky rast nuk eshte i perfshire aq me teper kerkohet per tre vite kur mund te kerkohet i vitit te fundit dokumentacioni i tepert dhe qe nuk i sherben autoritetit Kontraktor.

Kerkojme heqjen e ketij kriteri ose te kerkohet vertetim per vitin e fundit per njesit administrative ku ndodhen objektet.

XII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

1. Operatori ekonomik gjate tre viteve te fundit 2016-2017-2018 nga data e hapjes se tenderit duhet te kete xhiro mesatare vjetore nje viere jo me te vogel se 166,000,000 leke.

Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarrjes ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikimi.

Ky kriter duhet te modifikohet duke kerkuar vertetim nga Administrata Tatimore jo me pak se 40% e mesatares per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit.

XIII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

2. Operatori ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv (te mos kete dale me humbje) te qendrueshem gjate tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje te bilanceve te ketyre tre viteve, te paraqitur prane autoritetit perkates, te shoqeruara nga akt ekspertize e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarrjes ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikimi.

Ky kriter eshte egzagjeruar duhet te modifikohet dhe te kerkohet Operatori ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv (te mos kete dale me humbje) te qendrueshem gjate tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopjete bilanceve te nje prej tre viteve te paraqitur prane autoritetit perkates, te shoqeruara nga akt ekspertize e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarrjes ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikim.

XIV) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te zoteroje Licence/Autorizim per ngritjen dhe shfrytezimin e sistemit te pavarur te radiokomunikacionit dhe radioalarmit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" me zone mbulimi Qarkun Kukes dhe Qarkun Shkoder.

Edhe kjo eshte kerkese e egzagjeruar prandaj ky kriter duhet te modifikohet dhe te kerkohet; Operatori ekonomik duhet te zoteroje Licence/ Autorizim per ngritjen dhe shfrytezimin e sistemit te pavarur te radiokomunikacionit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008

"Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" me zone mbulimi rrethi Tropoje dhe rrethi Shkoder ku ndodhen objekte dhe zbatohet kontrata.

Kerkojme te hiqet kerkesa radioalarmit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise" pasi kemi te bejme me ruajtje fizike dhe jo me verifikim alarmi.

XV) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

Operatori Ekonomik ofertues duhet qe ne stafin teknik te kete edhe 2 (dy) punonjes i diplomuar ne bachelor per Elektronik / Telekomunikacioni / Informatik / Kompjuterike / Megatronike. Per te vertetuar disponimin e ketij kapaciteti, operatori duhet te paraqese: Diplomen dhe Kontraten e Punes e cila duhet te mbuloje te gjithë periudhen e sherbimit i cili duhet te figuroje ne listpagese I siguruar. Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter ne te kundert perben kusht per s'kualifikim.

Kerkesa e mesiperme eshte nje kerkese qe vjen ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi dhe bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr.15166 dhe nr.1858, date 20.12.2017, pasi sic edhe thekson ky rekomandim ky informacion nuk mund te kerkohet me dokumentacionin dhe pajisjet e referuara me siper ne kriter por mjafton paraqitja e Aktit te Miratimit:

- Ne lidhje me kriterin e Qendrës së Kontrollit, te kerkohet paraqitja e Aktit të Miratimit të Qendres së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit ne Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF.

Akoma me tej, rezulton se ky eshte nje kriter i dubluar pasi po ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

"3. Operatori ofertues duhet te kete Qender te Menaxhimit dhe te Kontrollit per ushtrim aktiviteti ne Qarkun ku kerkohet sherbimi te konfirmuar me akt miratimin perkates shoqeruar me vertetimin nga Drejtoria e Policise se Qarkut Kukes dhe Shkoder."

Per autoritetin kontraktor e nevojshme eshte qe oe te vertetojne disponimin e salles operative dhe dokumenti qe e verteton kete kapacitet eshte akti i miratimit i leshuar nga DVP. Kerkesa qe operatori ekonomik krahas ketij dokumenti, te paraqese edhe nje sere dokumentash te tjere eshte nje kerkese e panevojshme dhe vetem sa rendon/veshtirson poziten e operatoreve ekonomik ne pergatitjen e dokumentacionit. Akoma me tej Autoriteti ka kerkuar qe te jete ne listepagesa por nuk ka percaktuar si kriter as paraqitjen e liste pagesave dhe peridhen qe duhet te jete i siguruar Per sa me siper, kerkojme heqjen e ketij kriteri.

N Pretendimi i Autoritet Kontraktor se 2 (dy) punonjes i diplomuar ne bachelor per Elektronik/Telekomunikacioni/ Informatik/ Kompjuterike/ Megatronike eshte i nevojshem nuk qendron pasi kerkohet qe kontrata do lidhet me nje operator ateherë per 1 operatore mund te kerkohet te kete punesuar 1 person por jo 2 persona ose te lihet alternativa kontrate me subjekte private qe kryejne kete sherbim per mirmbajtjen e sallave oporative.

XVI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar:

Operatori ekonomik duhet te disponoje jo me pak se 2 (dy) Sistem Radiokomunikimi:

Per te plotesuar kerkesen e mesiperme OE duhet te paraqese fatura tatimore shitje, pagesat perkatese dhe deklarimin e faturave ne sistemin elektronik te tatimeve.

Kerkojme heqjen e ketij kriteri pasi eshte kerkuar licence / Autorizim per ngritjen dhe shfrytezimin e sistemit te pavarur te radiokomunikacionit dhe radioalarmit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise", me zone

mbulimi Qarkun Kukës dhe Qarkun Shkodër, ku janë të përcaktuar sistemet e Radiokomunikimit, atëherë me tërësi kërkohej dokumentacioni pa lidhje si fatura tatimore dhe deklarimin në SET (sistemi elektronik i tatimeve) kur ky dokument plotësohet me paraqitjen e QKSH dhe faturave tatimore për instalimin e pajisjeve të sallës operative. Deklarimi ose jo në SET nuk i përket Autoritetit Kontraktor por janë institucione të tjera që kontrollojnë këto deklarime për AK është e mjaftueshme që të jenë kapacitetet teknike.

II.5. Në datën 10.09.2019, nëpërmjet shkresës nr. 3749 Prot., datë 09.09.2019, me objekt “Informacion mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Ruajtja me polici private e HEC Fierzë, HEC Koman, HEC Vau Dejës”, me fond limit për 36 muaj: 415,786,312 (Katërqind e pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, Nr.REF-33418-08-13-2019”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “Referuar sa me sipër, shoqëria jone gjykon se organizimi nga ana e autoritetit kontraktor në një lot është joproporcionale pasi e tejkalon volumnin dhe përmasat e kontratës që prokurohet, në kushtet kur kërkohej që shërbimi i ruajtjes të kryhet në 3 (tre) HEC, Vau i Dejës, Koman, Fierzë të cilat administrativisht janë të organizuara në njësi të vecanta dhe shtrihen në dy Qarqe, respektivisht 10 vendroje me tre tume në HEC Fierzë, 12 vendroje me tre tume në HEC Koman, 14 vendroje me tre tume në HEC Vau i Dejës me 4.98 punonjës shërbimi për vend/roje. Organizimi në një lot të vetëm sipas kriterëve të kualifikimit është joproporcionale me objektin e prokurimit, dhe ndikon në uljen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si dhe bie ndesh me frymën e ligjit i cili parashikon se kriteret për kualifikimin duhet të hartohen në atë mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e sa më shumë ofertuesve në procedurën e prokurimit. Për autoritetin është e rëndësishme të vërtetohet se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (në rastin konkret punonjës shërbimi mjete shërbimi etj.) mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të realizojë objektin e prokurimit dhe për këtë arsye autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, në përputhje me përmasat e kontratës që dote prokurohet duke e ndarë në 3 (tre) lote. Ju sjellim në vëmendje: Procedura në fjalë është zhvilluar 3 vjetë me përparësi dhe ka funksionuar shumë mirë e ndarë në lote ku pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë ka qenë e mjaftueshme pavarësisht se fitues të procedurës për lotin Fierzë, sipas vendimit të KPP ka dalë shoqëria “Trezhnjeva” kontrata është nënshkruar

dhe zbatuar ne kundershtim me kete vendim te KPP i cili e ka shpallur absolutisht te pavleshme kontraten e lidhur nga BOE SHPSF "NSS Ndreu Security Servis" shpk & "Eurogjici-Security" kjo procedure vazhdon te jete ne proces gjyqesor.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 1 "Formulari i ofertës", autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e shërbimit si më poshtë vijon:

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroj eve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Ruajtja me polici private e HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes	36	36	4.98		
	Oferta Neto ne total					
	TVSH (%)					
	Oferta total					

III.1.2. Në shtojcën 11 "Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit" të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është përshkruar kryerja e shërbimit si vijon:

Shërbimi që kërkohet: Ruajtja e objekteve ne HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes.

Afatet e ekzekutimit: Shërbimi i ruajtjes duhet te sigurohet per 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

III.1.3. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar; 2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në kreun II, Neni 9, pika 5 e të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Kontrata ndahet në LOTE, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm, apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor."

III.1.5. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46, pika 3 përcaktohet: *“Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.”*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësia e prokurimit) pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, distribucionit, apo rastin konkretë të drejtën e licensimit.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në rastin konkret, mosndarja në Lote nga autoriteti kontraktor e procedurës së prokurimit, për secilin objekt (konkretisht HEC) që kërkohet të kryhet shërbimi, zvogëlon numrin e shoqërive që do të shfaqin interes për këtë procedurë prokurimi, duke lejuar vetëm një numër të kufizuar të tyre, kjo për të vetmin fakt se i detyron ato shoqëri të cilat nuk kanë kapacitetet për të ushtruar aktivitetet në të gjitha vendet e kërkuara, njëkohësisht, të mos bëhen pjesë e garës. Pra, mosndarja në lote, detyron që në këtë procedurë të marrin pjesë një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, në lidhje me numrin e punonjësve, pajisjet, mjetet si dhe licencat përkatëse për të marrë pjesë në një procedurë ku shërbimi kërkohet të kryhet në disa vendndodhje të ndryshme, në të njëjtën kohë, duke kufizuar kështu pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të operatorëve ekonomikë të cilët i plotësojnë më së miri këto kushte për një shërbim më shtrirje më të vogël. Pra, ndarja në lote do të stimulonte edhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të cilët kanë kapacitetet e nevojshme për të ofruar më së miri shërbimin e kërkuar në një lot të vetëm. Pra, autoriteti kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me frymën e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke mos e ndarë procedurën në fjalë në lote të veçanta sipas vendeve përkatëse, për të siguruar një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, shtrirja e objektit të prokurimit vetëm në një lot, ndërkohë që shërbimi do të kryhet në tre objekte HEC, referuar shërbimit që do të kryhet, rëndësisë së procedurës së prokurimit, vlerës së investimit, shmang pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi të shoqërive të interesuara, në kundërshtim me nenet 1, 2, 46/3, të LPP-së dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndarja në lote për secilin objekt që ka një rëndësi specifike më vete zvogëlon numrin e shoqërive që do të shfaqin interes për këtë procedurë prokurimi, duke lejuar vetëm një numër të kufizuar të tyre të jenë pjesëmarrëse, ndërkohë që ndarja në lote do të shoqërohej me stimulimin e pjesëmarrjes së gjerë duke mos kufizuar konkurrencën dhe duke mos diskriminuar asnjë shoqëri që disponon një numër të kufizuar punonjësish shërbimi në zonën përkatëse të çdo objekti ku do të kryhet shërbimi, në përputhje me qëllimin dhe objektivat e LPP-së. Për më tepër, nisur edhe nga historiku i kryerjes së kësaj procedure prokurimi konstatohet nga verifikimi se kjo procedurë është kryer e ndarë në tre lote në përputhje edhe me numrin e objekteve (HEC-ve) që do të ruhen dhe në të cilat do të kryhet shërbimi, i cili është i një rëndësie të veçantë dhe specifike.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k., se “Mungesa e informacionit qe ka te beje me daten e fillimit dhe te perfundimit te sherbimit krijon konfuzion dhe pamundesi per shoqerine tone ne perlllogaritjen e ofertes ekonomike pasi ne baze te diteve nxjerrim mesataren e diteve ne muaj. Per kete arsye, kerkojme plotesimin e te gjitha rubrikave nga autoriteti kontraktor si data e fillimit dhe data e perfundimit te sherbimit. Gjithashtu, kerkojme te vendoset informacioni nese ditet mesatare mujore do te jene 30.41 apo 30.44 dite gjate perlllogaritjes se tumit te dyte dhe te trete apo do te aplikohet nje mesatare tjeter..”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, pika I “Njoftimi i Kontratës”, Seksioni 2 “Objekti i kontratës”, pika 2.9 dhe 2.9.1 parashikohet:

2. 9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj 36 ose ditë □□□□

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

2.9.1 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: 36 (tridhjetë e gjashtë) ose ditë: •••• (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër (jo më shumë se (4) vjet)

Ose duke filluar nga ••/••/•• (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më ••/••/•• (dd/mm/vvvv)

III.2.2. Gjithahtu në Shtojca 1 “Formulari i ofertës”, autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e shërbimit si më poshtë vijon:

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroj eve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Ruajtja me polici private e HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes	36	36	4.98		
	Oferta Neto ne total					
	TVSH (%)					
	Oferta total					

III.2.3. Në shtojcën 11 “Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit” të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është përshkruar kryerja e shërbimit si vijon:

Shërbimi që kërkohet: Ruajtja e objekteve ne HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes.

Afatet e ekzekutimit: Sherbimi i ruajtjes duhet te sigurohet per 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

III.2.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e

prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.2.5. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues sqaron se: *“...Nga sa paraqitet me siper duket qarte se afati i parashikuar i marreveshjes kuader eshte 36 muaj nga nenshkrimi i marreveshjes kuader. Autoriteti kontraktor nuk eshte i detyruar te plotesoje cdo pike te pikes 2.9 te DST per sa kohe qe aty DST japin mundesine te fiksoh muajt ose ditet. Duket qarte se kohezgjatja e marreveshjes kuader eshte 36 muaj nga data e nenshkrimit te saj dhe eshte e parendesishme data e sakte e fillimit te sherbimit, e dhene kjo qe, ne fazen aktuale te prokurimit, nuk dihet saktesisht nga autoriteti kontraktor. Komisioni per shqyrtimin e ankeses gjykon se kjo kerkese e operatorit ekonomik eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe nuk mund te pranohet.”*

III.2.6. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, në pjesën “Njoftimi i Kontratës”, i dokumentave standarte të tenderit, përcaktohen kërkesa standarte të cilat duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor. Konkretisht, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, në pikën 2.9 të Seksionit II të “Njoftimit të kontratës”, autoriteti kontraktor ka detyrimin të plotësojë këtë pikë duke përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës ose afatin kohor për ekzekutimin e saj, të shprehur në muaj ose ditë, ose duke përcaktuar datën e fillimit dhe përfundimit të saj. Pra, është në të drejtën e autoriteti kontraktor të përcaktojë mënyrën se si të shprehë kohëzgjatjen e kontratës.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, se kohëzgjatja e kësaj kontrate do të jetë 36 muaj.

Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë datën e fillimit dhe mbarimit të kontratës, KPP gjykon se, kjo kërkesë nuk qëndron, pasi nisur nga lloji i shërbimit dhe specifikat e tij, është e pamundur që autoriteti kontraktor në këtë fazë në të cilën ndodhet kjo procedurë të përcaktojë saktë datën e lidhjes së kontratës. Akoma më tej, që në pikën 2.9.1 përcaktohet mjaft qartë se kohëzgjatja e kësaj kontrate do të jetë 36 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.

Sa më sipër, përcaktimit i bërë nga autoriteti kontraktor në lidhje me kohëzgjatjen e kësaj kontrate është mjaft i qartë dhe nuk lë vend për konfuzion.

Ndërkohë që, për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me përcaktimin se *“ditet mesatare mujore do te jene 30.41 apo 30.44 dite gjate perlllogaritjes se turnit te dyte dhe te trete apo do te aplikohet nje mesatare tjeter”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë qartë dhe saktë ditët mesatare mujore, bazuar në Rekomandimin Nr. 233 Prot, date 14.02.2019, “Rekomonadim mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike”, të Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Ky veprim i personave pergjegjes*

te Njesise se Prokurimit eshte shperdorim klasik i detyres me qellim favorizimin e operatorit ekonomik qe ka ne ruajtje objektin aktualisht dhe rritjen fiktive te ofertes.

5	Shpenzimet per ndërlidhje (bazuar në tarifat vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin)		
6	Kapacitetet mbështetese (transporti i punonjesve pasi kemi te bejme me objekte ne nje distanc te larget)		
7	Shpenzimet per sigurimin e pergjegjesis profesionale		
8	Shpenzimet administrative		
9	Fitimi i shoqërisë		

Kur koficienti per nje vend/roje eshte i percaktuar 4.98 roje, sjell si pasoje ofertime te ndryshme per subjekte te ndryshme. Vendosja e ketyre kerkesave sherben si pengese per konkurencen e drejte ne prokurimin publik ne kundershtrim me parimet e pergjithshme te Prokurimit Publik te percaktuara ne nenin 2 te ligjit nr 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndyshuar pasi nuk ka tarifa te percaktuara. Se pari, kerkesa per Shpenzimet per nderlidhje (bazuar ne tarifat vjetore te Akep per Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin) bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, date 20.12.2017 pasi sic edhe thekson ky rekomandim keto pajisje presupozohet qe i disponojne operatoret nga momenti i licencimit te tyre: “- Te mos perlllogariten shpenzimet per uniformen, si dhe te mos kerkohet paraqitja e mjeteve ndihmese si p.sh elektrik dore etj. pasi keto kritere permbushen nga shoqeria qe ne momentin e licensimit te saj. Se dyti, edhe sikur te pranojme per nje moment se kerkesa per llogaritjen ne preventiv eshte e ligjshme (nuk eshte) nuk eshte percaktuar numri i radiove dhe se kerkesa AKEP Radiokomunikim dhe Radioalarme eshte kerkuar ne range Qarku kurse objektet ndodhen ne dy rrethe Tropoje dhe Shkoder cka rrit ne menyre fiktive koston kur llogaritet ne shkalle qarku, eshte teresisht diskriminues dhe jo ne proporcion me objektin e procedures. Nga sa me siper, kerkojme heqjen e kerkesave referuar me siper.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 1 “Formulari i ofertës”, autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e shërbimit si më poshtë vijon:

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroj eve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Ruajtja me polici private e HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes	36	36	4.98		
	Oferta Neto ne total					
	TVSH (%)					
	Oferta total					

Sqarime:

1. Në çmim të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, shtesat për Turnet e II-ta dhe III-ta, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, nderlidhje, kapacitetet mbështetëse, shpenzimet për sigurimin e përgjegjësisë profesionale, shpenzimet administrative, fitimi i shoqërisë etj.
2. Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi dhe analiza e detajuar e cmimit.

Preventiv të koston për 1 roje në muaj, për 1 vendroje me shërbim 24 orë

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /Muaj
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
5	Shpenzimet për nderlidhje (bazuar në tarifën vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin)		
6	Kapacitetet mbështetëse (transporti i punonjësve pasi kemi të bëjmë me objekte në një distancë të largët)		
7	Shpenzimet për sigurimin e përgjegjësisë profesionale		
8	Shpenzimet administrative		
9	Fitimi i shoqërisë		
	Vlera totale pa tvsh për 1 roje në muaj		
	Vlera totale me tvsh për 1 roje në muaj		

- Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zërave të mësipërm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM-së Nr. 809, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe akteve nenligjore në fuqi etj.

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e koston në plotësimin e preventivit dhe analizës së koston, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka të drejtë t’u kërkojë operatorëve ekonomik sqarime në lidhje me zërat e ofertës ekonomike dhe në rast se konstaton se operatori nuk e argumenton dot aritmetikisht, ligjërisht dhe me dokumentacion mbështetës ofertën, autoriteti do ta s’kualifikojë.

- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit).
- Klasifikimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë në total.

III.3.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, I ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*”

III.3.3. Sa më sipër, KPP, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstaton se, autoriteti kontraktor në Shtojcën 1, Formulari i ofertës, ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në ofertën e paraqitur nga ana e tyre, të përlllogarisin Shpenzimet për pagën bazë, Shtesat mbi pagë për turnin II, Shtesat mbi pagë për turnin III, Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%, Shpenzimet për ndërlidhje (bazuar në tarifat vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin), Kapacitetet mbështetëse (transporti i punonjësve pasi kemi të bëjmë me objekte në një distancë të largët), Shpenzimet për sigurimin e përgjegjësis profesionale, Shpenzimet administrative dhe Fitimin e shoqërisë. Gjithashtu, autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin preventivin e ofertës së tyre sipas të gjitha zërave të mësipërm, ku autoriteti kontraktor ka të drejtë t’u kërkojë operatorëve ekonomikë sqarime në lidhje me zërat e ofertës ekonomike dhe në rast se konstaton se operatori nuk e argumenton dot aritmetikisht, ligjërisht dhe me dokumentacion mbështetës ofertën, ky fakt do të përbëjë kusht për skualifikim.

KPP, në rekomandimin Nr.15166 prot. Nr. 1858 prot., datë 20.12.2017, ka rekomanduar se, për sa i takon elementeve të veçantë për përlllogaritjen e koston për këtë lloj shërbimi apo hartimit të kriterëve për kualifikim, të mos përlllogariten në kosto nga autoriteti kontraktor shpenzimet për uniformën, si dhe të mos kërkohet paraqitja e mjeteve ndihmëse si p.sh elektrik dore etj, pasi këto kriterë përmbushen nga shoqëria që në momentin e licensimit të saj.

Akoma më tej, për sa kohë vërtetimi i elementëve të kërkuar nga autoriteti kontraktor si (*Shpenzimet për ndërlidhje (bazuar në tarifat vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin), Kapacitetet mbështetëse (transporti i punonjësve pasi kemi të bëjmë me objekte në një distancë të largët), Shpenzimet për sigurimin e përgjegjësis profesionale, Shpenzimet administrative dhe Fitimin e shoqërisë*), është i pamundur për tu përlllogaritur, për shkak të vetë natyrës së shërbimit që kërkohet të prokurohet, rrjedhimisht kërkesa për përlllogaritjen e tyre në formularin e ofertës, do të sillte konfuzion dhe paqartësi tek operatorët ekonomikë, duke ndikuar kështu si në momentin e përlllogaritjes së ofertave të tyre nga ana e operatorëve ekonomikë, edhe në fazën e vlerësimit dhe renditjes së ofertave nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe hartimi i dokumentave të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, me qëllim përfundimin e ofertës më të mirë ekonomike. Në rastin konkret, kërkesat e autoritetit kontraktor në lidhje me shpenzimet e përmendura më lart, krijojnë konfuzion tek ofertuesit lidhur me përgatitjen e ofertave të tyre ekonomike. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumentave të tenderit lidhur me formularin e ofertës, në përputhje me rekomandimin Nr.15166 prot. Nr. 1858 prot., datë 20.12.2017 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “Ne Shtojca 1 “Formulari i Ofertes Ekonomike”, autoriteti ka publikuar shenimin si ne vijim: Sqarime: Analiza e kostos • Operatoret jane te detyruar te paraqesin analizen e detajuar me menyren e perlllogaritjes se kostos per oferten e paraqitur si dhe preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cifat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM nr. 809, date 26.12.2018 per Percaktimin e Pages Minimale ne Shkalle Vendi”, Ligji Nr. 7961, date 12.7.1995, “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise”, te ndryshuar, Ligji 75/2014 “Per Sherbimin Privat te Siqurise Fizike”. Numri i punonjesve te nevojshem te sherbimit per nje vendroie me tre tume te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 per cdo punonjes sherbimi). Nderkohe qe referuar shtojces 9 “Specifikimet Teknike, Sherbimet & Grafiku I Ekzekutimit, Termat e References”, rezulton te jete i pa plotesuar fakt i cili krijon konfuzion gjate hartimit te ofertes ekonomike pasi ne shtojcen 1 eshte percaktuar 4.98 punonjes per vendroje ndersa ne shtojcen 9 eshte i pa percaktuar per nje vendroje kurse ne shtojcen 12 ka percaktuar numrin e punonjesve te sherbimit 5 per cdo vend/roje. Per sa me siper eshte detyre e autoritetit kontraktor te hartoje kriteret dhe specifikimet ne menyre te qarte dhe te sakte me qellim shmangien e konfuzionit te operatoret ekonomik ofertues, informacion i cili le vend per interpretim dhe per rrjedhoje edhe keqinterpretim duke mos i vene ne kushte barazie dhe kjo do te conte ne ofertime te ndryshme dhe vleresimi nga KVO do te ishte po i ndryshem. Ky informacion mund te sherbeje si pengese per konkurrencen e drejte ne prokurimin publik, ne kundersiztim me parimet e pergjithshme te prokurimit publik te percaktuara ne nenin 2 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Nga sa me siper, autoriteti kontraktor duhet te marre masa per te percaktuar qarte informacionin lidhur me numrin e rojeve per cdo vendroje (4.98 roje) ne te gjitha rubrikat e Dokumentave te Tenderit ku duhet te vendoset ky informacion si kusht i domosdoshem per plotesimin e ofertes nga ana e operatoreve ekonomike pjesmarres ne kete procedure prokurimi.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit, si dhe verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se nga komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, është pranuar ankesa e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues.

III.4.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 1 “Formulari i ofertës”, autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e shërbimit si më poshtë vijon:

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroj eve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Ruajtja me polici private e HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes	36	36	4.98		

		<i>Oferta Neto ne total</i>
		<i>TVSH (%)</i>
		<i>Oferta total</i>

Sqarime:

3. Në çmim të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, shtesat për Turnet e II-ta dhe III-ta, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, nderlidhje, kapacitetet mbeshtetese, shpenzimet për sigurimin e përgjegjesis profesionale, shpenzimet administrative, fitimi i shoqërisë etj.
4. Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi dhe analiza e detajuar e cmimit.

Preventiv të kostos për 1 roje në muaj, për 1 vëndroje me shërbim 24 orë

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj	Vlera (Lek) 1 vëndroje me tre turne /Muaj
1	<i>Shpenzime për pagë bazë</i>		
2	<i>Shtesë mbi pagë për turnin II</i>		
3	<i>Shtesë mbi pagë për turnin III</i>		
4	<i>Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%</i>		
5	<i>Shpenzimet për nderlidhje (bazuar në tarifën vjetore të Akep për Radiokomunikacionin dhe Radioalarmin)</i>		
6	<i>Kapacitetet mbeshtetese (transporti i punonjesve pasi kemi të bëjmë me objekte në një distancë të largët)</i>		
7	<i>Shpenzimet për sigurimin e përgjegjesis profesionale</i>		
8	<i>Shpenzimet administrative</i>		
9	<i>Fitimi i shoqërisë</i>		
	<i>Vlera totale pa tvsh për 1 roje në muaj</i>		
	<i>Vlera totale me tvsh për 1 roje në muaj</i>		

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zërave të mësipërm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM-së Nr. 809, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe akteve nenligjore në fuqi etj.

Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit dhe analizës së kostos, rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka të drejtë t’u kërkojë operatorëve ekonomik sqarime në lidhje me zërat e ofertës ekonomike dhe në rast se konstaton se operatori nuk e argumenton

dot aritmetikisht, ligjërisht dhe me dokumentacion mbështetës ofertën, autoriteti do ta s'kualifikojë.

- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit).
- Klasifikimi i ofertave behet mbi bazën e vlerës së ofertes së dhënë në total.

III.4.3. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor “Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor në shtojcën “Termat e referencës ka modifikuar kriterin si më poshtë:

[...]

Përshkrimi i Shërbimeve:

Objektet për të cilat kërkohet shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike;

1. HEC Fierze - 10 (dhjetë) vendroje, me 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë.
2. HEC Koman – 12 (dymbëdhjet) vendroje, me 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë.
3. HEC Vau Dejes - 14 (katërmëdhjetë) vendroje, me 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë.

[...]

- Në çdo vendroje duhet të kalojnë me shërbim me turne 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi, duke marrë dhe dorëzuar shërbimin me proces-verbal kundrejt firmës.

[...]

III.4.4. Referuar shkresës nr. 3513/3 prot., datë 22.08.2019 të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. Konkretisht, referuar aktit të mësipërm, KPP konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor janë pranuar kërkimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me përcaktimin e saktë të numrit të vendrojeve në të gjitha shtojcat e dokumentave të tenderit. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP konstaton se, nga e autoritetit kontraktor janë reflektuar në sistemin e prokurimeve elektronike ndryshimet (shtojcë e dokumenteve të procedurës së prokurimit) në lidhje me vendimarrjen e KSHA. Pra, sa më sipër, autoriteti kontraktor në lidhje me pretendimin e mësipërm ka pranuar ankesën dhe ka publikuar shtojcën me ndryshimet përkatëse, në sistemin e prokurimeve elektronike.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, duke qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. në lidhje me pretendimin e mësipërm, është pranuar nga autoriteti kontraktor, dhe janë pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse, në SPE në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, rrjedhimisht ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim në themel, pasi nuk eksiston më si objekt ankimi.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: “Ne Shtojca 12 "Termat e References", autoriteti ka publikuar kriteret e kualifikimit që duhet të paraqesin operatorët ekonomik. Nderkohe që ky veprim bie në kundërshtim me LPP dhe vetë Dokumentat e Tenderit dhe konkretisht me shtojcën Shtojca 8 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", rubrike e cila është

vendi ku percaktohen kriteret e vecanta te kualifikimit. Autoriteti nuk mund te dubloje kriteret e vecanta te kualifikimit duke i vendosur sa ne shtojcen 10 dhe ne shtojcen 12. Per sa me siper, kerkojme heqjen e kriterëve te kualifikimit nga shtojca 12 "Termat e References" dhe nga cdo rubrike tjeter qe nuk ka te beje me shtojcen 8 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" dhe lenien e tyre vetem ne shtojcen 8. Kerkesa per kriteret e kualifikimit eshte pranuar qe te hiqen nga shtojca e termave te references por Autoriteti Kontraktor nuk ka pranuar qe te percaktohet sakte numri i punonjesve pasi tek prevetivi numri i punonjesve eshte 4.98 roje/vend/roje dhe tek termat e references eshte 5 roje/vend/roje” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se autoriteti kontraktor nuk ka pranuar që të përcaktohet saktë numri i punonjësve pasi tek prevetivi numri i punonjësve është 4.98 roje/vend/roje dhe tek termat e referencës është 5 roje/vend/roje, KPP ka sqaruar ne arsyetimin e pikave III.4. deri III.4.4. të këtij vendimi se, referuar shkresës nr. 3513/3 prot., datë 22.08.2019 të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. Konkretisht, referuar aktit të mësipërm, KPP konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor janë pranuar kërkimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me përcaktimin e saktë të numrit të vendrojeve në të gjitha shtojcat e dokumentave te tenderit. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP konstaton se, nga e autoritetit kontraktor janë reflektuar në sistemin e prokurimeve elektronike ndryshimet (shtojcë e dokumenteve të procedurës së prokurimit) në lidhje me vendimarrjen e KSHA. Pra, sa më sipër, autoriteti kontraktor në lidhje me pretendimin e mësipërm ka pranuar ankesën dhe ka publikuar shtojcën me ndryshimet përkatëse, në sistemin e prokurimeve elektronike.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, duke qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. në lidhje me pretendimin e mësipërm, është pranuar nga autoriteti kontraktor, dhe janë pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse, në SPE në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, rrjedhimisht ky pretendim nuk do të merret në shqyrtim në themel, pasi nuk eksiston më si objekt ankimi.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Kerkesa per paraqitjen e 165 certifikatave nuk eshte ne perpjestim te drejte me numrin e punonjesve per zbatim e kontrates, ne te cilet eshte specifikuar se sherbimi do te kryhet ne 36 vendroje me 4.98 punonjes per vendroje me tre tume (tumi I, II dhe III-te) ne total bejne 179.8 punonjes sherbimi. Per sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit si ne vijim: • "Operatori ofertues duhet te paraqese 179.28 (njqind e shtatedhjet e nente pike njezet e tete) certifikata profesionale per ushtrim profesioni te rojes leshuar nga DPQ Kukes 50 (pesedhjet) dhe 129.28 certifikata profesionale per ushtrim profesioni te rojes leshuar nga DPQ Shkoder" vendosja e kriterit per 45 certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukes, 120 certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder*

perputhet me numrin e punonjesve te certifikuar qe kane aktualisht firma "Eurogjici-Security" ne Qarkun Kukes 45 dhe numrin e punonjesve te certifikuar qe kane firmat "Eurogjici-Security" dhe "NSS Ndreu security servis" ne qarkun e Shkodres 120." Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", pika 3.1.4 "Kapaciteti ligjor/professional i operatorëve ekonomikë", autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë vijon:

1. *Certifikata per punonjes sherbimi nenkategoria 1.3.A per 165 punonjes sherbimi, prej te cilave:*

- *45 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukes, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 30 punonjes;*
- *120 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 100 punonjes;*

III.6.2. Në shtojcën 8 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 4 dhe pika 5, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

4. *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukes, me anë të cilit të jepet informacion për:*

- *Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,*
- *Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,*
- *Grup të gatshëm*
- *Jo më pak se 45 punonjës shërbimi*
- *Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,*
- *Jo me pak se 10 arme krahu,*
- *Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*
- *Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*
- *Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*
- *Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*
- *Ka performance pozitive.*

5. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:*

- *Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,*
- *Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,*
- *Grup të gatshëm,*
- *Jo me pak se 120 punonjes shërbimi të certifikuar,*
- *Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,*
- *Jo me pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,*
- *Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*
- *Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,*

- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

III.6.3. Në shtojcën 11 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet:

Shërbimi që kërkohet: Ruajtja e objekteve ne HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes

Afatet e ekzekutimit: Shërbimi i ruajtjes duhet te sigurohet per 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

III.6.4. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 1 “Formulari i ofertës”, autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e shërbimit si më poshtë vijon:

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendrojeve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Ruajtja me polici private e HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes	36	36	4.98		
	Oferta Neto ne total					
	TVSH (%)					
	Oferta total					

III.6.5. Gjithashtu, në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor “Për modifikimin e dokumenteve te tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka modifikuar shtojcën “Termat e referencës” si më poshtë vijon:

[...]

Përshkrimi i Shërbimeve:

Objektet për të cilat kërkohet shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike;

2. HEC Fierze - 10 (dhjetë) vendroje, me 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë.
3. HEC Koman – 12 (dymbëdhjet) vendroje, me 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë.
4. HEC Vau Dejes - 14 (katërmëdhjetë) vendroje, me 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë.

III.6.6. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.6.7. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.6.8. Gjithashtu, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, neni 28, pika 1 dhe 2, parashikohet si më poshtë: “*1. Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.*

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.6.9. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se numri i kërkuar i punonjësve prej 165 punonjës shërbimi të pajisur me certifikatë nënkategoria 1.3.A, nuk është nuk është në proporcion me numrin total të punonjësve të shërbimit që nevojiten për realizimin e kontratës objekt prokurimi ku referuar shtojcës 1 “*Formulari i ofertës*” si dhe shtojcës 12 “*Termet e referencës*” nga vetë autoriteti kontraktor është parashikuar që për realizimin e këtij shërbimi nevojiten 36 vendroje, me numër 4.98 roje për cdo vendroje, për një periudhë 36 muaj. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka përcaktuar 10 vendroje, me 4.98 punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3 (tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë për HEC Fierze; 12 vendroje, me 4.98 punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3 (tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë për HEC Koman; 14 vendroje, me 4.98 punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë për HEC Vau Dejes. Sa më sipër, nga përllogaritjet, KPP konstaton se për kryerjen e shërbimit nevojiten në total një numër më i lartë punonjësish së sa numri 126 që ka përcaktuar autoriteti kontraktor në pikën 3.1.4 të “*Kapaciteti ligjor*”, të dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi. Akoma më tej autoriteti kontraktor në hartimin e kritereve nuk është treguar koherent pasi nga njëra anë kërkon nga ana e operatorëve ekonomikë të ofrojnë shërbimin e tyre për 36 vendroje, me 4.98 roje për 1 vendroje, dhe nga ana tjetër kërkon që të disponojnë 165 punonjës të certifikuar.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se, duke qenë se kjo procedurë sipas arsytimit në pikën III.1. e në vazhdim të këtij vendimi duhet të ndahet në lote, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kriterin në lidhje me numrin e punonjësve të shërbimit të pajisur me certifikata, sipas nevojave për secilin objekt, sipas loteve përkatëse.

Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k se: *“Kerkojme heqjen e Autorizimit te armeve pasi pajisja me kete dokument per punonjesit e sherbimit behet vetem pasi lidhet kontrata nga firma fituese sipas plan dislokimit. Pretendimi i Autoriteti Kontraktor ne kthim pergjigje se nuk kemi kerkuar Autorizim per mbajtje arme nuk qendron pasi ne kriteret per kualifikim dhe ne shtojcen e hedhur me 26.08.2019 kerkohet qe bashkelidhur certifikatave te punonjesve duhet te shoqerohen dhe me 30 autorizime mbajtje arme per qarkun Kukes dhe 100 autorizime per qarkun Shkoder. Kerkojme heqjen e Autorizimit te armeve pasi paisja me kete dokument per punonjesit e sherbimit behet vetem pasi lidhet kontrata nga firma fituese sipas plan dislokimit.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, pika 3.1.4 *“Kapaciteti ligjor/professional i operatorëve ekonomikë”*, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë vijon:

Certifikata per punonjes sherbimi nenkategoria 1.3.A per 165 punonjes sherbimi, prej te cilave:

- *45 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 “Per sherbimin privat te sigurise fizike”, leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Kukes, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 30 punonjes;*
- *120 Certifikata brenda afatit 4 vjecar sipas nenit 5 te ligjit Nr.75/2014 “Per sherbimin privat te sigurise fizike”, leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder, shoqeruar me autorizim arme minimalisht 100 punonjes;*

III.7.2. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 28, pika 2 dhe 5, parashikohet si më poshtë:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

5. *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.7.3. Referuar ligjit 74/2014, datë 10.07.2014 “Për armët”, neni 5 “Kategorizimi i armëve” parashikon shprehimisht se: “1. Armët, sipas këtij ligji, kategorizohen si më poshtë:

1.2. Armët e kategorisë “B” janë:

a) armët e shkurtra të zjarrit gjysmautomatike apo vetërimbushëse (B1);

b) armët e zjarrit të shkurtra për një qitje, me ndezje qendrore (B2);

c) armët me ndezje anësore të shkurtra për një qitje, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28cm; (B3);

ç) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të mbajnë më tepër se tre fishekë (B4);

d) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të pranojnë deri në tre fishekë. Kur mbushësi i tyre ndërrohet, këto armë mund të konvertohen, me ndihmën e një mjeti të zakonshëm, dhe të pranojnë më tepër se tre fishekë (B5);

dh) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike ose me përsëritje, me tytë të pavjaskuar, të gjatë deri në 60 cm (B6);

e) armët e zjarrit pneumatike, me energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm (B7);

[...];”

Gjithashtu, në nenin 7 “E drejta e pronësisë mbi armët”, të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht se:

“1. Armët e kategorisë “A”, në kuptim të këtij ligji, janë vetëm pronë e shtetit, me përjashtim të armëve të zjarrit të gjuetisë dhe ato sportive me vjaska dhe të pajisura me shënjestër optike.

2. Armët e kategorive “B”, “C” dhe “D”, në kuptim të këtij ligji, mund të jenë në pronësi private e shtetërore.

3. Veprimet juridike për kalimin e pronësisë ose të të drejtave të tjera mbi armët kryhen në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

4. Për sa nuk parashikohet në këtë ligj, zbatohen dispozitat e Kodit Civil.”

Ndërsa neni 8 i ligjit “Regjimi juridik për kategoritë e armëve” përcaktohet se: “[...] Për armët e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, ka regjim të veçantë juridik ,duke respektuar përfshirjen në kategoritë e ndryshme, si më poshtë:

1. Në kategorinë “A” përfshihen armë, të cilat nuk lejohen të përdoren dhe për të cilat nuk lëshohet autorizim, me përjashtim të armëve të zjarrit të gjuetisë dhe ato sportive me vjaska, të pajisura me shënjestër optike, që në kuptim të këtij ligji nuk janë të ndaluara. Për këto armë, pajisen me autorizim nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, ata shtetas shqiptarë ose të huaj që vërtetojnë aftësinë e ushtrimit të sportit të qitjes profesionale ose gjuetisë, sipas vërtetimit/lejes përkatëse nga ministria përgjegjëse për sportet ose ajo për mjedisin.

2. Në kategorinë “B” përfshihen armë, për të cilat lëshohet autorizim sipas këtij rregulli:

a) për armët e kategorisë “B1”, pajisen me autorizim personat që për shkak të detyrës shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë, sipas legjislacionit në fuqi, personat që plotësojnë kriteret për mbajtjen e armës, si dhe ata të cilëve për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private u lind e drejta e mbajtjes së armës, sipas këtij ligji;

- b) *për armët e kategorisë "B4", pajisen me autorizim personat që për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private, u lind e drejta e mbajtjes së armës, sipas dispozitave të këtij ligji.*
[...].”

III.7.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar konfuzionin sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijon efektin e konfuzionit dhe paqartësisë tek operatorëve ekonomikë në përgatitje e ofertës.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

“2. Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik*

III.7.5. Në Ligjin Nr. 75/2014 *“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”*, neni 27 *“Përgjegjësitë e punonjësit të shërbimit”*, pika *“c”* parashikon se:

[...] Punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike vepron me cilësinë e rojës, të trupprojës, të operatorit, të shoferit, si mbajtës i qenit, si dhe të përgjegjësit të shërbimit dhe ka këto përgjegjësi:
c) të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e SHPSF-së, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi”

Ndërsa sipas nenit.34, po këtu, thuhet se *“[...] në veprimtarinë e sigurisë fizike të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, e kanë drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit. Lloji i armëve të zjarrit dhe municionit të tyre që jepen për mbajtje, miratohen nga Policia e Shtetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi [...].”*

III.7.6. Referuar bazës ligjore sa më sipër përcaktohet qartë se çdo person i pajisur me certifikatën si punonjës shërbimi për ruajtjen dhe sigurinë fizike, ka të drejtën për përdorimin edhe të armës së zjarrit. Në këtë kontekst, çdo person i pajisur me leje/certifikatën si punonjës shërbimi, ka të drejtë për përdorimin e armës së zjarrit. Komisioni gjykon se kriteret lidhur me armatimin duhet të hartohen nga autoriteti kontraktor duke mbajtur në vëmendje legjislacionin mbi armët që i japin të drejtën, cdo operatori ekonomik që ushtron aktivitet në fushën e shërbimit të sigurisë së ruajtjes fizike, të pajisjen me armatim personal sipas ligjit, duke dëshmuar në procedurat prokuruese plotësimin e kapacitetve lidhur me armatimin. Në këtë kontekst autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar, duke hequr kërkesën “autorizim për mbajtje arme”, pasi nuk është në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqese deshmi ku të kete realizuar sherbime te ngjashme, ne nje vlere sa 40 % e fondit limit qe prokurohet, te realizura gjate tre viteve te fundit nga data e hapjes se tenderit. Per te vertetuar kete Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetime te cilesise se kryerjes se saj. Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sherbimet e realizuara. Autoriteti Kontraktor ka pranuar qe per sherbime te ngjashme te paraqiten vertetime per realizim kontrate por ka shtuar fjalet shoqeruar me fatura tatimore shitje. Kerkojme qe te hiqet fjala shoqeruar me fatura tatimore shitje pasi kjo kerkese kerkohet kur sherbimet jane realizuar me subjekte private.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 3.3.1 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka parashikuar përcaktuar si më poshtë vijon:

1. Shërbime të ngjashme:

- Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme kat. (1.3.A) në një vlerë sa 166,000,000 leke, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së tenderit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët duhet të paraqesin:

Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte shtetërore duhet të paraqiten Kontrat/ kontrata të realizuara, shoqëruar me Vërtetimin e realizimit me sukses lëshuar nga autoriteti përkatës kontraktor, i cili duhet të përmbajë, Afatin, Vlerën, Objektin. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimitisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Ose

- Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte private duhet të paraqiten Kontrat/ kontrata të realizuara të shoqëruara me Faturat përkatëse tatimore të shitjes të firmosura dhe vulosura nga të dyja palët dhe Vërtetimin e përfundimit me sukses të saj, lëshuar nga subjekti privat i cili duhet të përmbajë, datat, Afatin, Vlerën, Objektin. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimitisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

III.8.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor “Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin e mësipërm si më poshtë vijon:

[...]

1. Shërbime të ngjashme:

- Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme kat. (1.3.A) në një vlerë jo më të vogël se 166,000,000 leke, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së tenderit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët duhet të paraqesin:

Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte shtetërore duhet të paraqiten Vërtetimet e realizimit me sukses lëshuar nga autoriteti përkatës kontraktor si dhe faturat tatimore përkatëse ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimsht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik.

Ose

- Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte private duhet të paraqiten faturat përkatëse tatimore të shitjes të firmosura dhe vulosura nga të dyja palët ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimsht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik”.

III.8.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.8.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3, parashikohet si më poshtë:

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

“Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”

III.8.5. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor, parashtimeve me shkrim të ankimuesit, si dhe verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se nga komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, është pranuar ankesa e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me pretendimin e mësipërm.

Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, të ngritur pranë Komisionit të Prokurimit Publik më argumentin se *“autoriteti kontraktor ka pranuar që për shërbime të ngjashme të paraqiten vërtetime për realizim kontrate, por ka shtuar fjalët shoqëruar me fatura tatimore shitje. Kërkojmë që të hiqet fjala shoqëruar me fatura tatimore shitje pasi kjo kërkesë kerkohet kur shërbimet jane realizuar me subjekte private”*, gjykojmë se, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet ekonomike, besueshmërinë, dhe përvojën e duhur, në përputhje dhe në përpjestim me volumin e kontratës objekt prokurimi, për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin se, duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: *“mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”*, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

III.8.6. Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstaton se ky i fundit, ka pranuar pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, dhe ka modifikuar kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme, duke kërkuar shprehimisht *“Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme kat. (1.3.A) në një vlerë jo më të vogël se 166,000,000 leke, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së tenderit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme operatorët duhet të paraqesin: Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte shtetërore duhet të paraqiten Vërtetimet e realizimit me sukses lëshuar nga autoriteti përkatës kontraktor si dhe faturat tatimore përkatëse ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik. Ose - Në rastet kur shërbimet janë kryer me subjekte private duhet të paraqiten faturat përkatëse tatimore të shitjes të firmosura dhe vulosura nga të dyja palët ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rast se kontrata është realizuar si bashkim operatorësh, operatori duhet të paraqesë detyrimisht edhe akt-marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaçme ku përcaktohet përqindja e shërbimit për secilin operator ekonomik”*.

Nga verifikimi i dokumentave të tenderit dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, kriteri në lidhje me kontratat e ngjashme është përcaktuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe në përpjesëtim me objektin e kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike,

profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart, referuar edhe argumentimit të autoritetit kontraktor, KPP vlerëson se kjo kërkesë është në përpjesëtim me objektin e prokurimit dhe në përputhje me parashikimet ligjore, konkretisht nenin 28 pika 3 të Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

III.8.9. Gjithashtu, KPP, vlen të theksojë se, duke qenë se kjo procedurë sipas arsytimit në pikën III.1. të këtij vendimi duhet të ndahet në lote, autoriteti kontraktor në modifikimin e dokumentave të tenderit duhet të ketë parasysh që, vlera limit që kërkohet për vërtetimin e eksperiencës së ngjashme, duhet të jetë sipas përcaktimeve ligjore, në përputhje me vlerën që do të ketë secili Lot.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se: *“Referuar sa me sipër, shoqëria jone gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për ... "Te ketë në listë emergjente të pakten 165 punonjës të licensuar nga DPQ" është joproporcionale pasi nuk plotëson volumin dhe përmasat e kontratës që prokurohet, në kushtet kur kërkohet që shërbimi i ruajtjes të kryhet në 36 (tridhjetë e gjashtë) vendndodhje me tre tume, me 4.98 punonjës shërbimi. Numri i punonjësve të shërbimit i përcaktuar në kriterin e vecantë të kualifikimit është joproporcional me objektin e prokurimit, dhe ndikon në uljen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si dhe bën ndesh me frëmën e ligjit i cili parashikon se kriteret për kualifikimin duhet të hartohen në atë mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e sa më shumë ofertuesve në procedurën e prokurimit. Për autoritetin është e rëndësishme të vërtetohet se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (në rastin konkret punonjës shërbimi), mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të realizojë objektin e prokurimit dhe për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, në përputhje me përmasat e kontratës që do të prokurohet (50 punonjës shërbimi për Qarkun Kukës dhe 129.28 për Qarkun Shkoder).*

Kërkesa e mësipërme ku kërkohet ... "për operatorë" është një kërkesë që vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e komisionit të prokurimeve publike pasi është një numër tepër i ekzagjeruar. Për autoritetin kontraktor është e mjaftueshme të provohet nga operatorët ekonomikë se disponojnë operator pa vënë kufi mbi numrin e tyre.

Madje, Komisioni i Prokurimeve Publike me vendimin Nr. 15/2017, datë 18.01.2017, si organi më i lartë që merr vendime administrativisht përfundimtare, ka vendosur që kërkesa për operatorë sille, është një kërkesë e ekzagjeruar.

Konkretisht KPP ka vendosur: [...]

Për sa më sipër kërkojmë ndryshimin e kërkesës duke kërkuar disponim të operatorëve pa përmendur numër.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti teknik”*, pika 4 dhe pika 5, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

4. "Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukes, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 10 arme krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm,
- Jo me pak se 120 punonjes shërbimi të certifikuar,
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

III.9.1.2. Në shtojcën 11 "Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet:

Shërbimi që kërkohet: Ruajtja e objekteve ne HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes

Afatet e ekzekutimit: Shërbimi i ruajtjes duhet te sigurohet per 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

III.9.1.3. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 1 "Formulari i ofertës", autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e shërbimit si më poshtë vijon:

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroj eve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)

1.	<i>Ruajtja me polici private e HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejes</i>	36	36	4.98		
		<i>Oferta Neto ne total</i>				
		<i>TVSH (%)</i>				
		<i>Oferta total</i>				

III.9.1.4. Gjithashtu, në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor “Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka modifikuar shtojcën “Termat e referencës” si më poshtë vijon:

[...]

Përshkrimi i Shërbimeve:

Objektet për të cilat kërkohet shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike;

1. *HEC Fierze - 10 (dhjetë) vendroje, me 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë.*
2. *HEC Koman – 12 (dymbëdhjet) vendroje, me 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë.*
3. *HEC Vau Dejes - 14 (katërmëdhjetë) vendroje, me 4.98 (kater pike nentedhjetë e tete) punonjës shërbimi për çdo vendroje, me 3(tre) turne 24-orë nga e hëna në të dielë.*

III.9.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.9.1.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose*
- c) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- ç) *dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.9.1.7. Gjithashtu, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 1 dhe 2, parashikohet si

më poshtë: “1. Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.9.1.8. Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.9.1.9. Sa më sipër, KPP nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, gjykon se, referuar arsyetimit të këtij vendimi në pikën III.6 të tij, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë numrin e punonjësve të shërbimit të kërkuar, të cilët duhet të jenë të pajisur me certifikata të kategorisë 1.3.A, në përputhje me numrin e rojeve dhe të vendrojeve të kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor, më qëllim realizimin e shërbimit. Rrjedhimisht, edhe në kriterin e vecantë të kualifikimit, pika 3.3.4 dhe 3.3.5 e kapacitetit teknik, numri i punonjësve të shërbimit duhet të përcaktohet në përputhje me numrin e rojeve dhe të vendrojeve të përcaktuar nga autoriteti kontraktor për këtë shërbim.

Gjithashtu vlen të theksojmë se, duke qenë se në zbatimin të këtij vendimi (referuar arsyetimit në pikën III.1.) kjo procedurë do të ndahet në lote, rrjedhimisht, numri i punonjësve të shërbimit duhet të përcaktohet për secilin lot, në përputhje me numrin e rojeve dhe të vendrojeve të kërkuar për secilin objekt.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.9.2. Në lidhje më pretendimin e ankimuesit “Trezhnjeva” sh.p.k. se “Kërkesa e mesiperme ku kerkohet... “Te kete pergjegjes sherbimesh”, eshte jo proporcionale me objektin e kontrates. Per autoritetin eshte e rendesishme te vertetoje se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike, mjaftueshem sa te jete ne gjendje te realizoje kontraten, objekt i ketij prokurimi. Percaktimi i pergjegjesve te sherbimit, ka te beje me organizimin e brendshem te shoqerise dhe artifica te tilla nuk i sherbejne qellimit per te cilin vendoset kriteri, perkundrazi kufizojne pjesmarrjen dhe konkurencen. Per sa me sipër, kerkojme heqjen e kerkeses per pergjegjes sherbimi”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.9.2.1. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.9.2.2. Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për “jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për autoritetin është e rëndësishme të vërtetojë se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike, mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të realizojë kontratën, objekt i këtij prokurimi. Autoriteti kontraktor, duke qenë përfituesi direkt i shërbimit që prokurohet dhe në mënyrë që të krijojë një panoramë sa më të qartë mbi kapacitetet e operatorëve ekonomikë, mund ti parashikojë kërkesat e mësipërme në cilësinë e të dhënave që vetë SHPSF-të informojnë me shkrim, të paktën një herë në muaj, në strukturën përkatëse të Policisë së Shtetit dhe ky i fundit i pasqyron në vërtetimet përkatëse. Në këtë kontekst kërkesa e autoritetit kontraktor për “jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi”, është propocionale me objektin e prokurimit pasi nuk e tejkalon volumin dhe përmasat e kontratës që prokurohet, në kushtet kur objekt i prokurimit janë 3 objekte më rëndësi të lartë dhe kompleks për nga natyra e tyre. Pra, nisur nga rëndësia e shërbimit që do të kryhet, interesit publik që ajo ka, objektit të prokurimit, vlera e lartë e investimit të kësaj procedure prokurimi dhe kompleksitetit e specifikës së saj, KPP gjykon se, kërkesa për 2 përgjegjës shërbimi është një kërkesë e drejtë.

Akoma më tej, theksojmë se, duke qenë se kjo procedurë sipas arsytimit në pikën III.1. të këtij vendimi duhet të ndahet në lote, autoriteti kontraktor në modifikimin e dokumentave të tenderit duhet të përcaktojë kërkesën për përgjegjës shërbimi, duke patur parasysh përmasat dhe vlerën e secilës procedurë që do të shpallet, sipas secilit Lot.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.9.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k. se “Kërkesa e mesiperme ku kerkohet ... "krahu" "arme brezi", ... "Te autorizim per mbajtje arme" si dhe 26 arme krahu dhe 8 arme brezi, eshte nje kerkese qe vjen ne kundershtim me legjislacionin ne fuqi. Me vendimin Nr. 15/2017, date 18.01.2017, Komisioni i Prokurimeve Publike, si organi me i larte qe merr vendime administrativisht perfundimtare, ka vendosur qe kerkesa per arme dhe autorizim armesh ne kete faze te prokurimit, eshte nje kerkese ne kundershtim me ligjin. Konkretisht KPP ka vendosur: [...] Per sa me siper, kerkojme heqjen nga kriteri te kerkeses per "arme Krahu", "arme brezi", “autorizim per mbajtje arme”. Kjo kerkese e dubluar nga Autoriteti Kontraktor plotesohet plotesisht ne kerkesen e percaktuar:

“Operatori ekonomik duhet te disponoje 28 arme krahu, kategoria 1.3.A vertetuar me:

- Autorizim per blerje armesh leshuar nga Drejtoria e Policise Shtetit,
- Kontrate Shitblerje,
- Fatura Shitblerje dhe
- Pagesen Bankare

Operatori ekonomik duhet te disponoje 8 arme brezi, kategoria 1.3 A vertetuar me:

- Autorizim per blerje armesh leshuar nga Drejtoria e Policise Shtetit,
- Kontrate Shitblerje,
- Fatura Shitblerje dhe
- Pagesen Bankare”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 4 dhe pika 5, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

4. "Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 10 arme krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm,
- Jo me pak se 120 punonjes shërbimi të certifikuar,
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

III.9.3.2. Gjithashtu, në shtojcën 8 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 7 dhe pika 8, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

7. Operatori ekonomik duhet të disponojë 28 armë krahu, kategoria 1.3.A vërtetuar me:

- Autorizim për blerje armësh lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit,
- Kontratë Shitblerje,
- Fatura Shitblerje dhe
- Pagesën Bankare

8. Operatori ekonomik duhet të disponojë 8 armë brezi, kategoria 1.3 A vërtetuar me:

- Autorizim për blerje armësh lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit,
- Kontratë Shitblerje,
- Fatura Shitblerje dhe
- Pagesën Bankare

III.9.3.3. Në ligjin nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", neni 24 "Përgjegjësitë e titullarit të subjektit të SHPSF-ve", gërma "e", është parashikuar si më poshtë:

“Titullari i SHPSF-së është përfaqësuesi ligjor i subjektit të licencuar që ofron shërbimin për sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, të personave, të veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike, si dhe për sigurimin e vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, të kontraktuara, dhe ka këto përgjegjësi:

- Të informojë me shkrim, të paktën një herë në muaj, në strukturën përkatëse të Policisë së Shtetit, për veprimtarinë e SHPSF-së.”

Neni 27, pika “c” e këtij ligji parashikon se *“[...] punonjësi i shërbimit ka përgjegjësi të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shënjat dhe simbolet e SHPSF-së, vetëm gjatë kryerjes së detyrës si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi.”*

Ndërsa sipas nenit 34, po këtui, thuhet se *“[...] në veprimtarinë e sigurisë fizike të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, e kanë drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit. Lloji i armëve të zjarrit dhe municionit të tyre që jepen për mbajtje, miratohen nga Policia e Shtetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi [...].”*

III.9.3.4. Komisioni, referuar bazës ligjore të sipërcituar gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor në kriterin e sipërcituar, që vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të përmbajë të dhëna/të pasqyrojë informacion në lidhje me disponueshmërinë faktike të armëve të zjarrit (konkretisht armë krahu dhe armë brezi) nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, është një kërkesë e drejtë dhe e bazuar. Në këtë kontekst duke qenë se Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës është institucioni kompetent, i cili përgjigjet për veprimtarinë e sh.p.s.f.-ve dhe për këtë qëllim lëshon vërtetimet përkatëse, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm i kërkuar nga autoriteti kontraktor mund të provohet me këtë dokument (vërtetim nga D.P.Q përkatës) dhe është një dokumentacion/informacion që sigurohet lehtësisht nga ana e operatorëve ekonomikë.

Por, Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, gjykon se, kriteri në lidhje me armatimin, është konfuz, me kërkesa të dubluara të kërkuara më shumë se një herë dhe me dokumentacion të ndryshëm. Konkretisht ky kriter është kërkuar si në pikën 3.3.4 dhe 3.3.5 të kapacitetit teknik, në kriteret e veçanta të kualifikimit edhe në pikën 3.3.7, duke krijuar konfuzion dhe dublikim të këtij kriteri.

Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit duke shmangur përsëritjet e kërkesave dhe duke kërkuar në mënyrë të qartë të gjitha kapacitetet që kërkon të provohen me anë të Vërtetimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut dhe të mos i përsërisë këto kërkesa në kriteret të tjera. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë dokumentacion të ndryshëm për të provuar të njëjtat kapacitete pasi në këtë mënyrë veçse rëndon pozitën e operatorëve ekonomikë pjesmarrës. Konkretisht, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, duhet të heqë kriterin 3.3.7 të kapacitetit teknik, si një kërkesë të tepër dhe të dubluar.

Akoma më tej, theksojmë se, duke qenë se kjo procedurë sipas arsytimit në pikën III.1. të këtij vendimi duhet të ndahet në lote, autoriteti kontraktor në modifikimin e dokumentave të tenderit duhet të ketë parasysh, të përcaktojë numrin e armëve të nevojshme, sipas secilit lot.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.9.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k se:”Operatori Ekonomik, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 157 datë 01.04.2015, Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, Pika 9, të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier në të cilën pasqyrohet informacioni i mëposhtëm;

- Që ka operator në qendrën e kontrollit;

Ky kriter është i ekzagjeruar, pasi në rastin konkret për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që operatorët ekonomikë të disponojnë sallë operative në Qarkun përkatës, vërtetuar me vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut dhe aktmiratimi përkatës lëshuar po nga Drejtoria e Policisë së Qarkut, i cili është institucioni kompetent për verifikimin e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë. Mënyra se si operatorët ekonomikë organizojnë shërbimin në qendrën e kontrollit është çështje e brendshme organizative e tyre. Për sa më sipër kërkojmë heqjen e kriterit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 4 dhe pika 5, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

4.”Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukes, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 10 arme krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm,
- Jo me pak se 120 punonjes shërbimi të certifikuar,
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,

- *Ka performance pozitive.*

III.9.4.2. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 22 “Qendra e kontrollit të SHPSF-së”, është përcaktuar: “Subjekti i licencuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari, duhet të ketë qendër kontrolli, ku të tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emërtimin e shoqërisë.

Qendra e kontrollit të shërbimit kryen detyrat e drejtimit, mbikqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë së sigurisë fizike.

Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë.”

III.9.4.3. Në Udhëzimin e Ministrit të Punëve të Brendshme Nr.130, datë 05.03.2018 “Për Funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, Kreu V “Menaxhimi i Shërbimeve të SHPSF-së”, në pikën 11 dhe 13 është parashikuar:

11. Veprimtaria e SHPSF-së realizohet nëpërmjet organizimit të shërbimit me:

- a) roje objekti për ruajtjen fizike;
- b) truproje për ruajtjen e personave;
- c) sisteme sinjalizuese elektronike për ruajtjen e objekteve;
- d) punonjës shërbimi operator në qendrën e kontrollit;
- e) punonjës shërbimi për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë të lidhura me sisteme elektronike;
- f) përgjegjës shërbimi;
- g) punonjës shërbimi (shofer) për drejtimin e automjetit;
- h) punonjës shërbimi për drejtimin e motoçikletës;
- i) shoqërues i qenit të shërbimit.

13. Për verifikimin e sinjaleve elektronike për objektet që janë lidhur me këto sisteme, SHPSF-ja detyrohet të mbajë të gatshëm një grup punonjësish me përbërje jo më pak se 2 (dy) punonjës për çdo turn. Koha e reagimit përcaktohet në kontratën e lidhur mes palëve.

III.9.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të ruajtjes me roje të objekteve duhet të kenë qendër kontrolli të shërbimit për mbikqyrjen e veprimtarisë që shoqërisë, e cila përmban mjetet dhe pajisjet e nevojshme. Gjithashtu, duke qenë se në qendrat e kontrollit, shërbimi kryhet me operator dhe punonjësi i shërbimit, në zbatim të ligjit, vepron edhe në cilësinë e operatorit, kërkesa e autoritetit kontraktor që subjekti të ketë të punësuar operatorë për Qendrën e Kontrollit të SHPSF-së (sallën operative) me Vërtetim nga Drejtoria e Policisë Qarkut, është i nevojshëm.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në veprimtarinë e organizimit të shërbimit të një shoqërie private të sigurisë fizike përfshihet edhe operatori dhe kjo kërkesë gjen pasqyrim shprehimisht në veprimtarinë e SHPSF-ve sipas pikës 11/d të udhëzimit të mësipërm.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Aktiviteti i SHPSF-ve raportohet nga këto shoqëri në Drejtorinë e Policisë, e cila, nga ana saj, kryen evidentimin dhe kontrollin e aktivitetit të shoqërisë të cilat i pasqyrojnë më pas në vërtetimet

që lëshon për këtë qëllim. Pra, vërtetimi i Drejtorisë së Policisë së Qarkut përkatës duhet të japë informacion lidhur me zotërimin e operatorëve të kërkuar për kryerjen e shërbimit në fjalë. Në këtë kontekst duke qenë se Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës është institucioni kompetent, i cili përgjigjet për veprimtarinë e sh.p.s.f.-ve dhe për këtë qëllim lëshon vërtetimet përkatëse, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i mësipërm i kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet të provohet me këtë dokument (vërtetim nga D.P.Q përkatëse) dhe është një dokumentacion/informacion që sigurohet lehtësisht nga Drejtoria e Policisë së Qarkut përkatës.

III.9.4.5. Përsa i përket pretendimit të ankimuesit për heqjen e numrit të operatorëve të qendrës së kontrollit, që në rastin konkret janë kërkuar 5 operatorë, KPP gjykon se, nisur nga shërbimi i kërkuar nga autoriteti kontraktor për 36 vendroje me 4.98 roje për 1 vendroje, me tre turne, si dhe rëndësia e objekteve që kërkohet të ruhen, kërkesa për 5 operatorë në qendrën e kontrollit është një kërkesë e drejtë dhe në përputhje me objektin dhe shërbimin e kërkuar për këtë procedurë prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të vërtetojë se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike (në rastin konkret kapaciteti për operator për qendrën e kontrollit), mjaftueshëm sa të jetë në gjendje të realizojë kontratën objekt i këtij prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. se: *“Legjislacioni i prokurimit publik i ka percaktuar qarte rastet kur nje operator mund te perjashtohet nga pjesmarrja ne nje procedure prokurimi dhe ky rast nuk eshte i perfshire. Per sa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe ka te beje me • Nuk ka masa administrative per vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi, • Nuk ka shkelje te konstatuara per vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi, • Nuk ka ngjarje te ndodhura per vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi, • Nuk ka masa per ngjarje per vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.10.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8 *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, *“Kapaciteti teknik”*, pika 4 dhe 5, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukes, me anë të cilit të jepet informacion për:

- Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,
- Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,
- Grup të gatshëm
- Jo më pak se 45 punonjës shërbimi
- Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti ne perputhje me nenin 22 te ligjit nr.75/2014,
- Jo me pak se 10 arme krahu,
- Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka ngjarje te ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Nuk ka masa per ngjarje për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi,
- Ka performance pozitive.

5. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vërtetim lëshuar jo më parë se Korrik 2019, lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkoder, me anë të cilit të jepet informacion për:*

- *Jo më pak se 5 Operatorë të Qendrës së Kontrollit,*
- *Jo më pak se 2 përgjegjës shërbimi,*
- *Grup të gatshëm,*
- *Jo më pak se 120 punonjës shërbimi të certifikuar,*
- *Qendër Kontrolli në Njesin Administrative ku ndodhet objekti në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.75/2014,*
- *Jo më pak se 18 arme krahu dhe 8 arm brezi,*
- *Nuk ka masa administrative për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,*
- *Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,*
- *Nuk ka ngjarje të ndodhura për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,*
- *Nuk ka masa për ngjarje për vitin 2017-2018 dhe në vazhdimësi,*
- *Ka performancë pozitive.*

III.10.2. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.10.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*” b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

III.10.4. Në nenin 38 “*Kundërvajtjet administrative*”, pika 1 dhe 2 të ligjit nr.75/2014 dt.10.07.2014 “*Për shërbimin privat të sigurisë fizike*” parashikohet se: “*1.Për shkelje të dispozitave të këtij ligji, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, jepen masa administrative. 2.Masa administrative jepen nga strukturat e Policisë së Shtetit.*”

III.10.5. Në nenin 28 pika 2 “*Kontratat e Shërbimeve*” të VKM nr.914 dt.29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar parashikohet “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*”

III.10.6. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri kërkon garanci në lidhje me përmbushjen me sukses të kontratës nga ana e operatorëve ekonomikë të cilët

duhet të dëshmojnë seriozitet, besueshmëri gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre. Kriteri i vendosur për mospasjen e masave administrative dhe masave mbi ngjarjet e ndodhura për operatorët ekonomikë gjatë veprimtarisë së tyre nuk përbën në vetvete një kriter diskriminues dhe nuk i tejkalon përmasat e kontratës që do të prokurohet. Është në të drejtën e autoritetit kontraktor që të vendosë të tilla kritere ndaluese për operatorët të cilët nuk kanë një performancë pozitive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duke u ndëshkuar nga organet përkatëse me masa administrative për shkak të mospërmbljes së rregullt të detyrimeve të caktuara që burojnë nga legjislacioni në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike apo nga akte të tjera ligjore e nënligjore. Komisioni gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron të gjitha kapacitetet për realizimin e kontratës me sukses në afat dhe në cilësi sipas përcaktimeve të dokumentave standarte të tenderit.

Për më tepër që në vërtetimin që lëshon Drejtoria Vendore e Policisë për performancën e subjektit sh.p.s.f, referuar Udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm, në pikën 4 të formatit standard që lëshohet për këtë qëllim, jepet informacion për masat administrative dhe për masat e marra për ngjarjet.

Për sa i përket pretendimit të operatorite ekonomik ankimes për heqjen e kriterit në lidhje me ngjarjet dhe shkeljet administrative, KPP sqaron se, ngjarjet nuk mund të shmangen gjatë aktivitetit të shërbimit të ruajtjes me roje dhe nuk varen nga subjektet SH.P.S.F. E rëndësishme është që shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike të reagojnë ndaj tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për ti minimizuar pasojat e këtyre ngjarjeve apo edhe për ti shmangur ato. Ndërsa për sa i përket shkeljeve administrative, sqarojmë se kjo kërkesë është e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore.

Është në të drejtën e autoriteteve kontraktore të vendosin ato kritere ligjore të cilat i paraqesin një panoramë të qartë këtij të fundit mbi kapacitetin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. E rëndësishme është që kriteret të mos jenë diskriminuese dhe të ofrojnë një trajtim të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe të jenë në proporcion me natyrën e kontratës.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor, të modifikojë kriterin duke hequr kërkesat “Nuk ka shkelje të konstatuara për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi dhe Nuk ka ngjarje të ndodhura për vitin 2017-2018 dhe ne vazhdimesi”, si kërkesa diskriminuese dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimese qëndron pjesërisht.

III.11. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Trezhnjeva” sh.p.k. *“Ne kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 18 automjete dhe 6 motorra, në emer të shoqërisë ose në rastin kur janë në emer të administratorit, apo të marra me qera nga një person juridik apo fizik tjetër.*

Per automjetet në pronesi duhet të paraqiten:

- *Certifikatat e Pronesise*

- Lejet e qarkullimit.
- Certificate e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara
- Siguracionet

Per automjetet me qera duhet te paraqiten:

- Kontrate qeraje te lidhur para noterit
- Certificate e Pronesise
- Lejet e qarkullimit
- Certificate e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara
- Siguracionet

Faturat tatimore te prera nga qiradhenesi dhe pagesen perkatese bankare per periudhen e marrjes se mjeteve me qera.

Kerkesa per paraqitjen e 18 automjete dhe 6 motora" eshte nje kerkese e paligjshme dhe jo ne proporcion me volumin e realizimit te kontrates pasi kemi vetem 3 objekte te grupuara ne nje perimter te caktuar ku nje automjet ose nje motor per objekt eshte i mjaftueshem per kryerjen e sherbimit pasi diskriminon operatoret ekonomik qe disponojne automjete dhe jo motora.

Nga sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit si ne vijim:

5.Operatori ofertues duhet te vertetoje se disponon 3 motora ose 3automjete ne pronesi ose me kontrate qeraje per nderhyrje ne raste nevoje. Mjetet duhet te jene te pajisur me dokumentacionin perkates (leje qarkullimi, kolaudim i mjetit dhe sigurimi i detyrueshem, taksa te vlefshme certificate pronesie, nga nje automjet ose motorr për cdo objekt.”, Komisioni I Prokurimit Publik vëren se,

III.11.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.3.10 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

10. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 18 automjete dhe 6 motorra, në emër të shoqërisë ose në rastin kur janë në emër të administratorit, apo të marra me qera nga një person juridik apo fizik tjetër.

Për automjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- Certificate e Pronësisë
- Lejet e qarkullimit.
- Certificate e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara
- Siguracionet
-

Për automjetet me qera duhet të paraqiten:

- Kontratë qeraje të lidhur para noterit
- Certificate e Pronësisë
- Lejet e qarkullimit.
- Certificate e kontrollit Teknik
- Taksat e paguara.
- Siguracionet

- *Faturat tatimore të prera nga qiradhënësi dhe pagesën përkatëse bankare për periudhën e marrjes së mjeteve me qera*

III.11.2. Ndërkohë në shtojcën e publikuar për modifikimin e dokumentave të tenderit nga autoriteti kontraktor, kriteri i mësipërm është modifikuar si më poshtë:

2. *Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 6 automjete dhe 6 motorra, në emër të shoqërisë ose në rastin kur janë në emër të administratorit, apo të marra me qera nga një person juridik apo fizik tjetër.*

Për automjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- *Çertifikatat e Pronësisë*
- *Lejet e qarkullimit.*
- *Çertifikatë e kontrollit Teknik*
- *Taksat e paguara*
- *Siguracionet*

Për automjetet me qera duhet të paraqiten:

- *Kontratë qeraje të lidhur para noterit*
- *Çertifikatat e Pronësisë*
- *Lejet e qarkullimit.*
- *Çertifikatë e kontrollit Teknik*
- *Taksat e paguara.*
- *Siguracionet*
- *Faturat tatimore të prera nga qiradhënësi dhe pagesën përkatëse bankare për periudhën e marrjes së mjeteve me qera*

III.11.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.11.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”

a) *licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.11.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.11.6. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me kriterin e sipërcituar argumentohet si vijon: “Ne lidhje me pretendimin e ankimesit mbi kriterin 3.3 kapaciteti teknik pika 10 mbi disponimin minimalisht të 18 automjeteve dhe 6 motorra, ku kërkon ndryshimin e kriterit si ne vijim: Operatori ofertues duhet të vërtetojë se disponon 3 motora ose 3 automjete, komisioni relaton: Në nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, të LPP, I ndryshuar, citohet: [...]. Bazuar në piken e mësipërme, autoriteti kontraktor i lind e drejta të kërkojë dokumentacion për të siguruar se operatori ekonomik ka makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike të nevojshme për kryerjen e shërbimit. Komisioni gjykon se numri i mjeteve është i ekzagjeruar, dhe mjetet e mjaftueshme do të ishin 6 automjete dhe 6 motorra. Motorrat janë të domosdoshëm për nderhyrje urgjente në rastet e bllokimit të rrugëve nga trafiku. Në këtë mënyrë kërkesa e operatorit ekonomik duhet të pranohet pjesërisht. Njesia e prokurimit ta modifikojë atë duke kërkuar 6 automjete dhe 6 motorra.”

III.11.7. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, si dhe nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP gjykon se, në rastin konkret, kërkohet ruajtja e tre objekteve të rëndësishme dhe komplekse për nga natyra e tyre. Gjithashtu, për secilin objekt (HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejes), kërkohet një numër i konsiderueshëm rojesh dhe vendroresh, rrjedhimisht edhe shërbimi i ruajtjes për këto objekte është i një rëndësie të vecantë. Kështu që, KPP gjykon se, nisur nga rëndësia e shërbimit që do të kryhet, interesit publik që ajo ka, objektit të prokurimit, vlera e lartë e investimit të kësaj procedure prokurimi dhe kompleksitetit e specifikës së saj, autoriteti kontraktor e ka ulur numrin e kërkuar të mjeteve, për realizimin me sukses të objektit të prokurimit, në përputhje me sa më lart. Kriteri për disponimin e mjeteve si dhe numri i tyre përcaktohet në përputhje me nevojat dhe kërkesat e vecanta të autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, në mbështetje të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e

kontratës, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit të garantohet për cilësinë, shpejtësinë dhe efikasitetin e shërbimit që kërkon të realizojë.

Gjithashtu, për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me dokumentacionin provues të disponimit të këtyre mjeteve dhe të kapaciteteve të tyre, KPP gjykon se, për mjetet në pronësi autoriteti kontraktor ka kërkuar dokumentacionin e nevojshëm, konform dispozitave ligjore, ndërsa për sa i përket mjeteve të marra me qera, autoriteti kontraktor, mund të vërtetojë disponimin e këtyre mjeteve si dhe kapacitetet dhe gjendjen e tyre, me anë të dokumentacionit si Kontratë qeraje të lidhur para noterit, Çertifikatat e Pronësisë, Leje e qarkullimit, Çertifikatë e kontrollit Teknik, Taksat e paguara, Sigurimet. Pra kërkesa për paraqitjen e Faturave tatimore të prera nga qiradhënësi dhe pagesën përkatëse bankare për periudhën e marrjes së mjeteve me qera, është një kërkesë e ekzagjuar, e cila nuk i shërben qëllimit të vendosjes së këtij kriteri dhe si i tillë të hiqet.

Akoma më tej, theksojmë se, duke qenë se kjo procedurë sipas arsytimit në pikën III.1. të këtij vendimi duhet të ndahet në lote, autoriteti kontraktor në modifikimin e dokumentave të tenderit duhet të ketë parasysh, të përcaktojë numrin dy automjete dhe dy motorrë, për secilin Lot.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.12. Në lidhje më pretendimin e ankimuesit “Trezhnjeva” sh.p.k. se “*Operatori ekonomik duhet të disponojë jo me pak se 30 dedektore dore elektronike, jo me pak se 30 spray neuromuscularizues, jo me pak se 30 radio komunikimi dhe jo me pak se 30 cope jelek antiplumb.*

Ne rastet kur pajisjet janë blerë brenda vendit operatori duhet të paraqesë:

- *Fatura Tatimore e Shitjes e firmosur nga të dyja palët dhe e vërtetuar nga shitësi;*
- *Pagesën që vërteton vlerën e blerjes së pajisjeve;*
- *Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve;*

Ne rastet kur këto kapacitete janë blerë jashtë vendit operatori duhet të paraqesë:

- *Deklaratën e zhdoganimit nepermjet se ciles vërtetohet zhdoganimi i pajisjeve;*
- *Xhirimin Bankar që vërteton pagesën e vlerës së blerjes së pajisjeve;*
- *Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve;*

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të pajisjeve dhe në rast se konstaton se operatori ekonomik nuk disponon realisht pajisjet, autoriteti përveç se do ta skualifikojë, por do të kryejë denoncim dhe në APP për qëllim të nenit 13 të LPP-se.

Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike, kriteri duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përben kusht s'kualifikimi.

Kërkesa e mesipërme është një kërkesë që vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Kontraktor duhet të përcaktojë qartë dokumentin që vërteton pajisjet ose me vërtetim nga Drejtoria e Policisë Qarkut përkatës ose me fatura tatimore dhe mos të dublojë kërkesat për dokumentacion dhe jo të kërkojë dokumenta pa lidhje që se din as vete çfarë kërkon ose pse i duhet xhirimi bankar e aq më tepër Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve, targa të cilat i takojnë institucioneve të tjera bile ligjvënasi për të lehtësuar bizneset edhe vërtetimet e tatimeve për detyrime të deklarimit.

Madje, kërkesa per radio komunikimi, dedektor, spray bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, date 20.12.2017, per kete arsye duhet hequr.

Se pari, kërkesa per paraqitjen e pajisjeve speciale bie ndesh me rekomandimin e APP-se me KPP-ne nr. 15166 dhe nr. 1858, date 20.12.2017 pasi sic edhe thekson ky rekomandim keto pajisje presupozohet qe disponojne operatoret nga momenti licencimit te tyre:

- Te mos perlllogariten shpenzimet per uniforrnen, si dhe te mos kerkohet paraqitja e mjeteve ndihmese si p.sh elektrik dore etj, pasi keto kriteret permbushen nga shoqëria qe ne momentin e licensimit te saj.

Per kete arsye duhet hequr nga kriteri i kualifikimit kërkesa per, radio komunikimi, dedektor, spray, jelek antiplumb.

Se dyti, edhe sikur te pranojme per nje moment se kërkesa per paraqitjen e pajisjeve speciale eshte e ligjshme (nuk eshte) pasi numri per mjete speciale te sherbimit, eshte teresisht diskriminues dhe jo ne proporcion me objektin e procedures.

Referuar specifikimeve teknike dhe grafikut te sherbimit rezulton te jene 36 (tridhjet e gjashte vendroje) dhe kërkesa per 30 cop pajisje, emertimet e te cilave jane te permendura me siper eshte e jo ne proporcion me objektin e prokurimit pasi 1 pajisje per vendroje do te mjaftonte.

Kërkesa e mesiperme ku kerkohet ... "jelek antiplumb" eshte nje kerkese qe vjen ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi dhe vendimet e komisionit te prokurimeve publike pasi nuk kemi te bejme me sherbim transport vlerash monetare 1.3.B por kemi te bejme me sherbim ruajtje kat 1.3.A.

Per sa me siper, kerkojme heqjen e kesaj kerkese nga kriteri kualifikues. ", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.12.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.3.11 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“11.Operatori ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 30 dedektorë dore elektronike, jo më pak se 30 spray neuroparalizues, jo më pak se 30 radio komunikimi dhe jo më pak se 30 copë jelek antiplumb.

Në rastet kur pajisjet janë blerë brenda vendit operatori duhet të paraqesë:

- ☐ Faturë Tatimore e Shitjes e firmosur nga të dyja palët dhe e vulosur nga shitësi;
- ☐ Pagesën që vërteton vlerën e blerjes së paisjeve;
- ☐ Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve;

Në rastet kur këto kapacitete janë blerë jashtë vendit operatori duhet të paraqesë:

- ☐ Deklaratën e zhdoganimit nëpërmjet së cilës vërtetohet zhdoganimi i paisjeve;
- ☐ Xhirimin Bankar që vërteton pagesën e vlerës së blerjes së paisjeve;
- ☐ Deklarimin e faturës tatimore të shitjes në sistemin elektronik të tatimeve;

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të pajisjeve dhe në rast se konstaton se operatori ekonomik nuk disponon realisht pajisjet, autoriteti përveç se do ta skualifikojë, por do të kryejë denoncim dhe në APP për qëllim të nenit 13 të LPP-së.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kriteri duhet të plotësohet nga sejcili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përbën kusht s'kualifikimi.”

III.12.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.12.1.3. Në Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të ndryshuar , neni 23, pika 1 dhe 2, përcaktohet se: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”.

III.12.1.4. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 1, 2 dhe 5, parashikon se: “1. Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.12.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës por krijon efektin e kufizimit për pjesëmarrjen e gjërë të operatorëve ekonomikë. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik

në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: “2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.12.1.6. Lidhur me kërkesën e ankimuesit “Trezhnjeva” sh.p.k. për heqjen e kërkesës për jo më pak se 30 dedektorë dore elektronikë, dhe jo më pak se 30 spraj neutralizues, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, mbështetur edhe në rekomandimin Nr.15166 prot. Nr. 1858 prot., datë 20.12.2017, pajisjet e mësipërme, janë pajisje ndihmëse, të cilat, operatorët ekonomikë i përmbushin që në momentin e licensimit të tyre, kështu që këto kërkesa, nuk janë në proporcion me objektin e prokurimit. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë këto kërkes duke i hequr nga kriteri I mësipërm.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.12.2. Lidhur me kërkesën e ankimuesit “Trezhnjeva” sh.p.k. për heqjen e kërkesës për jo më pak se 30 radio komunikimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë 30 radio komunikimi si dhe dy sistem radiokomunikimi, me qëllim kryerjen me sukses të shërbimit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor, në mbështetje të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit të garantohet për cilësinë, shpejtësinë dhe efikasitetin e shërbimit që kërkon të realizojë.

Nisur nga rëndësia e shërbimit që do të kryhet, interesit publik që ajo ka, objektit të prokurimit, vlera e lartë e investimit të kësaj procedure prokurimi dhe kompleksitetit e specifikës së saj, KPP gjykon se, kërkesa e autoriteti kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të radiokomunikimit është një kërkesë e drejtë dhe në përputhje me objektin e prokurimit.

Gjithashtu, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë numrin e radiokomunikimit në përputhje me numrin e vendrojeve për secilin objekt, HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejes.

Akoma më tej, theksojmë se, duke qenë se kjo procedurë sipas arsytimit në pikën III.1. të këtij vendimi duhet të ndahet në lote, autoriteti kontraktor në modifikimin e dokumentave të tenderit duhet të ketë parasysh, të përcaktojë numrin e radiokomunikimit, sipas përmasave dhe vlerës për secilin Lot.

Gjithashtu, për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor për vërtetimin e pronësisë së këtyre pajisjeve, autoriteti kontraktor, duhet të rishikojë këto kërkesa, në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi, pasi disponimi i këtyre pajisjeve mund të vërtetohet më së miri me anë të faturave të blerjes ose deklaratave zhdoganore nëse këto produkte blihen jashtë vendit. Sa më sipër autoriteti kontraktor, bazuar në arsyetimin e mësipërm, duhet të përcaktojë saktë, kriterin në lidhje me dokumentat për disponimin e produkteve të mësipërme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

III.12.3. Lidhur me kërkesën e ankimuesit “Trezhnjeva” sh.p.k. për heqjen e kërkesës për jo më pak se 30 jelek antiplumb, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, autoriteti kontraktor, në mbështetje të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit të garantohet për cilësinë, shpejtësinë dhe efikasitetin e shërbimit që kërkon të realizojë.

Nisur nga rëndësia e shërbimit që do të kryhet, interesit publik që ajo ka, objektit të prokurimit, vlera e lartë e investimit të kësaj procedure prokurimi dhe kompleksitetit të specifikës së saj, KPP gjykon se, kërkesa e autoriteti kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të jelekëve antiplumb është një kërkesë e drejtë dhe në përputhje me objektin e prokurimit.

Gjithashtu, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë numrin e jelekëve antiplumb në përputhje me numrin e vendrojeve për secilin objekt, HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejes.

Akoma më tej, theksojmë se, duke qenë se kjo procedurë sipas arsyetimit në pikën III.1. të këtij vendimi duhet të ndahet në lote, autoriteti kontraktor në modifikimin e dokumentave të tenderit duhet të ketë parasysh, të përcaktojë numrin e jelekëve antiplumb, sipas përmasave dhe vlerës për secilin Lot.

Gjithashtu, për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor për vërtetimin e pronësisë së këtyre pajisjeve, autoriteti kontraktor, duhet të rishikojë këto kërkesa, në përputhje me rregullat dhe ligjet në fuqi, pasi disponimi i këtyre pajisjeve mund të vërtetohet më së miri me anë të faturave të blerjes ose deklaratave zhdoganore nëse këto produkte blihen jashtë vendit. Sa më sipër autoriteti kontraktor, bazuar në arsyetimin e mësipërm, duhet të përcaktojë saktë, kriterin në lidhje me dokumentat për disponimin e produkteve të mësipërme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron pjesërisht.

III.13. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Trezhnjeva” sh.p.k. për modifikimin e kriterit “*Ne kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar: Vërtetim leshuar nga Bashkia/Njesi Administrative me ane të se cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2016-2017-2018, për adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatorit ekonomik, sipas Ekstraktit*

Historik lëshuar nga QKR. Kerkese perseritur dy here e ekzagjeruar dhe ne kundershtim me ligjin Legjislacioni i prokurimit publik i ka percaktuar qarte rastet kur nje operator mund te perjashtohet nga pjesmarrja ne nje procedure prokurimi dhe ky rast nuk eshte i perfshire aq me teper kerkohet per tre vite kur mund te kerkohet i vitit te fundit dokumentacion i tepert dhe qe nuk i sherben autoritetit Kontraktor. Kerkojme heqjen e ketij kriteri ose te kerkohet vertetim per vitin e fundit per njesit administrative ku ndodhen objektet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.13.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 3.1/5 “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”, nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

5.Vërtetim lëshuar nga Bashkia/Njësi Administrative me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e taksave për vitin 2016-2017-2018, për adresat ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet operatori ekonomik, sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR.

III.13.2. Neni 12 “Regjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, parashikon se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

III.13.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.13.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.13.5. Referuar sa mësipër, KPP gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitet 2016-2017-2018 pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ka ushtruar ose ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Në këtë kuptim KPP gjykon se megjithëse neni 28 i VKM nr.914 datë 29.12.2014, i ndryshuar nuk parashikon në mënyrë eksplicite një kërkesë të tillë, por kjo VKM nuk kufizon në asnjë rast autoritetin kontraktor të referohet ligjeve specifike (lex specialis) në fuqi sikurse në rastin konkret ligjit për taksat vendore për të hartuar kriteret të tilla të cilat dëshmojnë për kapacitetet ekonomike financiare të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në procedurën e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.14. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *XII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar: 1. Operatori ekonomik gjate tre viteve te fundit 2016-2017-2018 nga data e hapjes se tenderit duhet te kete xhiro mesatare vjetore nje viere jo me te vogel se 166,000,000 leke. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit. Ne rastet e bashkimit te operatorëve ekonomike, kriteri duhet te plotesohet nga sejcili prej anetareve pjesemarrës ne perputhje me perqindien e pjesemarrjes ne te kundert perben kusht s'kualifikimi. Ky kriter duhet te modifikohet duke kerkuar vertetim nga Administrata Tatimore jo me pak se 40% e mesatares per xhiron e realizuar gjate tre viteve te fundit, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.14.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, pika 3.2. *“Kapaciteti ekonomik dhe financiar”*, pika 1 është përcaktuar kriteri:

“Operatori ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2016-2017-2018 nga data e hapjes se tenderit duhet te kete xhiro mesatare vjetore një vlerë jo me te vogel se 166,000,000 leke. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kriteri duhet të plotësohet nga sejcili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përbën kusht s'kualifikimi”.

III.14.2. Në nenin 46 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar përcaktohet shprehimisht se: *c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;*

III.14.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 28, pika 4, përcaktohet shprehimisht:

“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

III.14.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e mësipërm duke përcaktuar qartë dhe riformuluar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi në lidhje me kriterin për xhiron, sipas përcaktimit për vlerën dhe për periudhën se kur kërkohet ky dokument, gjithnjë duke qenë në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar. Sqarojmë se përcaktimi i kriterëve për kualifikim duhet të jenë të qarta e të sakta dhe në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik në fuqi, me qëllim shmangien e konfuzionit tek operatorët ekonomikë gjatë përgatitjes dhe hartimit të ofertës, ashtu edhe tek komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës për të mos lënë vend për paqartësi, në përputhje me arsyetimet e mësipërme.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.15. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: “[...]Ne kriteret e vecanta të kualifikimit, autoriteti ka kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv (të mos ketë dale me humbje) të qëndrueshëm gjatë tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të ketyre tre viteve, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të shoqëruara nga akt ekspertizë e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kriteri duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përben kusht s’kualifikimi. Ky kriter është egzagjeruar duhet të modifikohet dhe të kërkohet Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv (të mos ketë dale me humbje) të qëndrueshëm gjatë tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopjetë bilanceve të një prej tre viteve të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të shoqëruara nga akt ekspertizë e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kriteri duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përben kusht s’kualifikim”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.15.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, pika 3.2/2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv (të mos ketë dalë me humbje) të qëndrueshëm gjatë tre viteve 2016, 2017 dhe 2018. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të ketyre tre viteve, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të shoqëruara nga akt ekspertizë e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kriteri duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në të kundërt përben kusht s’kualifikimi”.

III.15.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që

autoriteti kontraktues i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”.

III.15.3. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 4, gërma “a”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktues kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse [...]

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktues për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës”.

III.15.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin.

Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.15.5. Referuar testit të mësipërm të proporcionalitetit, KPP konstaton se synimi i autoritetit kontraktor me anë të kriterit të mësipërm është përmbushja me sukses e kontratës dhe për realizimin e synimit të mësipërm është parashikuar dorëzimi i bilanceve pozitive për tre vite financiare 2016-2017-2018. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, si edhe specifikimet teknike duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

KPP gjykon se kuadri ligjor në asnjë rast nuk parashikon se dorëzimi i bilanci të më shumë se një viti negativ (me humbje) tregon pa aftësinë financiare për përmbushjen me sukses të kontratës. Akoma më tej, vetë kuadri ligjor në fushën e procedurave tatimore, lex specialis ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk penalizon në asnjë rast subjektet juridikë në ushtrimin e aktivitetit të tyre tregëtar, edhe në rast se, rezulton se, bilanci i një ose më shumë viteve rezulton me humbje (negativ). I vetmi penalizim parashikohet në ligjin nr.8901 datë 23.05.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, në të cilin referuar nenit 14 pika 1 parashikohet se: “procedura e falimentit hapet me kërkesë të organeve tatimore kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë tre vjeçare”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e bilancave financiare për tre vitet financiare 2016-2017-2018 të ushtrimit të aktivitetit tregëtar, si një e drejtë e cila rrjedh nga lex specialis dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Nga ana tjetër, KPP, gjykon se, kërkesa e mësipërme lidhet strictu sensu me njohjen e aftësisë së operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për të marrë pjesë në qarkullim civil si subjekt tregëtar, si edhe duke shfaqur aftësi pagueuse ndaj të tretëve dhe ndaj shtetit.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dëshmia se bilanci financiar i një operatori ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi ka rezultuar me humbje për një ose disa vite, nuk është një parakusht që tregon pa aftësinë pagueuse të tij dhe njëherazi rrezikun potencial të mospërmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata publike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ndër parimet kryesore të përgatitjes së pasqyrave financiare, referuar Standardit Kombëtar të Kontabilitetit (SK) është ai vijimësisë. Parimi i vijimësisë do të thotë se veprimtaria ekonomike e njësisë ekonomike do të ketë vijimësi dhe njëësia ekonomike nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj. Sa më sipër, KPP gjykon se, një operator ekonomik nuk mund të diskriminohet nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit ipso facto se, ka dëshmuar se një ndër pasqyrat financiare të aktivitetit financiar të këtij të fundit ka rezultuar me humbje, kur në asnjë rast nuk ka dëshmuar se ndodhet në kushtet e humbjeve në vijimësi (referuar parimit të SK), apo në gjendjen e insolvabilitetit. Gjithashtu, në nenin 46 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet se *“Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”*.

KPP gjykon se, kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktues cënon stimulimin e pjesëmarrjes së biznesit të vogël/mesëm në procedurat e prokurimit publik. Në një rast hipotetik, një operator ekonomik i cili ka nisur ushtrimin e aktivitetit tregëtar vetëm një vit para pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit publik nuk mund të disavantazhohet/diskriminohet për faktin se bilanci financiar ka rezultuar me humbje.

Gjithashtu, KPP gjykon se, pasyqrimi i humbjeve në bilanc vijnë për shkaqe të ndryshme si: humbja nga ndryshimi i kursit të këmbimit të kërkesave për t’u arkëtuar dhe detyrimeve për t’u paguar (për shembull, huatë e dhëna dhe të marra) në monedhë të huaj e që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese), humbja në kapital, humbja nga shitjet; humbja nga veprimtaritë e shfrytëzimit, shkaqe të cilat jo drejtpërdrejtë lidhen me pa aftësinë pagueuse të pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër, KPP gjykon se, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, si edhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në asnjë rast, nuk parashikojnë se, një operator ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik do të konsiderohet prima facia jo i aftë për përmbushjen e kapacitetit ekonomik në drejtim të përmbushjes së kontratës në rast se, rezulton se, bilanci i një ose më shumë viti është me humbje (negativ), për sa kohë, që ky i fundit, nuk është subjekt i ndalimeve të parashikuara nga ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, dhe ligji nr. 8901, datë 23.05.2002 *“Për falimentimin”*, i ndryshuar.

III.15.6. Në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës dhe *“Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit Ndërmjet Komuniteteve Europiane E Shteteve Të Tyre Anëtare Dhe Republikës Së Shqipërisë”*,

neni 70 i së cilës parashikon se: *“Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me acquis e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet”, Komisioni i Prokurimit Publik i referohet jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë së BE në vendimmarrjen e tij.*

III.15.7. Inter Allia dhe Mutatis Mutandis në Çështjen C-218/11 Édukovázig dhe Hochtief Construction GJED ka argumentuar se “Niveli minimal i gjendjes ekonomike dhe financiare: GjD-ja konfirmoi se Direktiva e lejonte autoritetin kontraktues që të kërkonte një nivel minimal të gjendjes ekonomike dhe financiare (paragrafi 26).

GjD-ja gjithashtu vuri në dukje se Direktiva e lejonte autoritetin kontraktues që të kërkonte nga operatorët ekonomikë që të siguronin dëshmi për atë gjendje përmes paraqitjes së bilancit të tyre. GjD-ja vërejti më tej se, në përgjithësi, niveli minimal i gjendjes ekonomike dhe financiare nuk mund të përcaktohet duke iu referuar një bilanci. Prandaj, autoriteti kontraktues mund t’i referohet një apo më shumë aspekteve të veçanta të bilancit (paragrafët 26-27). GjD-ja konfirmoi se, në këtë kontekst, Direktiva i linte "një shkallë të drejtë lirie autoriteteve kontraktuese".

Sipas GjD-së, Direktiva "i autorizon shprehimisht autoritetet kontraktuese të zgjedhin referencat provuese të cilat duhet të paraqiten nga [operatorët ekonomikë] për të dhënë prova të gjendjes së tyre ekonomike dhe financiare." GjD-ja theksoi se liria në dispozicion të autoriteteve kontraktuese nuk ishte e pakufizuar.

Niveli i kapacitetit minimal i vendosur nga autoriteti kontraktues duhet të jetë i lidhur dhe proporcional në raport me lëndën e kontratës (paragrafi 29). Aspektet e bilancit të zgjedhur nga autoriteti kontraktues për të demonstruar nivelin minimal të gjendjes ekonomike dhe financiare duhet:

- Të sigurojë informacion objektiv për një gjendje të tillë
- Të përshtatet me madhësinë e kontratës në fjalë
- Të mos shkojnë përtej asaj që është e arsyeshme për qëllimin (paragrafi 2929)

GjD-ja ballafaqoi vlerësimin e gjendjes ekonomike dhe financiare me vlerësimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale.

GjD-ja deklaroi se, në lidhje me kapacitetet teknike dhe profesionale, Direktiva krijonte "një sistem të mbyllur i cili kufizon mënyrën e disponueshme për vlerësimin dhe verifikimin dhe, për këtë arsye, i kufizon [autoriteteve kontraktuese] mundësitë për të vendosur kërkesa" (paragrafi 28). GjD-ja vuri në dukje se legjislacioni i shteteve anëtare në lidhje me llogaritë vjetore të shoqërive nuk ishte subjekt i harmonizimit të plotë. Prandaj, nuk mund të përjashtohet që mund të ketë dallime në lidhje me një aspekt të veçantë të një bilanci. Mund të ketë dallime në aspektet e një bilanci me të cilat autoriteti kontraktues vendos një nivel minimal kapaciteti. [...]"

III.15.8. Sa më sipër, KPP gjykon se, referuar testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e bilanceve të qëndrueshme pozitive për tre vitet financiare 2016-2017-2018, nuk është në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nuk është e përshtatshme për realizimin e synimit të autoritetit kontraktor dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin në përputhje me sa më sipër arsyetuar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.16. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” sh.p.k. se: “Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licence/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zone mbulimi Qarkun Kukës dhe Qarkun Shkodër. Edhe kjo është kërkesë e egzagjeruar prandaj ky kriter duhet të modifikohet dhe të kërkohej; Operatori ekonomik duhet të zotërojë Licence/ Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zone mbulimi rrethi Tropojë dhe rrethi Shkodër ku ndodhen objekte dhe zbatohet kontrata.

Kërkojme të hiqet kërkesa radioalarmit të leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” pasi kemi të bëjmë me ruajtje fizike dhe jo me verifikim alarmi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.16.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 3.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“Operatori ekonomik duhet të zotërojë Liçencë/ Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit dhe radioalarmit të leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” me zonë mbulimi Qarkun Kukës dhe Qarkun Shkodër”.

III.16.2. Në shtojcën 11 “Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit” të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është përshkruar kryerja e shërbimit si vijon:

Shërbimi që kërkohej: Ruajtja e objekteve në HEC Fierze, HEC Koman dhe HEC Vau Dejës.

III.16.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.16.4. Në pikën 2, të nenit 28 “Kontratat e shërbimeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.16.5. Në nenin 66, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “AKEP-i lëshon një autorizim individual për përdorimin e frekuencave, në përputhje me PKRF-në dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave sipas neneve 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70 dhe 71 të këtij ligji.” Në këto autorizime, përcaktohet edhe zona e mbulimit (neni 70, pika 1, e Ligjit të lartpërmendur), ku përcaktohet se “Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave përmban: a) të dhëna për përfituesin; b) frekuencat e përfituara; c) vendndodhjen

dhe zonën e mbulimit; ç) afatin e vlefshmërisë së autorizimit; d) kushtet, që duhet të përmbushen për shfrytëzimin e frekuencës së caktuar, sipas nenit 71 të këtij ligji".

III.16.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojen e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimin me sukses të kontratës. Referuar Shtojcës 11 ku përcaktohet vendndodhja e objektit të prokurimit, konstatohet se, objekti i prokurimit është i shtrirë në tre objekte, konkretisht në *HEC Fierze*, *HEC Koman* të cilat shtrihen në qarkun Kukës, qyteti Tropojë, dhe *HEC Vau Dejes* I cili shtrijet në Qarkun Shkodër, qyteti Vau I Dejes, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri për paraqitjen e autorizimit të lëshuar nga AKEP referuar objektit të prokurimit nuk duhet të kërkohej për Qarkun Shkodër dhe Kukës, por në përputhje me vendet ku do të kryhet shërbimi. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e sipërcituar, duke hequr përcaktimin për Qarkun e Shkodrës dhe Kukësit dhe të përfshijë mundësinë e paraqitjes së autorizimit individual qytetin/qarkun ku përfshihet vendodhja e objektit/objekteve të prokurimit. Akoma më tej, duke qenë se kjo procedurë referuar arsytimit në pikën III.1. të këtij vendimi duhet të ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm në përputhje me ndarjen në lote, në mënyrë të tillë që të mbulojë zonën e mbulimit të shërbimit për secilin Lot. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues për heqjen e nga ky kriter të termit "radioalarm", KPP gjykon se, për sa kohë autoriteti kontraktor në zërat e shpenzimeve për këtë procedurë prokurimi nuk ka përfshirë asnjë zë për radioalarm, rrjedhimisht kjo kërkesë nuk qëndron. Pra, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës në përputhje me këtë konstatim, duke hequr kërkesën për radioalarm në kriterin 3.3.2 "Kapaciteti teknik" të dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi.

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesve qëndron.

III.17. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues: "*Pretendimi i Autoritet Kontraktor se 2 (dy) punonjes i diplomuar në bachelor për Elektronik/Telekomunikacioni/ Informatik/ Kompjuterike/ Megatronike është i nevojshëm nuk qëndron pasi kërkohej që kontrata do lidhet me një operator atehere për 1 operatore mund të kërkohej të kete punësuar 1 person por jo 2 persona ose të lihet alternativa kontrate me subjekte private që kryejnë këtë shërbim për mirmbajtjen e sallave operative.*", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.17.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 9 është përcaktuar kriteri: "*9. Operatori Ekonomik ofertues duhet që në stafin teknik të ketë edhe 2 (dy) punonjes i diplomuar në bachelor për Elektronik / Telekomunikacioni / Informatik / Kompjuterike / Megatronike. Për të vërtetuar disponimin e këtij kapaciteti, operatori duhet të paraqesë: Diplomen dhe Kontraten e Punës e cila duhet të mbulojë të gjithë periudhën e shërbimit i cili duhet të figurojë në listpagese të siguruar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë këtë kriter në të kundërt përbën kusht për s'kualifikim.*"

III.17.2. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.17.3. Në nenin 46 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar përcaktohet shprehimisht se: *"b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës"*.

III.17.4. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, neni 28, pika 5, përcaktohet shprehimisht: *"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e procedurës së prokurimit "Shërbim konsulence", stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë"*.

III.17.5. Referuar pretendimit të ankimesit, argumentave të autoritetit kontraktor, si dhe kriterit të kualifikimit të sipërcituar, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka hartuar në mënyrë të qartë kriterin e kualifikimit. Në kriter është kërkuar "Operatori Ekonomik ofertues duhet që në stafin teknik të ketë edhe 2 (dy) punonjes i diplomuar ne bachelor per Elektronik / Telekomunikacioni / Informatik / Kompjuterike / Megatronike. Per te vertetuar disponimin e ketij kapaciteti, operatori duhet te paraqese: Diplomen dhe Kontraten e Punës e cila duhet të mbulojë të gjithë periudhën e shërbimit i cili duhet te figuroje ne listpagese i siguruar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të plotësojë këtë kriter në të kundërt përbën kusht për s'kualifikim", ndërkohë që sipas pretendimit të ankimesit është kërkuar në të njëjtën kohë edhe qendër menaxhimi dhe kontrolli duke krijuar kështu konfuzion dhe paqartësi për operatorët ekonomikë të interesuar.

III.17.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

KPP gjykon se kriteret e përcaktuara në një procedurë prokurimi duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të shprehin të gjitha kërkesat dhe nevojat e autoritetit kontraktor me qëllim shmangien e

paqartësive që mund të lindin gjatë hartimit të ofertës, duke lënë vend për konfuzion në radhët e operatorëve ekonomikë.

KPP gjykon se mospërcaktimi i saktë i qëllimit për të cilin vendoset ky kriteri lë vend për konfuzion në radhët e operatorëve ekonomikë dhe njëherazi vështirëson punën e KVO-së gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave duke lënë vend dhe për mostrajtim të barabartë të ofertuesve. Në këtë kuptim, KPP gjykon se kriteri i sipërcituar duhet të saktësohet dhe sqarohet nga ana e autoritetit kontraktor, duke përcaktuar qëllimin e përcaktimit të këtij kriteri, funksionet dhe dokumentacionin e saktë me të cilin do të provohet kriteri i sipërcituar si dhe duke shmangur kështu kërkesat e paqarta të cilat çojnë në vlerësime të gabuara të ofertuesve.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.18. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues: *“XVI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, autoriteti ka kerkuar: Operatori ekonomik duhet te disponoje jo me pak se 2 (dy) Sistem Radiokomunikimi: Per te plotesuar kerkesen e mesiperme OE duhet te paraqese fatura tatimore shitje, pagesat perkatese dhe deklarimin e faturave ne sistemin elektronik te tatimeve. Kerkojme heqjen e ketij kriteri pasi eshte kerkuar licence / Autorizim per ngritjen dhe shfrytezimin e sistemit te pavarur te radiokomunikacionit dhe radioalarmit te leshuar nga AKEP konform ligjit nr. 9918 date 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise", me zone mbulimi Qarkun Kukes dhe Qarkun Shkoder, ku jane te percaktuar sistemet e Radiokomunikimit, aq me teper kerkohet dokumentacion pa lidhje si fatura tatimore dhe deklarimin ne SET (sistemi elektronik i tatimeve) kur ky dokument plotesohet me paraqitjen e QKSH dhe faturave tatimore per instalimin e paisjeve te salles operative. Deklarimi ose jo ne SET nuk i perket Autoritetit Kontraktor por jane institucione te tjera qe kontrollojne keto deklarime per AK eshte e mjaftueshme qe te jene kapacitetet teknike, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.18.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 12 është përcaktuar kriteri: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 2 (dy) Sistem Radiokomunikimi: Për të plotesuar kerkesen e mesiperme OE duhet te paraqese fatura tatimore shitje, pagesat përkatëse dhe deklarimin e faturave në sistemin elektronik të tatimeve”.*

III.18.2. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.18.3. Në nenin 46 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet shprehimisht se: *”b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

III.18.4. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, neni 28, pika 5, përcaktohet shprehimisht: *"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e procedurës së prokurimit "Shërbim konsulence", stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë"*.

III.18.5. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga rëndësia e shërbimit që do të kryhet, objekti i prokurimit, vlera e lartë e shërbimit të kësaj procedure prokurimi dhe kompleksitetit e specifikës së saj, gjykon që në përputhje me arsyetimin e bërë në pikën III.1. të vendimit për ndarjen në lote, autoriteti kontraktor të bëjë modifikimin e kriterit duke parashikuara një sistem komunikimi i cili të mbulojë të gjithë zonën ku do të kryhet shërbimi sipas ndarjes sa më sipër. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës në përputhje me këtë konstatim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, neni 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *"Për miratimin e rregullave "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Trezhnjeva" sh.p.k. për procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar"*, me nr. REF-33418-08-13-2019, me objekt *"Ruajtja me polici private e HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau Dejës" – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 36 muaj"*, me fond limit 415.786.312 lekë (pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 11.10.2019, nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor, me shpalljen e procedurës së prokurimit, të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "Trezhnjeva" sh.p.k.

6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1452 Protokolli,
Datë 30.08.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha